



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Kukës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI “AUDITIMIN FINANCIAR”

Tiranë, 2025

	PËRMBAJTJA	Faqe
SHKURTIME		3-3
I	PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-11
	1 Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	4-5
	2 Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-9
	3 Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	9-11
II.	HYRJA	11-16
	1 Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit	11-11
	2 Identifikimi i çështjes	11-12
	3 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12-12
	4 Përgjegjësitë e audituesve	12-13
	5 Kriteret e vlerësimit	13-14
	6 Standardet e auditimit	14-15
	7 Metodot e auditimit	15-16
	8 Dokumentimi i auditimit	16-16
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16-99
	1 Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	16-17
	2 Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	17-99
	2.1.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm	17-28
	2.1.2 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm	28-34
	2.2.1 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	34-44
	2.2.4 Auditimi mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre	44-56
	2.3 Vlerësimi Raportimit Financiar, hartimi i pasqyrave financiare	56-73
	2.4 Mbi administrimin e aseteve, procedurat e inventarizimit e regjistrimit, qirate	73-83
	2.5 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	83-99
	2.6 Të ndryshme, të dala gjatë auditimit	99-99
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	99-115

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jomateriale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave të Ndërtimeve Informale
AK	Autoritet Kontraktor
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
UP	Urdhër Prokurimi
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e Kukësit është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe 14 njësi administrative si vijon: njësi administrative Kukës (qyteti), njësitë administrative Surroj, Kolsh, Arrën, Bushtricë, Topojan, Malzi, Shtiqën, Kalis, Gryk-Çajë, Shishtavec, Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Zapod.

Bujqësia dhe infrastruktura: Ai njihet si një vend me traditë në rritjen dhe mbarështimin e deleve. Cilësia e mishit dhe e leshit të deleve lumjane ishte e njohur në të gjithë Ballkanin. Kukësi ishte gjithashtu një qendër e njohur e transportit. Krahës llojeve të tjera të transportit, aty ishte i zhvilluar dhe transporti ujor përmes liqenit artificial të Fierzës, i cili bënte të mundur lëvizjen e mallrave dhe të udhëtarëve si dhe zhvillimin e turizmit. Që prej vitit 2000, transporti përmes Liqenit të Fierzës ka pushuar së ekzistuari.

Të dhëna të tjera: Kukësi ka potenciale për të qenë një vend turistik, pasi posedon të gjithë larminë e elementëve turistikë si: relievin e shumëllojshme, ujin e bollshëm liqenor-lumor dhe burimor, klimën dhe mikroklimat, malet, pyjet, liqenin, lumenjtë, burimet dhe gurrat, livadhet alpine, bjeshkët me pishnajë dhe ahishte, monumentet e natyrës, kushtet tërheqëse për ushtrimin e llojeve të ndryshme të sportit si në futboll, mundje, hipizëm, rrëshqitje me ski, gjuetinë e peshkut, të zogjve dhe të kafshëve të egra etj. Rreth brigjeve të liqenit mund të ngrihen pika turistike dhe stacione barkash me vela ose skafe, ndërsa në bjeshkë mund të ngrihen shtëpi pushimi për pushuesit e turistë.

Misioni i Bashkisë Kukës është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetëqeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Kukës si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, nenit 50 “Auditi i jashtëm”, pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Kukës si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë

rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Kukës. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm;
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit;
- mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike;
- mbi vlerësimin e raportimit financiar dhe dhënien e opinionit për pasqyrat financiare të vitit 2023;
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. **Vlerësimi i riskut të kontrollit;**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2023 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 23,455 mijë lekë dhe gabimi i lejuar (10% - 20%) në vlerën 2,346 mijë lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli).

Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 21 gjetje dhe ka dhënë 22 rekomandime, nga ku masa organizative me 17 gjetje dhe 18 rekomandime, 3 gjetje dhe 3 rekomandime me efekt negativ në buxhet nga të ardhurat e munguara në vlerën 26,347,893 lekë, 1 gjetje - rekomandim për rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifave vendore në vlerën 204,209,278 lekë.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave

Për vitin 2023 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës paraqitet në masën 122,6%, nga 146,581,425.76 lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 179,764,222.40 lekë. Ky realizim tregon për programimin jo të saktë të të ardhurave të pa bazuar në kapacitetet reale, duke vendosur vlera të paargumentuara në mungesë të të dhënave se mbi ç'bazë janë përlllogaritur për çdo taksë dhe tarifë e tregojnë treguesit e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, ku për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin. Gjithashtu niveli i debitorëve të

biznesit për taksa dhe tarifa ka ardhur duke u rritur nga vlera prej 155,256,316.77 lekë në fund të vitit 2022 në vlerën 204,209,277.98 lekë në fund të vitit 2023.

- Procesi i ngarkimit të **familjeve** për taksat dhe tarifat vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitore dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë. Nga të dhënat që disponon Bashkia Kukës rezulton se kanë paguar detyrimet për këto taksa/tarifa 362 familje në vlerën 1,283,712.34 lekë nga 2852 gjithsej të taksuara për Qytetin e Kukës, ku 22.6 % e tyre rezultojnë debitorë në një ose disa taksa/tarifa.

- Për **taksën e tokës** për vitin 2023 janë arkëtuar 4,577 lekë nga 568,328.37 lekë e planifikuar ose në masën 0,8%, fakt që tregon se familjet fermere nuk taksohen dhe planifikimi i kësaj takse është bërë mbi bazë jo reale, pasi mbi bazën e të dhënave mbi ndarjen e fondit të tokës dhe kategorizimin e saj të ardhurat e planifikuara në vitin 2022 janë në vlerën 2,370,800 lekë.

- **Tarifa për shërbime (tregje, leje të perkohshme etj.)** për vitin 2023 është realizuar 0 lekë nga 2,869,776.94 lekë e planifikuar ose në masën 0%, kur në paketën fiskale Kreu II, pika 14 “tarifa e tregut të lirë është 600 lekë në muaj ose 7200 lekë në vit, parashikuar për ta mbledhur Sektori i tregut.

- **Tarifa e shërbimit veterinar** për vitin 2023 është realizuar 0 lekë nga 342,685.13 lekë e planifikuar ose në masën 0%. Për këtë tarifë nuk është siguruar informacion për numrin e therjeve të bagëtive gjatë vitit ushtrimor dhe nuk janë ndjekur procedurat për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e therjes dhe shërbimit për to, duke sjellë të ardhura të munguara.

- **Tarifa e parkimit** për vitin 2023 është realizuar 80,000 lekë nga 344,373.23 lekë e planifikuar ose në masën 13.7%. Bashkia Kukës nuk ka një plan të detajuar për mbledhjen e tarifës së parkimit.

- Nuk është realizuar arkëtimi i **taksës së ndikimit në infrastrukturë** (legalizimet) për 614 individë debitorë në vlerën **24,572,657** lekë, të rezultuar në fund të vitit 2023.

- Gjatë vitit 2023 janë aktive 7 kontrata për dhënie me qira të parcelave pyjore-kullosore për instalim antene të telefonisë celulare, ku në vitin 2024 janë përmbledhur në 4 kontrata. Nga këto paraqiten 2 subjekte qiramarrës (sipërfaqe pyjore) me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 1,215,236 lekë**, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kukës.

- Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, për 4 subjekte sipërmarrës punimesh që kanë realizuar projekte investimi për vitin 2023 me fondet e Bashkisë në territorin e Bashkisë Kukës mbi 10 milionë lekë nuk është aplikuar “*Tarifa e perkohshme për investime në bashki*”. Nga përllogaritja e detyrimit për këtë tarifë për 4 subjektet rezultojnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë në vlerën **560,000** lekë.

▪ **Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve**

- Nga auditimi i dokumentacionit të listave të inventarëve të aseteve rezulton se 4427 pasuri të paluajtshme publike, shtetërore janë transferuar në pronësi/përdorim Bashkisë Kukës, ku i kanë kaluar përfundimisht 1894 pasuri Bashkisë (Qendër) dhe 145 pasuri NJA Surroj sipas listave përfundimtare të miratuara me VKM-ët përkatëse, ndërsa për 2388 pasuri të 13 Njësive Administrative si: **Kolsh, Arrën, Bushtricë, Topojan, Malzi, Shtiqën, Kalis, Gryk-Çajë, Shishtavec** janë në fazën fillestare të miratimit dhe **Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Zapod** janë në fazën e miratimit të listave paraprake. Nga këto prona janë hipotekuar 20 prona dhe janë në proces hipotekimi 20 prona të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë inventarizimi dhe përditësimi i të dhënave të këtyre pronave. Në mungesë të inventarizimit, përditësimit dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë

a. Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së dhe të dhënave të Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të kontratave të qiradhënies me shoqëritë:

- që ushtrojnë aktivitetet HEC rezulton se, për periudhën objekt auditimi në 13 raste të Hec-ve pas vitit 2021 nuk janë lidhur kontrata qiradhënie me subjektet private për sipërfaqet pyjore/kullosore, që shfrytëzojnë për arsye se nga këto: në 1 rast tubacionet i kanë futur nën tokë, në 5 raste akoma nuk janë pajisur me leje ndërtimi, dhe në 7 raste nuk ka të dhëna. Në këto raste pavarësisht se nuk është marrë leja e ndërtimit (në AZHT), nga këto shoqëri për objektin e kryesor të kontratës, parcelat e marra me qira nga fondi pyjor-kullosor kanë vazhduar ti mbajnë të bllokuara mbi 1 vit, duke mos lejuar Bashkinë ti ketë në dispozicion për vënie në shfrytëzim nga qiramarrës të tjerë me pasojë shkaktimin e të *ardhurave të munguara* për buxhetin e Bashkisë Kukës;

- që ushtrojnë aktivitetin për prodhim dhe nxjerrje minerare në formë karriere dhe galerie në 23 raste subjektesh, që nuk kanë kryer procedurat e heqjes nga fondi pyjor/kullosor të parcelave që kanë shfrytëzuar, nga të cilat 13 subjekte kanë mbyllur aktivitetin, 4 subjekte vazhdojnë akoma aktivitetin në parcelat pyjore/kullosore pronë e Bashkisë, si dhe 6 subjekte sipas AKBN janë të pajisura me licenca aktiviteti në harkun kohor 2007-2010 për të cilat nuk ka të dhëna të tjera, nuk janë lidhur kontrata, duke sjellë të ardhura të munguara dhe mos kompensim i sipërfaqeve të pyllëzuara.

b. Në vitin 2023 janë lidhur 2 kontrata për dhënien në shfrytëzim të parcelave nga fondi pyjor/kullosor me procedura ankandesh, ku në të dy rastet janë paraqitur 1 ofertues, por nga verifikimi i dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura rezulton se mungojnë:

- garancia financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në plan-biznes (vërtetimi bankar për gjendjen), dokumenti që vërteton se ka të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të kualifikimit të DSA,

- dëgjesa publike, leja e ndërtimit të Bar-Restorantit, statusi juridik i parcelës nga ASHK bashkëlidhur me dokumentacionin miratimit me VKB;

- proces-verbali i dorëzimit të parcelës, detyrim që nuk është parashikuar në kontratë si dhe në rastin e kontratës 10-vjeçare nuk është noterizuar.

▪ ***Në procedurat e raportimit financiar dhe hartimin e pasqyrave financiare***

- Referuar të dhënave të kontabilitetit dhe analizës së llogarive të AAGJ rezulton se, mungojnë inventarët fizik dhe inventarët kontabël nuk rakordojnë me gjendjet në bilanc të llogarive:

- llog. 202 “*Studime dhe kërkime*” nuk rakordon për shumën 7,420,514 lekë për to nuk është llogaritur amortizim;

- llog.210 “*Toka, Troje, Terrene*” nuk rakordon për vlerën 202,600,645 lekë;

- llog.211 “*Pyje, Plantacione*” nuk rakordon për vlerën 22,186,849 lekë;

- llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” nuk rakordon për vlerën 377,725,348 lekë;

- llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” nuk rakordon për vlerën 767,282,166 lekë;

- llog. 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” nuk rakordon për vlerën 54,548,880 lekë;

- llog. 215 “*Mjete Transporti*” nuk rakordon për vlerën 15,142,508 lekë.

- Inventarizimi i aktiveve të llogarive 31 “*Materiale*”, llog.32 “*Inventar i imët*” dhe llog.218 “*Inventar ekonomik*” ka filluar pas mbylljes së vitit ushtrimor 2023 dhe ka përfunduar pas hartimit të PF dhe mangësi në dokumentacion. Vlera kontabël në total e aktive të këtyre 3 llogarive nuk rakordon për shumën 28,854,348 lekë me vlerën e tyre së bashku të paraqitur në bilanc.

- Nga analiza e gjendjes së llog. 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*” rezulton se në gjendjen e saj ekzistojnë rreth 51 aktive në vlerën 257,135,966 lekë, të financuara në vlerë të plotë e të kapitalizuara nga kryerja e investimeve dhe janë marrë në dorëzim në vitet

e mëparshme, të cilat në fakt nuk duhet të ishin pjesë e kësaj gjendje në këtë llogari, por duhet të shpërndaheshin në llogaritë e aktiveve përkatëse.

- Gjendja e llog. 467 *“Kreditorë të ndryshëm”* në mbyllje të vitit 2023 është e gabuar, pasi është paraqitur në vlerën 0 lekë, kur në këtë llogari duhej të kontabilizoheshin diferenca e faturave të palikujduara të krijuara si detyrim para vitit 2023 lekë dhe vlera e faturave prej 86,668,986 lekë të Shërbimit postar e UK sha të pa evidentuara në kontabilitet.

- Në gjendjen e llog. 468 *“Debitorë të ndryshëm”* në mbyllje të vitit 2023 është përfshirë vlera prej 28,128,366 lekë e mbartur ndër vite, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson.

- Nga gjendja e llog. 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* rezulton se, nuk është zbritur vlera prej 13,545,856.14 lekë e investimeve të kryera në 11 objekte për ujësjellësa e rrjetin shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji, të cilat Bashkia Kukës nuk ia ka transferuar Ujësjellës Kanalizime SHA Kukës.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- ***Në lidhje me të ardhurat.***

- Të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **204,209,278 lekë** nga taksapaguesit e biznesit dhe institucione shtetërore.

- Të merren masa për hartimin e regjistrave të plotë për taksapaguesit familjarë dhe fermerë me ngarkesat e sakta për taksat dhe tarifatat vendore, në mënyrë që të përcaktojnë saktë detyrimet debitorë për to.

- Të merren masa që të miratohet një plan veprimi për mënyrën e arkëtimit të tarifës së parkimit, për arkëtimin e tarifës së tregut të lirë për vitin 2023 dhe periudhës në vazhdim nëpërmjet lidhjes së kontratave me subjektet e tregut.

- Të marrin masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 85 debitorë në vlerën **24,572,657 lekë**.

- Të marrin masa për arkëtimin e tarifës së përkohshme për investime në bashki në vlerën **560,000 lekë**.

- Të marrë masat për arkëtimin e tarifës së qirasë nga 2 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën **1,215,236 lekë**.

- ***Në lidhje me raportimin financiar dhe saktësinë e pasqyrave financiare.***

- Të marrin masa që, të kryhet procesi i inventarit fizik i aktiveve dhe të kryhet shqyrtimi i dokumentacionit financiar arkivor i ish-komunave dhe ish-bashkisë, për identifikimin e plotë dhe evidentimin e AAGJM-ve të institucionit me vlerat e tyre. Gjithashtu të marrë masa që të kryejë veprimet e sistemit në kontabilitet të AAGJM, duke saktësuar gjendjet e llogarive të klasës 21 në aktiv të bilancit dhe duke ribërë klasifikimin e saktë të aktiveve në llogaritë përkatëse sipas nomenklaturës llogarive të planit kontabël publik, të bëjë rakordin e inventarëve të tyre si dhe përcaktimin e plotë të vlerës së plotë të çdo aktivi që nga vlera fillestare me gjithë shtesat dhe pakësimet, shoqëruar me korrektimet kontabël për amortizimet, si dhe duke i finalizuar me evidentimin e tyre aktiv për aktiv në librin historik të hartuar sipas formatit të përcaktuar ligjor.

- Të merren masa që, të kryhen veprimet në kontabilitet për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të detyrimeve ndaj të tretëve në llogaritë e klasës 4, duke kontabilizuar të gjitha faturat e mbërritura për blerje mallrash e shërbimesh të papaguara, me qëllim që pasqyrat financiare në fund të vitit ushtrimor të japin një informacion të saktë e të besueshëm në lidhje me detyrimet afatshkurtra.

- Të kryhen procedurat ligjore për transferimin tek “Ujësjellës Kanalizime Kukës” sh.a të AAGJM-ve, që i përkasin gjendjes së llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, dhe më pas të kryhen veprimet sistemuese kontabël, duke i reflektuar ato në pasqyra financiare të mbylljes së vitit 2024.

▪ ***Në lidhje me administrimin dhe menaxhimin e pronave***

- Bashkia Kukës ***inventarizimin, përditësimin dhe regjistrimin e aseteve në ASHK*** Bashkia Kukës nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave për 13 NJA **Kolsh, Arrën, Bushtricë, Topojan, Malzi, Shtiqën, Kalis, Gryk-Çajë, Shishtavec, Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Zapod**, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave të paraprake apo fillestare të pronave të miratuara. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim të pa hipotekuar të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Vendore Kukës.

- Të merren masa që, për subjektet, e licencuara nga MIE të hartojë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pa zbritura nga fondi pyjor, t’i drejtohet subjekteve me leje minerale të bëjë kërkesën për zbritje nga fondi pyjor. Ndërsa për rastet e 13 shoqërive që kanë mbyllur aktivitetin e prodhim-nxjerrje minerali të kërkohet kompensim të sipërfaqeve të pyllëzuara.

- Të marren masa për 13 rastet e shoqërive që ushtrojnë aktivitet HEC dhe 10 rastet e shoqërive që ushtrojnë aktivitet prodhim dhe nxjerrje minerali, të rishikohen e të vihen në efikasitet, duke lidhur kontrata qiraje për sipërfaqet që shfrytëzojnë.

- Të merren masa për revokimin e 2 kontratave e lidhura të qiradhënies me persona fizik me nr.73prot., datë 02.06.2023 dhe nr.48prot., datë 13.03.2023 për mosplotësim dokumentacioni në ofertat e paraqitura dhe për rastet e dhënies me qira të aseteve, që para se të merret vendimi i Këshillit bashkiak të kryhen dëgjesa publike. Ofertat duhet të shoqërohen me dokumentacion të plotë, sipas kërkesave të DSA. Ndërsa kontratat duhen të shoqërohen me procesverbalin e dorëzimit të parcelave që jepen me qira dhe kontrata mbi 9-vjet duhet të jenë të noterizuara.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

Opinion i auditimi financiar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Kukës për vitin e ushtrimor 2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmitë mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një **opinion të modifikuar me rezervë** për llogaritë vjetore të vitit 2023 të subjektit Bashkia Kukës, pasi veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi (kriteret) Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së

përgjithshme”, por konstatohen raste keq klasifikimi të llogarive apo raste të mospërputhshmërisë, të cilat janë anomali materiale, por jo të përhapura në llogaritë vjetore të Bashkisë Kukës.

Baza për opinionin:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e këtij raporti. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen dhe dhënien e opinionit të auditimit, duke marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 23,455 mijë lekë.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese për pasqyrat financiare të vitit 2023 janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për dhënien e **opinionit të modifikuar me rezervë¹, ku ka rezultuar se anomali janë materiale, por jo të përhapura** sipas përshkrimit të çështjeve të mëposhtme:

- Referuar të dhënave të kontabilitetit dhe analizës së llogarive të AAGJ rezulton se, mungojnë inventarët fizik dhe inventarët kontabël nuk rakordojnë me gjendjet në bilanc të llogarive:

- llog. 202 “*Studime dhe kërkime*” nuk rakordon për shumën 7,420,514 lekë për to nuk është llogaritur amortizim;

- llog.210 “*Toka, Troje, Terrene*” nuk rakordon për vlerën 202,600,645 lekë;

- llog.211 “*Pyje, Plantacione*” nuk rakordon për vlerën 22,186,849 lekë;

- llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” nuk rakordon për vlerën 377,725,348 lekë;

- llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” nuk rakordon për vlerën 767,282,166 lekë;

- llog. 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” nuk rakordon për vlerën 54,548,880 lekë; llog. 215 “*Mjete Transporti*” nuk rakordon për vlerën 15,142,508 lekë;

- Inventarizimi i aktiveve të llogarive 31 “Materiale”, llog.32 “Inventar i imët” dhe llog.218 “Inventar ekonomik” ka filluar pas mbylljes së vitit ushtrimor 2023 dhe ka përfunduar pas hartimit të Pasqyrave Financiare (PF) dhe me mangësi në dokumentacion. Vlera kontabël në total e aktiveve të këtyre 3 llogarive nuk rakordon për shumën 28,854,348 lekë me vlerën e tyre së bashku të paraqitur në bilanc.

- Nga analiza e gjendjes së llog. 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*” rezulton se në gjendjen e saj ekzistojnë rreth 51 aktive në vlerën 257,135,966 lekë, të financuara në vlerë të plotë e të kapitalizuara nga kryerja e investimeve dhe janë marrë në dorëzim në vitet e mëparshme, të cilat në fakt nuk duhet të ishin pjesë e kësaj gjendje në këtë llogari, por duhet të shpërndaheshin në llogaritë e aktiveve përkatëse.

- Gjendja e llog. 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në mbyllje të vitit 2023 është e gabuar, pasi është paraqitur në vlerën 0 lekë, kur në këtë llogari duhej të kontabilizoheshin diferenca e faturave të palikujduara të krijuara si detyrim para vitit 2023 dhe vlera e faturave prej 86,668,986 lekë e Shërbimit postar dhe UK sh.a. të paevidentuara në kontabilitet.

1. Sipas **Manualit të Auditimit Financiar** të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 246, datë 22.12.2022, kapitulli VI, fq 55: “**Një opinion i kualifikuar/modifikuar me rezervë** duhet të shprehet kur audituesi ka marrë evidenca të mjaftueshme të auditimit dhe konstaton se ka gabime materiale te pasqyrat financiare ose nëse audituesi nuk mund të marrë evidenca të përshtatshme për aspektet e auditimit. (ISSAI 1700.7)”.

- Në gjendjen e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2023 është përfshirë vlera prej 28,128,366 lekë e mbartur ndër vite, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson.

- Nga gjendja e llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezulton se, nuk është zbritur vlera prej 13,545,856 lekë e investimeve të kryera në 11 objekte për ujësjellësa dhe rrjetin shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji, të cilat Bashkia Kukës nuk ia ka transferuar Ujësjellës Kanalizime sh.a. Kukës.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot. 1082/1, datë 11.09.2024, i ndryshuar me shkresën nr. prot. 1082/2, datë 09.10.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 11.09.2024 deri në datë 18.10.2024, në subjektin Bashkia Kukës për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 u krye auditimi “Mbi auditimin financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

I. Sh, përgjegjës grupi;

M. B, auditues;

L. Gj, auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objekti dhe qëllimi i auditimit: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që, ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Kukës.

Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Projekt Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kukës, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me

korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Kukës.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Kryetari i Bashkisë Kukës (*Administratori i Përgjithshëm*), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Kukës, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.²

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të bashkisë Kukës dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar je me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, alokimi i

² Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 15

fondeve dhe transaksionet financiare.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Kukës është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm publik*”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”; udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; udhëzimin e MF nr.22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “*Për miratimin e manualit të MFK*”; Urdhri i Ministrit të Financave nr. 100, datë 16.10.2017 “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, ligjet vjetore të buxhetit me udhëzimet në zbatim të tyre, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*”; ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*”; ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*”.

- Në fushën e mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare: ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; udhëzimi i MF nr. 08, datë

09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022; udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e prokurimeve publike: ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e menaxhimit të aseteve: ligji nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”; ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”; ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”; VKM nr.537, datë 28.02.2021 “Për përcaktimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim konpesues në rastin e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore” i ndryshuar me VKM nr.267, datë 27.04.2023. VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”; Marrëveshja e nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 15.07.2022 me objekt “Krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizimeve”; VKM nr. 59, datë 26.1.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore park kombëtar (kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore” dhe me VKM nr. 60, datë 26.1.2022, VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar; Udhëzimit nr. 13, datë 26.04.2018, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

Standardet e auditimit. ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

Mtodat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*³. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen

³ ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërcave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkojnë fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- Verifikimi i transaksioneve - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- Intervistimi - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (aktkonstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të aktkonstatimeve u përgatit Projektraporti i Auditimit. Me kthimin e përgjigjes nga subjekti i audituar pas shqyrtimit të projektraportit me observacione nga grupi i auditimit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Auditimi në Bashkinë Kukës u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt u evidentuan disa të meta e dobësi në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në drejtim të raportimit financiar, të menaxhimit

të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, menaxhimin, inventarizimin dhe hipotekimin e pronave/aseteve.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektivit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave për shpenzimet dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Historik i zhvillimit ekonomik: Lëvizjet demografike të popullsisë drejt zonave urbane, vihen re dhe në Kukës. Degët kryesore të ekonomisë janë bujqësia, ku klima e favorshme lejon kultivimin e të gjitha bimëve e drufrutorëve, blegtoria dhe shërbimet. Kukësi është i pasur me burime të shumta natyrore, tokësore dhe nëntokësore. Pyjet dhe kullotat komunale zënë një sipërfaqe të konsiderueshme, ku përveç lëndës drusore, ka edhe mjaft bimë mjekësore. Një tjetër burim kryesor të ardhurash për banorët e këtij rajoni përbën edhe turizmi malor dhe historik, si dhe industria e mineralit të kromit në minierat private.

Sfidat me të cilat përballlet: Bashkia përballlet me një sërë sfidash të rëndësishme janë: Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve; Ndërhyrja në infrastrukturën e rrugëve dytësore të qytetit dhe fshatrave përreth, mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe shëndetësore; Mbështetja dhe nxitja më tej e turizmit, rritja e të ardhurave nëpërmjet politikave fiskale dhe menaxhimin e mirë të resurseve që ka kjo bashki; Ripërtëritja e jetës kulturore dhe artistike të zonës, por dhe zhvillimi i ambienteve dhe aktiviteteve sportive për rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale të qytetit, etj.

Rëndësia e këtij auditimi është sepse, auditimi është pjesë jetike e një sistemi rregullator, që ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga Bashkia Kukës si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimi për integritet dhe vlerat etike”

- Bashkia Kukës ka hartuar dhe miratuar Kodin e Etikës me Urdhrin nr.305, datë 30.03.2022, por rregullat e etikës janë përfshirë edhe në Aneksin nr.2 të Rregullores së Brendshme, në të cilat përcaktohen parimet që duhet të respektojë çdo punonjës në punën e tij, si dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë

institucion. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste.

- Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, janë hartuar rregulloret, të miratuar sipas Urdhrit nr.4 datë 24.04.2017 “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Kukës”. Në Rregulloren e Brendshme në nenin 7 dhe 8 janë përcaktuar veprimet që parandalohen, të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes, ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Punës. Nuk është hartuar raporti i Njesisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, në datën që dërgohet pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të interesave (ILDKPKI). Nuk ka programe trajnimi nga Bashkia Kukës për integritetin dhe sjelljen, por në vitin 2023, punonjës të Bashkisë Kukës kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

- Ankesat nga jashtë depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e marrëdhënieve me publikun), duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë dhe përgjigja kthehet nga drejtoritë përkatëse. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 5, të Rregullores së Brendshme.

-Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip, 1herë në 6 muaj. Duhet theksuar se për një pjesë të punonjësve të rekrutuar nuk janë kryer procedurat e statusit të shërbimit civil.

Në lidhje me parimin 2 *“Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”*

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë saj. Theksojmë se rregullorja e brendshme duhet të ndryshojë me qëllim përfshirjen e detyrave të reja për gjithë punonjësit sipas strukturës së miratuar.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e raportimit të realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkrëtarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë. Për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, por është hartuar Plani i Menaxhimit të MFK-se për vitin 2023 i miratuar me datë 09.02.2023.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE si edhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 *“Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”*

- Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Kukës me Urdhërin e Kryetarit nr.328, datë 05.04.2022.

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimet e menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.
- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e PBA-së, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të takimeve me grupet e interesit, si dhe për dëgjesat me publikun.
- Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike, por nuk ka urdhër të veçantë të Kryetarit së Bashkisë.
- Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike.
- Është hartuar planë i veprimit për menaxhimin financiar për periudhën e auditimit të vitit 2023 për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilin përfshihen aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.
- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Organigrama e Bashkisë Kukës është e ndërtuar në mënyrë të tillë që 3 nën/Kryetarët, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Kabinetit, Drejtori i Auditit të Brendshëm dhe 14 Administratorët e NJA varen direkt nga Kryetari, ku edhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë.

Për vitin 2022-2023 me Vendim të Kryetarit nr. 04, datë 13.01.2022 “Për miratimin e strukturës organike, kategorive/klases së pagave të administratës së Bashkisë Kukës” me 760 punonjës të miratuar dhe strukturë: Kabineti dhe Drejtoritë përkatëse ndarë sipas sektorëve.

- Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Po kështu edhe në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, kurse objektivat për secilin punonjës janë të pasqyruara në vlerësimet e punës.
- Bashkia Kukës ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore (kukes.gov.al).
- Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “*Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave*”

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.
- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka plan vjetor të rekrutimit. Për çdo punonjës të rekrutuar është krijuar dosja personale, e cila përmban të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: certifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Gjithashtu nga Bashkia Kukës nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve, e cila ti dërgohej Shkollës Shqiptare të Administratës Publike apo në institucione të tjera jashtë bashkisë (Organizata, Agjenci sipas fushave të ndryshme) për trajnimin e stafit me qëllim ngritjen profesionale sipas nevojave. (mungojne të dhënat për trajnime jashtë institucionit).

-Për bashkinë, nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. Me Vendim të KB nr. 80, datë 23.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 1/36 date 04.01.2023 është miratuar nga Këshilli Bashkiak "Buxheti për vitin 2023" dhe Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025. NA për vitin 2023 ka nxjerrë Urdhërin nr.129, datë 08.02.2023 e ngritjes së GMS dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve nr.266, datë 10.03.2022.

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

-Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e ngarkuar me menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit si dhe eprori direkt i Bashkisë Kukës, për vitin 2023 nuk kanë përfunduar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil për të gjithë ata punonjës të administratës, të cilët janë të punësuar në pozicionet që trajtohen sipas statusit të nëpunësit civil.

Në rastet e largimeve dhe emërimeve në pozicionet drejtuese për vitin 2023 sipas strukturës Organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës.

Në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë nuk është ngritur asnjë komision nga titullari aktual për inventarizimin e dosjeve, procedurave apo praktikave në proces të personelit që është larguar apo marrjen me procesverbal sintetik të dosjeve dhe punës të personelit që kanë filluar ushtrimin e detyrës.

Për periudhën objekt auditimi në Bashkinë Kukës, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale.

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”

Në Rregulloren e Brendshme janë parashikuar “funksionet/detyrat që delegohen” në zbatim të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollin i institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi ka patur Urdhëresa për delegime detyrash.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat

standarte për përgatitjen e PBA të njërive të Qeverisjes Vendore” Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2023 për hartimin e PBA 2023-2025 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me 24 anëtarë dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve për 8 programe buxhetore me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.129, datë 08.02.2023.

Në rregulloren e Brendshme nuk janë përcaktuar komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë:

Nga verifikimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si:

-Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar

-Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

- Eshtë miratuar nga Kryetari Udhëzimi i Brendshëm Nr.205, datë 03.04.2023 dhe Urdhëri nr.509, datë 14.08.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”.

- Janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6 “*Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva*”

Bashkia Kukës në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva në planet operationale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si edhe me vizionin dhe misionin e njësisë të përcaktuara në Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Kukës. Këto objektiva bëhen të njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtuara Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjuesat me publikun.

-Bashkia Kukës ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila rishikohet çdo 3 vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Por nuk ka marrë masa për implementimin dhe më tej kontrollin e funksionimit të kësaj strategjie. Në evidencat e vëna në dispozicion nga Bashkia Kukës nuk u evidentuan analiza konkrete sa i përket kontrollit të funksionimit të strategjisë së miratuar të riskut në nivel programi, aktiviteti, lidhur me nivelin e realizimit të objektivave, evidentimit të problematikave që patën ndikim në realizimin e objektivave dhe përgatitjen e planit të masave për minimizimin e riskut lidhur me to në të ardhmen. Nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, mungon vlerësimi për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, “Regjistri dhe matrica e riskut” si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.2, “Menaxhimi i riskut”.

-Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7 “*Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave*”

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësive publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se “Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësive publike. Në përmbushje të përgjegjësisë të tij, nëpunësi autorizues mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës”.

Me Urdhër të Titullarit për përcaktimin e kordinatorit të GMS-se nr.26, datë 06.02.2023 është hartuar regjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi i risqeve për Drejtoritë përkatëse. Duke mos u përcaktuar kordinatori i riskut dhe grupi i menaxhimit të riskut si pasojë dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

Për funksionimin e GMS nga Bashkia Kukës nuk është nxjerrë urdhër për zëvendësimin e anëtarëve të GMS të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet financiare me këtë institucion dhe si rrjedhojë grupi i menaxhimit strategjik nuk ka kryer funksionin prej muajit mars të vitit 2023.

Në lidhje me parimin 8 “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrim”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Në lidhje me parimin 9 “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Kukës në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi ose riorganizimi i këtij institucioni, nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

III. Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10 “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative etj).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Nëpunësi Zbatues/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA). Struktura e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit përbëhet nga 11 punonjës, 1 drejtor, 2 përgjegjës Sektori (Sektori i Shpenzimeve dhe Sektori i Buxhetit).

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Detyrat dhe përgjegjësit e NJHDT dhe KVO janë parashikuar edhe në kapitullin V të Rregullores së Brendshme.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit, e cila konfirmohet me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

- Në Rregulloren e Brendshme neni 83 “Specialist i Protokoll-Arkivit” përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.

Në lidhje me parimin 11 “*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë*”

- Bashkia Kukës nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike. Faqja Zyrtare e bashkisë Kukës në internet ka një sistem back-up.

Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Në lidhje me parimin 12 “*Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave*”

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, nuk ka plan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, pavarësisht se është bërë identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.

-Në nenin 56 të rregullores së brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.

-Për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi merret Drejtoria e Planifikimit të Territorit. Këto funksione janë përfshirë në detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre drejtorive neni 105 i rregullores së Brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. Pasqyrat Financiare konfirmohen nga NA dhe NZ.

Nga AB ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare kryhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”). Nga audit i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13 *“Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”*

Drejtuesit në Bashkinë Kukës kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacionale, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe dërgohen në MFE. Ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Raportet për detyrimet e konstatuara, por të papaguara hartohen çdo muaj dhe paraqiten në degën e thesarit çdo 4 muaj në MFE. Stoku i detyrimeve të prapambetura për vitin 2023 është në vlerën 77,953 mijë lekë. Detyrimet dhe të drejtat janë paraqitur në llog. e klasës 4 në aktiv dhe pasiv të bilancit të PF.

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës për mbajtjen e kontabilitetit operon me program excel, pa e dubluar programin SIFQ. Regjistrimet apo evidentimi në SIFQ i transaksioneve financiare së bashku me dokumentet shoqërues kryhet nga Specialistët e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program Excel që e menaxhon Drejtoria e Tatim-Taksave. Për çdo muaj dhe vit kryhen aktrakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet. Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankës. Për lëvizjet AAGJM-ve mbahen dokumenta financiarë dhe për çdo vit kryhet inventarizimi i tyre. Për aktivet e amortizuara dhe pa vlerë përdorimi kryhen procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Në lidhje me parimin 14 *“Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor”.*

Në lidhje me parimin 15 *“Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm”* ka faqen e saj zyrtare.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet 6 “Marrëdhëniet me mediat”, neni 7 “Afishimi i akteve juridike”, neni 14 “Praktika shkresore”,

neni 28 “Marrëdhëniet me të tretët” neni 29 “Marrëdhëniet me Publikun”, neni 30 “ Zyra e shërbimit me një ndalesë”.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit herë pas here, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar.

Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike zyrtare. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe të menaxherëve me këshillin Bashkiak janë mbajtur procesverbale. Në faqen e Bashkisë Kukës janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura, planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e Bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si edhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

- Ka raporte periodike dhe publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

-Nga Bashkia Kukës kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Kukës ka një faqe zyrtare ëeb në të cilën paraqiten informacione për publikun (kukesi.gov.al).

V. Komponenti “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16 *“Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”*

- Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore lidhur me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave.

- **Për vitin 2023** me shkresën nr.prot.684, datë 24.02.2023, të cilat janë dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave “Deklarata për cilësinë e e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Kukës dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë në këto drejtime kryesore:

1. Vlerësimi i performancës së Aparatit të Bashkisë nëpërmjet monitorimit.
2. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përshkrimit në pyetësin e vetëvlerësimit. Veprimtaria e sektorit të Auditit të Brendshëm në investimin e drejtorive të Aparatit të Bashkisë dhe njësive vartëse.
3. Rekomandimet të metat dhe mangësitë e gjetura.

4. Hartimi i plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe sidomos për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që përshkruhen në aktivitete e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në përshkrimin e komponentëve të MFK.

Pjesë e Deklaratës është edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo realizohet nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësisë, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

- Në Bashkinë Kukës mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të KBFP-së për vitin 2023.

- Në Bashkinë Kukës aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

- Një nga drejtimet e monitorimit lidhet me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Për vitin 2023 janë audituar nga Auditi i Brendshëm Drejtoria e Tatim-Taksave, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe disa kontrole me tematika të ndryshme.

Në lidhje me parimin 17 *“Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”*

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

- Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

-Bashkia Kukës nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Një problematikë tjetër e evidentuar është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.

Është një plan vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit por nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

-Mungon ndarja e proceseve të punës dhe përcaktimi i detyrave që ka secili punonjës. Drejtoria Juridike nuk bashkëpunon me drejtoritë e tjera si Drejtoria e Financës, Drejtoria e Aseteve etj, për të zbatuar detyrat funksionale.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se: *“Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.”*

Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Në këto kushte, evidentohet se Bashkia Kukës nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Kukës nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT-së. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike. Faqja Zyrtare e Bashkisë në internet ka një sistem back-up. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT-së për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Komponenti “Informimi dhe komunikimi”

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Komponenti “Monitorimi”

- Në Bashkinë Kukës mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

-Në Bashkinë Kukës aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi

mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

-Njësia e Auditit të Brendshëm ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara. Bashkia Kukës nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

-Nuk janë ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Gjurmë auditimi ka vetëm Drejtoria Ekonomike.

2.1.2 Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm;

2.1.3 Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm është si vijon:

- Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Kukës;
- Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
- Programimi i auditimeve për vitin 2023;
- Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
- Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
- Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.
- Vlerësimi i auditimeve.

Auditimi u fokusua kryesisht në këto çështje:

- Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm/Komitetit të Auditimit, niveli profesional i audituesve, çertifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme, bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, niveli i raportimit në këtë drejtori,
- Realizimi i treguesve të planifikuar nga DAB,
- Sigurimi i cilësisë së auditimit, me qëllim vlerësimin nëse veprimtaria e auditit të brendshëm është në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet e auditimit, konkretisht ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm”, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e NJAB të Bashkisë Kukës, rezultoi se:

➤ **Organizimi dhe Funksionimi:** Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e NJAB në sektorin publik” Bashkia Kukës ka ngritur NJAB.

Për vitin 2023 NJAB ka funksionuar me 1(një) drejtor i Drejtorisë së Auditimit dhe me 2(dy) auditues sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Titullari i Bashkisë me vendim nr. 4, datë 13.01.2022, “Për miratimin e struktureve organike, kategorive/klasës së pagave të administratës së Bashkisë Kukës” për vitin 2022, strukturë e cila është funksionale edhe për vitin 2023.

Konkluzion: Për vitin 2023 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1(një) drejtor i Drejtorisë së Auditimit dhe 2 (dy) auditues strukturë e përcaktuar sipas strukturës organizative të miratuar nga Titullari i Bashkisë me vendimin nr.4, datë 13.01.2022, “Për

miratimin e strukturës organike, kategorive/klasës së pagave të administratës së Bashkisë Kukës” për vitin 2022, strukturë e cila është funksionale edhe për vitin 2023.

Pra, struktura e miratuar me VKB-në nr.4, datë 13.01.2022 është në mbështetje të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3 e cila përcakton se: “Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3(3) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Në strukturën e Njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.”

Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Kukës të miratuar me urdhrin e titullarit nr. 257, datë 26.06.2019, me urdhrin nr.328, datë 05.04.2022 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Kukës” mbi bazën e të cilës funksionojnë të gjitha strukturat e Bashkisë.

Struktura e NJAB, niveli i arsimit, certifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

Nr	Periudha 2023	Funksion i	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	S. S.	Drejtues	I lartë DIND	40	13	Cert.2012	PO
2	L. R.	Auditues	I lartë Master Profesional	1,5	1,5	JO	JO
3	E. G.	Auditues	I lartë Master Profesional	12	1,5	JO	JO

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes të punonjësit të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se, Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është certifikuar dhe ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnime të vijueshme për kualifikimin profesional, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenet 11, “Punësimi i Auditit të Brendshëm” neni 19 “Certifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”.

➤ **Komiteti i Auditimit të Brendshëm**, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësisë së saj, nuk është krijuar nga Bashkia Kukës.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e organit që bashkërendon, harmonizon dhe monitoron veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, me shkresën nr.13893.,prot, datë 22.07.2019 “Mbi krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, ka ofruar asistencë në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Kukës nëpërmjet propozimit të disa hapave konkretë.

Referuar ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 12, pika b, përcakton se *Titullari i Njësisë Publike është përgjegjës për vendimmarrjen e krijimit të Komitetit të Auditimit.*

Nga auditimi rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se: “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

- duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
- duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
- duke vlerësuar përshatshmërinë e burimeve të auditimit;
- duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
- duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;

dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

Konstatim: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë.

- **Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik**

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në Bashkinë Kukës, e cila është miratuar nga titullari me urdhërin nr 201, datë 13.03.2023.

- **Kodi i Etikës për Audituesit e Brendshëm.**

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kodin e Etikës për Audituesit e Brendshëm” në Bashkinë Kukës, e cila është miratuar nga titullari me urdhërin nr 200, datë 13.03.2023.

- **Planet Strategjike dhe Vjetore:**

Ne mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Për vitin 2023 me shkresën nr.714, datë 26.09.2022 është miratuar plani strategjik për vitet 2023 - 2025 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2023.

Plani Vjetor 2023 dhe Plan Strategjik për vitet 2023 - 2025 është dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.5540 prot, datë 26.09.2022 në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Njësia e AB në Bashkinë Kukës mbulon me auditim 35 subjekte: ku 21 subjekte janë drejtori, inspektoriate e tjera (të listuara në planin strategjik të vitit 2023-2025) në juridiksionin e Bashkisë Kukës, si Qendra Kulturore e Bashkisë, OJF Klubi Shumësportësh, Konvikti “20 Dëshmorët”, Drejtoria e MZSH (Mbrojtjes nga Zjarri e Shpëtimi), Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Inspektoriati i Policisë Bashkiake si edhe **14 subjekte Njësi Administrative** në juridiksionin e Bashkisë Kukës si: NJA Shtiqën, NJA Tërthore, NJA Bicaj, NJA Zapod, NJA Shishtavec, NJA Topojan, NJA Ujmisht, NJA Bushtricë, NJA Kalis, NJA Grykë Çajë, NJA Surroj, NJA Malzi, NJA Kolsh dhe NJA Arrën.

Konstatim: NJAB në hartimin e këtyre planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuar, dhe ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve. Në planin vjetor 2023 dhe planin strategjik 2023-2025 është parashikuar edhe Ujësjetllës sh.a Kukës, institucion për të cilin është hartuar dokumentacioni për fillimin e këtij misioni auditimi si autorizim (për fillim mision auditimi), njoftim (për fillim mision auditimi) si dhe programi i angazhimit të auditimit) për këtë shoqëri, mision auditimi i cili nuk është kryer për arsye se kjo Shoqëri ka ngritur në strukturën e saj organike edhe NJAB.

• **Realizimi i Planeve Vjetore:**

Për vitin 2023 janë parashikuar gjithsej 12 auditime në Bashki dhe Ujësjiellës sh.a. Kukës, ku sipas llojit janë të përputhshmërisë, të kombinuar dhe të zbatimit rekomandimeve të vitit 2022.

Për vitin 2023 në planin vjetor të miratuar me shkresën Nr.714 prot, datë 26.09.2023 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Njësia e auditimit të brendshëm ka planifikuar 12 auditime gjithsej.

Janë realizuar gjithsej 7 misione auditimi në 7 subjekte auditimi, ku 12 janë auditime të planifikuara, 1(një) mision auditimi është për zbatim rekomandimesh të vitit të mëparshëm 2022, nuk është kryer auditimi i detyrimeve të prapambetura për arsye se është audituar nga audituesit e KLSH-së. Realizimi i matur duke marrë parasysh auditimet e realizuara në raport me auditimet e planifikuara në numër është në masën 60 %. Realizimi e auditimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financë	Kombinuar	Performancë	Zb.Rek
1	Viti 2023	12	7	1		5		1

Raportimi: Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkinë Kukës për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB te Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr.592 prot, datë 13.02.2024, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Kukës për vitin 2023. Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Nr	Subjektet e Audituara	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjit hsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbi me Këshill imi	Angazhi me me kërkesë të titullarit	Angazhi me të përfund uara	Angazh ime në proces
			A. të përpuths hmërisë	A. të perfor mancë	A. financi are	A. tek. Informa cionit	A. të kombi nuara				
1	Zbatim Rekomandimesh	1					1			1	
2	Drejtorja e të Ardhurave Pronave Lejeve	1	1							1	
3	Drejtorja e Finances dhe Buxhetit	1	1							1	
4	Drejtorja e Burimeve Njerëzore	1	1							1	
5	Drejtorja e Shërbimit Social dhe Shoqëror	1					1			1	
6	Njesia Administrative Topojan	1					1			1	
7	Shoqëria Rajonale e UKK-së	1	1							1	

➤ **Gjetje-Rekomandimet**

Për vitin 2023, Nga auditimet janë evidentuar 265 gjetje, për të cilat janë dhënë 227 rekomandime, nga të cilat 24 rekomandime për përmirësimin e sistemit, 12 rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor, 175 janë rekomandime të karakterit organizativ , 13 rekomandime për arkëtime, të cilat në mënyrë të përmblodhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
4	Viti 2023	227	0	1	226	13	0	0	13
	TOTALI	227	0	1	226	13	0	0	13

Të dhënat e gjetjeve sipas fushave të auditimit dhe subjekteve të auditimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	SUBJEKTI AUDITUAR	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE NE NUMER										
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblyeme, trajtime, komisione	Fondet e sig. Shoq, sig.shendetesore, përkulidësitë shodërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit pronës, pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Sistemet e legalizimeve, urbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit, subvencioneve	Të tjera	Audituesi mbuluar me auditim
1	Zbatim Rekomandimesh		21								116	3
2	Drejtoria e të Ardhurave Pronave Lejeve				42						0	"
3	Drejtoria e Finances dhe Buxhetit										7	"
4	Drejtoria e Burimeve Njerëzore		3								18	"
5	Drejtoria e Shërbimit Social dhe Shoqëror										56	"
6	Njesia Administrative Topoan					3					20	"
7	Shoqëria Rajonale e UKK-së										0	"
	Totali	0	24	0	42	3	0	0	0	0	217	

Ndjekja e zbatimi i rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të A.B. NJAB u ka dërguar Aktverifikime për zbatimin e rekomandimeve të vitit 2023 me shkresa zyrtare të protokolluara tek zyra e Protokoll-Arkivit, po ashtu u janë dërguar edhe Raportet Finale njësive të audituara për informim e zbatim mbi nivelin e zbatimit të tyre dhe në auditimin e radhës është çështja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore. Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2023	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT				
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimit e sistemeve	Rekomandime të përmirësimit e kuadrit ligjor	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera
1.	Drejtoria e të Ardhurave Pronave Lejeve	20	20	20	0	0	0	0	16	0	4
2	Drejtoria e Finances dhe Buxhetit	12	12	12	0	0	0	0	8	4	0
3	Drejtoria e të Burimeve Njerëzore	17	17	17	1	0	0	0	5	0	12
4	Drejtoria e Shërbimit Social dhe Shoqëror	35	35	35	0	12	0	0	35	0	0
5	Njesia Administrative Topoan	10	10	10	0	0	0	0	10	0	0
6	Shoqëria Rajonale e UKK-së	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Totali	94	94	94	1	12	0	0	74	4	16

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se nga 94 masa të rekomanduara, janë pranuar 0 rekomandime, nga këto 1 rekomandim është zbatuar, 12 rekomandime janë proces zbatimi, ndërsa rekomandime të pa zbatuara janë 81.

Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka marrë në shqyrtim dhe ka mbikëqyrur procesin e monitorimit e ndjekjes së rekomandimeve të dhëna nga struktura e auditimit të brendshëm. Grupi i auditimit nuk ka analizuar arsyet e mosrealizimit të rekomandimeve të mëparshme. Referuar Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.13.3 përcaktohet se: *Një njësi e mirë menaxhuar vendos procedura për t'u siguruar se çdo rekomandim i bërë nga njësi e AB, zbatohet ashtu siç duhet. Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkëpunim me menaxhimin cakton një punonjës me përvojë që të evidentojë të gjitha rekomandimet e bëra nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë dhe*

informojë për progresin që është bërë për zbatimin e tyre. Kjo do të ndihmojë që të sigurohet se përmirësimi i kontroleve të brendshme është përgjegjësi e menaxhimit të njësisë publike dhe jo rol i Njesisë së Auditimit të Brendshëm”.

➤ **Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.**
Nga auditimi i detajuar i dosjeve të auditimeve të kryera në subjektet:

Për vitin 2023 dosjet:

1. Drejtoria e të Ardhurave Pronave Lejeve
2. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
3. Drejtoria e të Burimeve Njerëzore
4. Drejtoria e Shërbimit Social dhe Shoqëror

Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:

- a-Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit;
- b-Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit dhe Raportit Final nga audituesit;
- c- Bazueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standartet e auditimit, rezultoi se:
 - Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016.
 - Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12. Hapi 11, “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”.
 - Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare në përgjithësi është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit.
 - Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 është hartuar, miratuar dhe dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MFE me shkresën nr. 592 prot, datë 13.02.2024.
 - Në dosjet e auditimit mungon “Memo e planifikimit”
 - Në fund të procesit të auditimit mungojnë letrat e punës për secilin auditues të cilat duhet të përfshijnë regjistrimin e punës së audituesit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemit.
 - Nuk dokumentohet procesi i ndarjes së detyrave/sistemeve për tu vlerësuar, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës në kundërshtim me pikën 4.1.1.2 të MAB, dokument ky i nevojshëm për vlerësimin e punës për secilin auditues.
 - Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve nuk është dhënë asnjë opinion apo analizë mbi arsyet e mos realizimit të rekomandimeve të mëparshme si dhe mungon konkluzioni nga audituesit për masat që duhet të marrë menaxhimi i subjektit të audituar për realizimin e tyre.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion u konstatua se:

- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Audituesit e brendshëm nuk janë trajnuar në fushat e planifikuara në Planin Strategjik të Auditimit, si edhe nuk kanë kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe

Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut;

-Për vitin 2023, konstatohet se nuk është realizuar plani i auditimeve për vitin 2023.

- Nuk dokumentohet procesi i ndarjes së detyrave/sistemeve për tu vlerësuar, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës në kundërshtim me pikën 4.1.1.2 të MAB, dokument ky i nevojshëm për vlerësimin e punës për secilin auditues.

- Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve nuk është dhënë asnjë opinion apo analizë mbi arsyet e mos realizimit të rekomandimeve të mëparshme si dhe mungon konkluzioni nga audituesit për masat që duhet të marrë menaxhimi.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit”.

2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;

2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave, shpenzimeve, bazuar në nivelin e fondeve të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (faturat e palikujduara të shoqërohen me listë, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve të FZSHS-së dhe ministrive të linjës etj.

Për auditimin e pikës 2 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Dokumenti i hartimit të PBA 2023-2025 dhe miratimi i tij dhe gjithë korespondenca me Ministrinë e Financave.

2.Dokumenti i programimit buxhetit vjetor për vitin 2023 të miratuara me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE dhe korespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë vitit buxhetor.

3. Aktrakordimet periodike me Degën e Thesarit shpenzimet dhe të ardhurat.

4. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve si fatura të palikujduara dhe vendime gjyqësore.

6. Dokumentet e hartuara periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023.

8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel” si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret, shpenzimet të ardhurat etj.).

➤ Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin, e PBA dhe programimit të buxheteve vjetore

• Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2023-2025

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025 rezultoi se:

- Për realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë urdhri i titullarit nr. 129, datë 19.02.2023, “Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik për vitin 2023”; urdhri nr.209, datë 20.03.2023 për ndryshimin e koordinatorit të GMS, vendimi nr 53, datë 20.03.2023 për ndryshimin e koordinatorit të GMS, dhe vendimi i titullarit nr. 30, datë 31.10.2023 “Për ndryshimin e kordinatorit te GMS”. Janë ngritur EPM sipas programeve me urdhrin nr.266, datë 10.03.2022, “Për ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA 2023 - 2025”, i ndryshuar me urdhrin nr.583, datë 13.07.2022 dhe me urdhrin nr. 657, datë 30.08.2022.

- Është përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor, i cili është miratuar me VKB nr.73 datë 24.12.2021 dhe konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Kukës me shkresën nr.1/63 prot., datë 06.01.2022 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33/1.

- Janë miratuar në Këshillin Bashkiak tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA 2023-2025 me VKB nr.19, datë 31.03.2022 dhe konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Kukës me shkresën nr.282/1prot, datë 05.04.2022 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar neni 34/6. Tavanet përfundimtare të PBA 2023-2025 janë miratuar me VKB nr.49, datë 31.08.2022, si dhe VKB nr.79, datë 23.12.2022 “Për ndryshimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2023-2025” (miratuar me VKB nr.49 datë 31.08.2022).

Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA rezultoi se, në përgjithësi ishin respektuar kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 25.02.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes PBA të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit e MF nr.8 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” dhe të Udhëzimit plotësues të MFE nr.23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”

- Përgatitja dhe hartimi i PBA 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023, është bërë nëpërmjet Instrumentit të Planifikimit Financiar (FPT), shoqëruar me relacionin shpjegues, i cili është miratuar me VKB nr.80, datë 23.12.2022 dhe VKB nr.81, datë 23.12.2022. Ky dokument është dërguar në MF me shkresën nr.prot.45 prot., datë 09.01.2023 dhe përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimia me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme. (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).

- Në dokumentin e PBA janë përcaktuar drejtimet e politikave të shpenzimeve, sipas funksioneve, duke u bazuar në analizën e zërave të buxhetit në tre vitet e fundit dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin PBA-ja 2023-2025.

- Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e planifikimit urban. Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm me VKB nr.41, datë 29.06.2022, e cila është dërguar me shkresën nr.3836, datë 01.06.2022 “Dërgim draft dokumentin e parë të PBA 2023-2025 dhe ka marrë rekomandimet e Ministrisë së Financave;

- Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në Bashkinë Kukës, nëpërmjet procesit të “buxhetimit me pjesëmarrje”, për të cilat ishin mbajtur relacionet dhe protokollet përkatëse.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2023-2025 dhe buxheteve vjetore, rezultoi se janë hartuar mbi bazën e informacionit të mbledhur si përgjigje e shkresës nr.396, datë 06.04.2022 “Hartimi i kërkesave buxhetore të PBA 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023” dhe shkresës nr.796 prot., datë 06.09.2022 “Dërgim i ndryshimeve në kërkesat buxhetore, të PBA 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023 (nëse keni ndryshime konform tavanëve përfundimtare buxhetore)” të dërguar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe kërkesave buxhetore nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve që mbulojnë këto programe, si dhe nga kërkesat e mbledhura në dëgjuesën publike të datës 30.05.2022 dhe konsultimit publik të datës 15.12.2022.

- Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet përfundimtare të PBA 2023-2025 miratuar me VKB nr.49, datë

31.08.2022, si dhe VKB nr.79, datë 23.12.2022 “Për ndryshimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2023-2025” (miratuar me VKB nr.49 datë 31.08.2022) janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjeçar sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat.

- Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2023

Për vitin 2023, buxheti vjetor si viti i parë i PBA-së 2023-2025 është miratuar me Vendim të KB nr. 80, datë 23.12.2022 dhe është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 1/36, datë 04.01.2023, i paraqitur në tabelën e mëposhtme:

lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	146,581,000	
2	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar	382,071,000	
3	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	257,773,000	
4	Te ardhura te trashëguara	72,698,000	
5	Ndihma ekonomike dhe Invaliditeti	670,000,000	
1	Paga (600)		437,028,000
2	Sigurime shoqërore (601)		71,143,000
3	Shpenzime operative (602)		215,661,000
4	Fondi Rezervë		7,000,000
5	Inv. (230 +231) nga Te ardhurat + Tr.Pakushtëzuar + Tr.Specifike		128,291,000
6	Transferta (604 – 609) Ndihma ekonomike dhe Invaliditeti		670,000,000
Totali i buxhetit (Lekë)		1,529,123,000	1,529,123,000

Sipas tabelës së mësipërme buxheti i vitit 2023 është miratuar i balancuar dhe pa deficite, ku të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 1,529,123,000 lekë dhe trashëgimet e fondeve nga viti i mëparshëm është në vlerën 72,698,000 lekë. Buxheti vjetor 2023 nuk ishte hartuar i plotë, sipas standardeve të buxhetimit dhe ndryshimet janë bërë që në 3-mujorin e parë të vitit buxhetor.

Mbështetur edhe në aktrakordinin e thesarit nr.81 prot., datë 30.01.2023, fondet e trashëguara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Diferencë nga transferta e pakushtëzuar	20,144	
2	Grant i pashpërndarë(detyrimet e prapambetura)	36,884	
3	Të ardhura të trashëguara	36,068	
4	Të çelura të papërdorura	53,302	
5	Grant i trashëguar		
6	Transferte e pakushtëzuar sektoriale e papërdorur	72,878	
8	Paga (600)		17,015
9	Sigurime shoqërore (601)		3,541
10	Shpenzime operative (602)		64,987
11	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë		3,997
12	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushtëz+tr.Specifike		39,359
13	Investime ne proces		90,377
Totali i buxhetit		219,276	219,276

- Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2023, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti Fillestar 2023 VKB nr.80, dt 23.12.2022	PBA 2023-2025 VKB Nr.81, datë 23.12.2022	Ndryshimi
1	Paga (600)	437,028,000	437,028,000	0
2	Sigurime shoqërore (601)	71,143,000	71,143,000	0
3	Shpenzime operative (602)	215,661,000	215,661,000	0

Nr	Emërtimi	Buxheti Fillestar 2023 VKB nr.80, dt 23.12.2022	PBA 2023-2025 VKB Nr.81, datë 23.12.2022	Ndryshimi
4	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë	7,000,000	7,000,000	0
5	Investime (230+231) nga Te ardhurat + Tr.Pakushtezuar + Tr.Specifike	128,291,000	128,291,000	0
6	Ndihma ekonomike dhe Invaliditeti	670,000,000	670,000,000	0
Total i planit buxhetor		1,529,123,000	1,529,123,000	0

Burimi: Nga përpunimi i të dhënave nga KLSH sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Referuar tabelës së mësipërme, nga krahasimi i planit fillestar të buxhetit 2023 me vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm 2023-2025, rezulton se nuk ka diferencë mbi tavanin e përcaktuar në PBA, duke iu përgjigjur tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025.

➤ 2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

- Në degën e Thesarit Kukës janë dërguar fondet buxhetore për shpënzime të ndara në plane mujore dhe 3-mujore, sipas shkresës nr.58, datë 09.01.2023 “Kërkesë për mbushje buxheti për vitin 2023” dhe shkresës nr.352, datë 31.01.2023 “Kërkesë për mbushje të ardhura të veta buxheti për vitin 2023” të shoqëruara me shkresat e Ministrisë Financave nr.22954, datë 14.12.2022 “Dërgohet transferta e pakushtezuar dhe sektoriale për vitin 2023” dhe VKB nr. 80, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023” bashkë me konfirmimin nga Institucionit i Prefektit. Në këto dokument është bërë ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit të Bashkisë Kukës dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Kukës dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Kukës dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Kukës.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB. Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2023 paraqiten në Aneks:

000/lekë

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2023			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë

	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	146,581	238,411	384,992	Art. 600 Paga	437,028	29,081	466,109
Të ardhurat e veta të trashëgu nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2023	72,698		72,698	Art. 601 Sig. shoqërore e shëndetësore	71,143	9,475	80,618
Total të ardhurat e veta	219,279	238,411	457,690	Art. 602 Shpenzime operative	215,661	38,986	254,647
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	382,071		382,071	Art. 604 Transfer korrente të brendshme			-
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike				Art. 606 Transfe të buxhet famil e individ	670,000	236,842	906,842
Transferta kushtëzu e çelur për llogari të vitit 2023	670,000	467,019	1,137,019	Art. 230-231 Investime	128,291	391,046	519,337
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2023	257,773		257,773	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	7,000		7,000
Total të ardhurat nga transfertat e buxheti shtet	1,309,844	467,019	1,776,863				
TOTALI TË ARDHURAVE	1,529,123	705,430	2,234,553	TOTALI I SHPENZIMEVE	1,529,123	705,430	2,234,553

Nga sa më sipër konstatojmë se, për vitin 2023 kanë ndodhur 5 ndryshime me VKB, nga të cilat tre vendime kanë autorizuar alokim fondesh me burim të ardhurat e veta, 1 vendim për akordim të fondeve Këshilli i Qarkut Kukës dhe 1 vendim për alokim fondesh nga ministritë e linjës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se 3 shtesa kanë ndodhur në 3-mujorin e parë të vitit, ndërkohë që ky alokim fondesh nuk duhet të ndodhte, kur buxheti sapo është miratuar, si dhe nuk është përcaktuar se kush zë shpenzimesh është pakësuar apo objekte të investimit. Këto investime janë parashikuar në PBA si objekte investimi, por pa vlerë krahas objekteve të investimit me vlerë. Rastet e 3 shtesave paraqiten më poshtë:

- Me VKB nr.03 date 20.01.2023 “Asfaltim i rrugës së fshatit Kalimash”, për vitin 2023 në shumën 8,000,000 lekë, financim i siguruar nga të ardhurat e trashëguara të Bashkisë Kukës nga viti 2022 të pa planifikuara për tu përdorur gjatë 2023.

- Me VKB nr.19, datë 30.03.2023 “Bashkëfinancimi për projektin ReLOaD2, me numër projekti 00115510, për shumën 530,970 lekë” financim i siguruar nga të ardhurat e veta të Bashkisë Kukës viti 2023.

- Me VKB nr.20, datë 30.03.2023 “Për përdorimin e transfertës së Këshillit Qarkut Kukës për hartim projektsh 10,000,000 lekë”, financim i siguruar nga nivele të tjera qeverisje nga buxheti i pushtetit vendor - Këshilli Qarkut Kukës.

➤ **Auditim mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Kukës, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur aktrakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Kukës, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2023, të miratuar me Vendim të KB ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Kukës u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar aktrakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	2023		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	466,109	453,886	97.38%
2	Sigurime shoqërore 601	80,618	76,608	95.03%
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	253,160	168,170	66.43%
4	Nd/Ekonom invalid 606	906,842	895,655	98.77%
5	Investime (230/231)	508,713	462,361	90.89%
8	Fond i emergjencave civile min 17 (604)	19,111	11,747	61.47%
	Rehabilitim ure Cernaleve (investime 231)		9,665	
	Ndihme ne raste fatkeqësie (604)		2,082	
	Totali	2,234,553	2,068,427	92.5%

Referuar të dhënave mbi nivelin i realizmit të treguesve të buxhetit rezulton se fondet buxhetore për shpenzime për vitin 2023 janë realizuar në shumën 2,068 milionë lekë nga

2,237 milionë lekë të programuar ose në masën 92,5 %. Në këtë realizim ka ndikuar realizimi i ulët i fondeve për shpenzime operative llog.602 në masën 66.7%, nga 263 milionë lekë të planifikuar janë realizuar në fakt 170 milionë lekë. Ky fakt tregon se fondet për shpenzime operative janë planifikuar me rezervë dhe jo mbi baza reale, pavarësisht se një pjesë e fondeve, siç pretendohet ka ardhur si rezultat i vonësve në procedurat e prokurimit publik për mallrat dhe shërbimet, duke sjellë lidhjen më vonësë të kontratave dhe mosrealizimin e tyre brenda vitit buxhetor 2023.

Peshën specifike më të madhe në shpenzime e zënë shpenzimet për “Ndihmë ekonomike dhe paaftësinë” llog.606 në masën 43%, shpenzimet për investime llog.230-231 në masën 23% dhe shpenzimet për paga llog.600 në masën 22%.

- Shpenzimet për investime llog.231 nga buxheti i Bashkisë dhe nga transferta e kushtëzuar janë realizuar në masën 472 milionë lekë nga 520 milionë lekë të planifikuara, ose në masën 90.8 %. Ky zë rezulton i realizuar në këtë masë për arsye të mosrealizimit të punimeve për investime, kryesisht ato të financuara me fondet e akorduara nga ministritë e linjës dhe të ardhurat.

2.2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave

- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës

a. Në relacionin shpjegues të PBA 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023, që është bërë nëpërmjet Instrumentit të Planifikimit Financiar, të dërguar në MFE me shkresën nr.45 prot., datë 09.01.2023 në totalin e shpenzimeve të bashkisë Kukës për vitin 2023 është planifikuar fondi rezervë dhe kontigjenca me vlerë 7,000,000 lekë, ose në masën 3% sipas përcaktimit ligjor, fond i cili është pasqyruar në FPT (Instrumentin e Planifikimit Financiar). Nga auditimi rezulton se fondi rezervë dhe fondi për kontigjencën është planifikuar në shumën 7,000,000 lekë, fonde të cilat nuk janë përdorur gjatë vitit financiar 2023.

b. Me shkresën nr.prot. 86/6 datë 27.03.2023 nga Ministria e Mbrojtjes (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile) janë akorduar fonde për emergjencë civile në vlerën 8,487,428.07 lekë. Në bazë të VKM nr.260, datë 27.04.2023 “Për miratimin e projekteve fituese të financuara nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe utoritetet kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetqeverisjes vendore” bashkisë Kukës i është akorduar fondi për projektin: “Rehabilitimi i urave në fshatrat Cernalevë, Gështenjë, Orgjost” në vlerën 10,624,287.30 lekë, duke përfituar një fond emergjencash në total në vlerën 19,111,715.37 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se këto fonde janë përdorur:

Emergjencë Civile	Fondi i Akorduar	Fondi i Realizuar	Teprica
Emergjencë Civile(Fatkeqesi të ndryshme natyrore)	8,487,430	2,081,850	6,405,580
Rehabilitim i Urave Geshtenje,Orgjost	10,624,290	9,665,390	958,900
TOTALI	19,111,720	11,747,240	7,364,480

Fondet e emergjencave për raste të fatkeqësisë janë:

- Me VKB nr.54, datë 17.11.2023 për dëmshpërblim në rastin e fatkeqësisë për djegie shtëpie z.B. D. në vlerën 50,200 lekë.

- Me VKB nr.41, datë 24.08.2023 për dëmshpërblim në rastin e fatkeqësisë për djegie shtëpie z.K. A. në vlerën 1,379,996 lekë.

- Me VKB nr.17, datë 30.08.2023 për dëmshpërblim në rastin e fatkeqësisë për djegie shtëpie z.S. K. në vlerën 222,682 lekë.

- Me VKB nr.8, datë 27.02.2023 për dëmshpërblim në rastin e fatkeqësisë për djegie shtëpie z.S. M. në vlerën 140,636 lekë.

- Me VKB nr.60, datë 22.12.2023 për për dëshmipërblim në rastin e fatkeqësisë për djegie shtëpie z.A. Gj. në vlerën 288,334 lekë.

• **Raportet e Monitorimit.**

Për vitin 2023, janë përgatitur tre raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 6.

- Për vitin 2023 me shkresën nr.2474, datë 12.07.2023 “Dërgim dokumentacioni” është dërguar VKB nr.33, datë 07.07.2023 “Për miratimin e Raportit periodik 4-mujor të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën janar-prill 2023”, bashkëlidhur raporti i monitorimit.

- Me shkresën nr. 358 prot., date 08.11.2023, është dërguar VKB nr.49, datë 02.11.2023 “Për miratimin e Raportit periodik 8-mujor të monitorimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën janar-gusht 2023”, bashkëlidhur raporti i monitorimit.

- Me shkresën nr.prot.1993, datë 11.04.2024 “Dërgim dokumentacioni” është dërguar VKB nr.22, datë 03.04.2024 “Për miratimin e raportit të konsoliduar të zbatimit të buxhetit Janar-Dhjetor 2023”, bashkëlidhur raporti i monitorimit.

Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit janë të plota me të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pikat 10, 12, 28, 29, 48.

➤ ***Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizimit të të ardhurave***

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Në regjistrin e riskut të Bashkisë Kukës, dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.prot.684, datë 24.02.2023 “Dërgim dokumentacioni” në mes dokumentash të tjera ka dërguar “Regjistrin e Riskut për Bashkinë Kukës për vitin 2023, nënshkruar me datë 16.02.2023” në faqen nr.15 pika 61 jepet përshkrimi i riskut: “Përmbushja në kohë dhe masën e duhur i pagesave, detyrimeve përkatëse ndaj të tretëve, si dhe marrja e masave për sigurimin dhe çeljen e fondeve në përputhje me llogaritë financiare (si rezultat i detyrimeve të akumuluar para 2015 nga Bashkia Kukës, vështirësohet përmbushja e misionit)”, ndërsa në rubrikat e tjera “nevoja për kontrole të mëtejshme” shprehet se është e nevojshme të bëhen kontrollet e brendshme për vendosjen e prioritetëve në likuidimin me këste të detyrimeve dhe kontrolli permanent i shpenzimeve të kryera. Ndërsa në rubrikën “veprime për të adresuar boshllëqet” është e nevojshme që të bëhet: “raportimi periodik në MF për detyrimet e prapambetura dhe kërkesa për fonde shtesë, rakordimi me MF dhe Drejtorinë e të Ardhurave të Bashkisë për sigurim fondesh etj.

• Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikujduara

Me fondet e vitit buxhetor 2023, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Bashkia, nga Ministritë e linjës apo FZHS, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve. Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht paraqitet si vijon:

Bashkia/Këshilli i Qarkut	Detyrimi i mbetur deri në dhjetor 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Diferencë (Fakt-Plan)
BASHKIA KUKËS	164,622,100	98,053,000	33,284,550	33,284,550	0

"Detyrimi i mbetur deri në dhjetor 2023" është i rakorduar me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit, këtë e vërteton aktrakordimi me Degën e Thesarit Kukës, ndërsa shuma e planifikuar për tu likuiduar gjatë vitit 2024 përfshin shtesën e fondit në transfertën e pakushtëzuar të përgjithëshme që do të përdoret vetëm për likuidimin e detyrimeve të prapambetura sipas Aktit Normativ nr.6, datë 14.12.2023.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës "Detyrimet e prapambetura", sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2023:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31.12.2022 (lekë)	Detyrimi i krijuar në periudhën vitit 2023 (lekë)	Total detyrime (lekë)	Shlyerja e detyrimeve 2023 (lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023 (lekë)
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës e FZHS		35,949,383	35,949,383		35,949,383
b. Investime nga Bashkia	31,715,306	10,969,243	42,684,549	24,624,000	18,060,549
INVESTIME :	31,715,306	46,918,626	78,633,932	24,624,000	54,009,932
Mallra dhe shërbime	52077987	840000	52,917,987	28974805	23,943,182
Totali :	83,793,293	47,758,626	131,551,919	53,598,805	77,953,114

Burimi: Nga të dhënat e subjekti sipas pasqyrave

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë që në fund të vitit 2023 janë të palikujduara gjithsej 73 fatura me vlerë 77,953,114 lekë. Detyrimet e prapambetura të detajuara paraqiten në analizën e llog.401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to".

Konkluzion: Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2023 Bashkia Kukës ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën prej 164,622,100 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2023 rezultoi se është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.09, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit". Detyrimet e prapambetura për vitin 2023 të raportuara në Ministrinë e Financave me shkresën nr.prot.1063, datë 22.02.2024 "Dërgim i raportit të vetëvlerësimit, situata financiare janar-dhjetor 2023" paraqiten në tabelën e mëposhtme:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJQV-në	Stoku/Shpenzim e vjetore faktike të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0	2,068,427,870	
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëvesh financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		

b,1	Marrëvesh financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	164,622,100		7.96%
Llog ekon	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqësore	928,120		
4864200	Det.Prap. Sherbime	5,033,252		
4864201	D.P.Energji Elektirke	86,668,986		
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	6,436,884		
4864400	Det.Prap. Investime	54,009,932		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	2,469,478		
4864900	Det.Prap.Te Tjera	0		
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore	5,600,346		
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet	0		
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal	3,475,102		
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	164,622,100	2,068,427,870	7.96%

Analiza e vlerës së e detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2023 dhe raportuar në MFE paraqitet më poshtë:

a. Me financim nga bashkia Kukës

Fatura të pa likuajuara në vlerën 42,003,731 lekë, të detajuara në mënyrë analitike në tabelën e mësipërme.

b. Me financim nga ministritë e linjës

Detyrime të ministrive të linjës në shumën 35,949,383 lekë, pjesë e faturës nr. 79, datë 8.09.2023 për projektin e investimit me objekt “Optimizimi i furnizimit me uje faza II”.

Konkluzion: Shuma prej 35,949,383 lekë e raportuar në mënyrë të gabuar si detyrim i papaguar i përket faturës nr. 79, datë 18.09.2023 në vlerë 46,837,818 lekë, e cila në fakt është likuajuar në mënyrë pjesore në vlerën 45,792,818 lekë përkatësisht me urdhër-shpenzimin nr.834, datë 29.12.2023 në vlerën 35,904,383 lekë dhe urdhër-shpenzimin nr 695, datë 21.11.2023 në shumën prej 10,888,435 lekë nga fondet e çelura nga AKUM për vitin 2023. Pra në fakt kemi detyrime të papaguara në shumën prej 128,717,717 lekë.

Krijimi dhe akumulimi i detyrimeve të papaguara në fund të vitit ushtrimor është në papajtueshmëri me Udhëzimin e MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Shenim: Të dhënat e tabelës së mësipërme tregojnë se shuma më e madhe e detyrimeve të prapambetura i takon detyrimeve të prapambetura për energji elektrike, ku në fakt tek kjo shifër përfshihen edhe detyrimet e prapambetura ndaj Shërbimit postar dhe detyrimet e prapambetura ndaj Ujësjellës Kanalizimeve për faturat e ujit të pijshëm, të cilat së bashku kapin vlerën 86,668,986 lekë, por duhet theksuar se Bashkia Kukës nuk i ka të regjistruara në sistemin e thesarit as në kontabilitet në kohën e krijimit të tyre. Për likuidimin e tyre është lidhur një akt-marrëveshje, kurse disa prej tyre janë në procese gjyqësore.

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (të akumuluar) në fund të vitit 2023 paraqiten në vlerën 164,622,100 lekë. Peshat specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 7.96 % kundrejt fondeve faktike. Kjo situatë tregon se,

Bashkia Kukës konsiderohet në situatë normale e gjendjes financiare, pasi nuk e ka kaluar pragun 15% në fund të vitit ushtrimor 2023. Gjithashtu raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore faktike për shpenzime është nën nivelin prej 25%, kështu duke mos u konsideruar institucion në vështirësi financiare sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Udhëzimit e MFE nr. 35, datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 33.

• Celja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financim nga transfertat e pakushtëzuar, ardhurat e veta të Bashkisë Kukës, si dhe transfertat të kushtëzuara.

- Për **vitin 2023** janë planifikuar fonde për investime në shumën **520,088,830 lekë** (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + transfertat sektoriale + të ardhura+transfertat e kushtëzuara), realizuar dhe likuiduar në vitin 2023 në vlerën 472,026,180 lekë. Realizimi në masën 90.8 % i investimeve ka ardhur si rezultat i disa shkaqeve si: nuk është prerë faturë nga operatori fitues dhe nuk janë realizuar të ardhurat. Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në Aneks. Investimet në projekt buxhetin e vitit të parë të PBA 2023 janë programuar në vlerën 128,291 mijë lekë, ku përfshihen 17 projekte me vlerë nga të cilat janë realizuar 9 projekte dhe si prioritet 73 projekte pa vlerë nga të cilat janë realizuar 2 projekte.

- Nga auditimi i procedurave të ndjekura në vitin 2023 për realizimin dhe financimin rezultoi se Bashkia Kukës ka financime të investimeve nga ato ardhurat e veta, nga bashkfinancimet me buxhetin e shtetit dhe Ministria e Arsimit dhe investime nga AKUM për sistemin kanale të ujërave të zeza, (të paraqitura në tabelën e mësipërme) rezultoi se janë ndjekur hapat:

Për çdo procedurë prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka konfirmimin me nënshkrim elektronik, datën e depozitimit dhe të miratimit nga Dega e Thesarit Kukes. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ në Degën e Thesarit Kukes dhe të shtrira në kohë sipas financimit brenda vitit buxhetor koherent. Kontrata është regjistruar e plotë me qëllim pagesën e saj në afatet mujore, pra nuk janë regjistruar kontratat të copëtuara, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për investimet që programimi i fondeve për financim dhe likuidimi i të cilave është i shpërndarë në 3 vite janë zbatuar afatet e likuidimit sipas kontratës.

Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar urdhër-blerja, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit dhe elementet e tjera të procedurave të prokurimit dhe dokumentave financiare.

➤ Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Realizimi i buxhetit për vitin 2023 sipas burimit të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Nr	Emërtimi	2023		
		Plani (Lekë)	Fakt (Lekë)	Realizimi %
1	Paga 600	466,108,535	453,885,658	97.4%
	Transferta e Kushtëzuar	14,837,628	14,373,368	96.9%
	Transferta e Pakushtëzuar	252,496,320	251,385,470	99.6%
	Transferta Specifike	198,764,857	188,126,820	94.6%
	Të ardhura të veta	9,730	-	0.0%
2	Sigurime shoqërore 601	82,181,288	76,608,571	93.2%
	Transferta e Kushtëzuar	1,699,948	1,655,608	97.4%
	Transferta e Pakushtëzuar	45,592,410	44,767,990	98.2%
	Transferta Specifike	34,887,120	30,184,973	86.5%
	Të ardhura të veta	1,810	-	0.0%
3	Shpenzime operative 602 + Fondi Rezerve	251,598,226	168,169,794	66.8%

	Transferta e Kushtëzuar	14,757,620	9,655,140	65.4%
	Transferta e Pakushtëzuar	83,358,260	69,704,920	83.6%
	Transferta Specifike	78,382,936	29,972,760	38.2%
	Të ardhura të veta	75,099,410	58,836,974	78.3%
4	Transferime 604	8,487,430	2,081,850	24.5%
	Transferta e Kushtëzuar	8,487,430	2,081,850	24.5%
	Transferta e Pakushtëzuar	-	-	-
	Transferta Specifike	-	-	-
	Të ardhura të veta	-	-	-
5	Ndihmë Ekonomike Paaftësia 606	906,842,072	895,655,817	98.8%
	Transferta e Kushtëzuar	906,842,072	895,655,817	98.8%
	Transferta e Pakushtëzuar	-	-	-
	Transferta Specifike	-	-	-
	Të ardhura të veta	-	-	-
6	Investime 230-231	519,337,180	472,026,180	90.9%
	Transferta e Kushtëzuar	330,915,020	326,624,362	98.7%
	Transferta e Pakushtëzuar	4,404,000	4,404,000	100.0%
	Transferta Specifike	20,717,770	18,527,070	89.4%
	Të ardhura të veta	163,300,390	122,470,748	75.0%
	Totali i shpenzimeve 2023 Bashkia Kukës (Lekë)	2,234,554,731	2,068,427,870	92.6%

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se nga të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 “paga e shpërblime” për vitin 2023 në masën 0 %
- Shpenzimet në artikullin 601 “kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore” për vitin 2023 në masën 0%.
- Shpenzimet në artikullin 602 “shpenzime operative për mallra e shërbime” për vitin 2023 në masën 78.3%.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “investime” për vitin 2023 në masën 75 %.

Duke u nisur nga burimi i financimit **për vitin 2023** shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 181,308 mijë lekë ose në masën 8.77 %, nga transferata e pakushtëzuar dhe transferata specifike në shumën 637,074 mijë lekë ose në masën 30.80 %, nga transferata e kushtëzuar në shumën 1,250,046 mijë lekë ose në masën 60,43% .

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. M. I. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit (për periudhën 01.01.2023 -06.06.2023, z. R. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit (për periudhën 06.06.2023-15.06.2024) në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe z. Z. J. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit.

2.2.5. Burimi krijimit të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve tatimore. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuar progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Për auditimin e pikës 2.5 u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Kukës për miratimin e paketave fiskale të vitit 2023. Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj.
- Dokumentacioni i Drejtorisë të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, database në excel i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues.
- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga specialistët e pranim-faturimit dhe specialistët e kontrollit në terren
- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga inspektorët e borxhit shoqëruar me evidenca dhe korrespondencat zyrtare për ndjekjen e debitorëve.

- Kontrata, aktmarrëveshje, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat. Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, si për taksat ashtu edhe për tarifave vendore, të mbajtura nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.
 - Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2023.
 - Aktrakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara.
 - Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.
 - Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.
 - Korrespondenca me institucione të ndryshme për të ardhurat që i takojnë Bashkisë.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, konstatohet se rregullshmëria e veprimeve të kryera nga sektori i të ardhurave, për vjeljen e taksave, tatimeve dhe të ardhurave të tjera, paraqitet si më poshtë:

• Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2023 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr.80, datë 23.12.2022 dhe me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.191 datë 01.04.2020 “Për miratimin e strukturës, organigrama e bashkisë Kukës, viti 2023”, ku përfshihet edhe Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave. Kjo Drejtoria për vitin 2023 ka funksionuar me një strukturë organike me 1 Drejtor, 5 përgjegjës sektorësh dhe 12 specialistë. Drejtoria ka 5 sektorë: Sektori i Kontabilizimit dhe Shërbimit ndaj Taksapaguesve me 4 punonjës, Sektori i Lejeve, Licencave dhe Kontrollit të Territorit me 6 punonjës, Sektorit i Borxhit me 3 punonjës, Sektori i Menaxhimit të Ndërmarrjeve Publike dhe Tregjeve Publike me 3 punonjës dhe Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit me 2 punonjës.

• Të dhëna mbi numrin e subjekteve, regjistrimet dhe mbylljet

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, Bashkia Kukës në lidhje me numrin e subjekteve aktiv, regjistrimeve të reja dhe atyre që kanë kërkuar mbyllje aktiviteti, rezultojnë se:

Për periudhën objekt auditimi, gjendja dhe ndryshimet mbi statusin e subjekteve paraqitet: **në vitin 2023 janë 678 subjekte biznesi**, nga të cilat 499 subjekte të biznesit të vogël, 148 subjekte të biznesit të madh dhe 31 institucione, Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Kukës në mënyrë të përmblendhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

NR	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të vitit	Biznese të palicencuar deri në fund të vitit ushtrimor
1	BIZNESI VOGEL	2023	481	23	5	499	-
2	BIZNESI MADH	2023	148	0	0	148	-
3	INSTITUCIONE	2023	31	0	0	31	-
	TOTALI	2023	660	23	5	678	-

Konkluzion: Sipas të dhënave të Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave (DAPPLL) në territorin e Bashkisë Kukës kryejnë aktivitet ekonomik 678 subjekte private të biznesit të madh dhe të vogël. Nga verifikimi i dokumentacionit nga DAPPLL rezultojnë se, nuk është kryer identifikimi i saktë i bizneseve, që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Kukës, pasi nuk ka bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukës për të saktësuar numrin e bizneseve, që kryejnë aktivitet ekonomik në territorin në administrim të saj. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave nuk disponon një regjistër të saktë dhe të plotë të taksapaguesve biznesi i vogël dhe biznesi i madh, pasi nuk janë kryer përditësimet çdo vit me të dhënat e DVTT, Kukës nëpërmjet korespondencës zyrtare. Mungojnë dosjet për çdo biznes me dokumentacionin përkatës. Këtë veprimë në kundërshtim me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i

ndryshuar, neni 19 pika 2 dhe Rregulloren e Bashkisë Kukës të miratuar me Urdhrin e Titullarit nr.328, datë 05.04.2022, neni 67/n dhe neni 68/m.

• Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2023, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Kukës është miratuar me VKB nr. 83, datë 23.12.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës”. Referuar planit vjetor të miratuar dhe bazuar në aktraktordimet me Degën e Thesarit Kukës, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për Bashkinë Kukës për 2023 paraqitet i detajuar në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

NR. Llogaris	Pershkrimi	Plan 2023	Fakt 2023	Real %
	Te Ardhurat Tatimore			
7020200	Taksa e ndertesës	15,183,286.20	15,580,314.25	102.6
7020100	Taksa e tokës bujqësore	568,328.37	4,577.00	0.8
7035025	Taksa e Truallit	1,721,866.16	636,037.32	36.9
7002200	Takse mbi biznesin e vogel (TTHF)	4,362,060.94	322,915.00	7.4
7035003	Takse e ndikimit ne inf. nga ndertimet e reja.	5,740,116.57	4,403,499.15	76.7
7035005	Taksen per fjetjen ne hotel	344,373.23	152,495.00	44.3
7204101	Taksa e Automjeteve DRSHTTR	10,331,196.97	30,940,719.00	299.5
7029200	Mbi shtijen e pasurise se paluajtshme	229,582.15	181,191.20	78.9
7035009	Taksa per tabelen	3,099,359.09	993,785.00	32.1
7035008	Taksa per reklamat	3,099,359.09	1,917,000.00	61.9
7035035	Taksa vendore e perkohshme (miniera dhe hec)	27,559,494.36	21,922,441.00	79.5
7003009	Taksa te tjera (MZSH)	2,869,776.94	10,000.00	0.3
	SHUMA	75,108,800.08	77,064,973.92	102.6
	Te Ardhurat Jotatimore			
7109101	Të ardhurat nga menaxhimi i aseteve (TARIFE KONTRATE)	8,803,537.54	2,840,589.30	32.3
7115420	Të ardhurat nga qerat	1,286,977.69	465,000.00	36.1
7115500	Te tjera Gjobat, sekuestri, polic etj.	344,373.23	205,000.00	59.5
7115499	Kamate Vonesa	344,373.23	726,428.00	210.9
7035046	Të ardhura të tjera DEB TF (sekuestri zhdemtime)	482,122.53	19,230,254.38	3,988.7
7204102	Të ardhura te tjera (renta minerare+24 oresh+linje tensioni)	3,443,732.32	1,615,965.00	46.9
7204102	Lek te kthyer ne thesar & Tatim mbi te ardhurat personale	-	27,914,507.00	
	SHUMA	14,705,116.55	52,997,743.68	360.4
	Te Ardhurat nga Tarifat etj.			
7110501	Tarifa pastrimi	24,048,885.00	30,266,402.80	125.9
7035013	Tarifa e gjelbërimit	2,869,776.94	2,821,318.00	98.3
7035023	Tarifa e ndricimit	1,836,657.24	2,380,089.00	129.6
7032002	Tarifa e zenies hapsires publike	773,955.39	666,744.00	86.1
7035039	Tarifa lejes së transportit, Certificate, Autorizim	1,147,910.77	4,348,604.00	378.8
7111007	Tarifa e parkimit	585,434.49	80,000.00	13.7
7035032	Tarifa e administrimit (Urbanistike e te ndrysh.)	11,479,107.74	1,145,000.00	10.0
7111001	Tarifa e Ushqimit Kopshte e Femijeve	5,073,765.62	5,284,095.00	104.1
7111002	Tarifa e Ushqimit Cerdhet e Femijeve	1,377,492.93	1,755,368.00	127.4
7111003	Tarifa e Ushqimit Konvikti	688,746.46	232,146.00	33.7
7114900	Tarifa e kulturës dhe sportit (bileta, etj)	229,582.15	-	-
7113010	Tarifa për shërbime (tregje,leje te perkoh. etj)	2,869,776.94	-	-
7110599	Tarifa e perkoheshme per ivestime ne bashki	3,443,732.32	380,000.00	11.0
7035007	Tarifa e Sherbimit Veterinar	342,685.13	-	-
7211100	SPONSOR		341,738.00	
	SHUMA	56,767,509.13	49,701,504.80	87.6
	TOTALI	146,581,425.76	179,764,222.40	122.6

Burimi: Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Për vitin 2023 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Kukës paraqitet në masën 122,6%, nga 146,581,425.76 lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 179,764,222.40 lekë (plus 33,182,796.64 lekë). Në këtë realizim kanë ndikuar realizimet në nivele të larta mbi planin i disa zërave të paparashikuara si:

- Të ardhura të tjera DEB TF (sekuestri e zhdemtime) në masën 558.4 %;
- Taksa e Automjeteve DRSHTTR në masën 299.5%;
- Tarifa lejes së transportit, Certificate, Autorizim në masën 378.8%;

- Kthime ne thesar & Tatim mbi te ardhurat personale, sponsorizime etj.

Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave nuk disponon të dhëna për taksapaguesit, pasi derdhjet bëhen nëpërmjet Degës së Thesarit, nga këto institucione si:

- Per tarifën e rentës minerare Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës.

- Për Taksën Vjetore për Qarkullimin e mjeteve të përdorura Drejtorisë së Transportit Rrugor Kukës.

- Për Tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe Tatimin mbi të ardhurat personale Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës.

Gjithashtu është bërë një planifikim jo i saktë mbi baza jo reale i disa taksave dhe tarifave si tarifë pastrimi, ndriçimi, tarifë ushqimi në çerdhe, kamatëvonesat etj, të cilat janë realizuar mbi planin.

Programimin jo të saktë të pa bazuar në kapacitetet reale, duke vendosur vlera të pa argumentuara në mungesë të të dhënave se mbi ç'bazë janë përlllogaritur për çdo taksë dhe tarifë e tregojnë treguesit e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, ku për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin, kështu:

a. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim mbi planin si:

-**Taksa mbi ndërtesën** është realizuar 15,580,314.25 lekë nga 15,183,286.20 lekë e planifikuar ose në masën 102,6%,

-**Tarifa e pastrimit për biznesin** është realizuar 30,266,402.80 lekë nga 24,048,885 lekë e planifikuar ose në masën 125.9%,

- **Tarifa ndriçimi** është realizuar 2,380,089 lekë nga 1,836,657.24 lekë e planifikuar ose në masën 125.9%,

- **Tarifa e ushqimit në çerdhet e fëmijëve** është realizuar 1,755,368 lekë nga 1,377,492.93 lekë e planifikuar ose në masën 127.4%,

- **Tarifa e ushqimit kopshte e fëmijëve** është realizuar 5,284,095 lekë nga 5,073,765.62lekë e planifikuar ose në masën 104.1%,

b. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim të ulët të planit si:

- **Taksa vendore mbi biznesin e vogël** është realizuar 322,915 lekë nga 4,362,060.94 lekë e planifikuar ose në masën 7,4%,

- **Taksa mbi pasurinë e paluajtshme** është realizuar 181,191.20 lekë nga 229,582.15 lekë e planifikuar ose në masën 78.9%,

- **Taksa mbi tokën bujqësore** është realizuar 4,577 lekë nga 568,328.37 lekë e planifikuar ose në masën 0,8%,

- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja** është realizuar 4,403,499.15 lekë nga 5,740,116.57 lekë e planifikuar ose në masën 76.7%,

- **Taksa e tabelës** është realizuar 993,785 lekë nga 3,099,359.09 lekë e planifikuar ose në masën 32.1%,

- **Taksa mbi truallin** është realizuar 636,037.32 lekë nga 1,721,866.16 lekë e planifikuar ose në masën 36.9%.

- **Taksa per fjetjen ne hotel** është realizuar 152,495 lekë nga 80,000 lekë e planifikuar ose në masën 44.3%.

- **Tarifa e parkimit** është realizuar 80,000 lekë nga 344,373.23 lekë e planifikuar ose në masën 13.7%.

- **Tarifa e administrimit (Urbanistike e te ndryshme)** është realizuar 1,145,000 lekë nga 11,479,107.74 lekë e planifikuar ose në masën 10%.

- **Tarifa e ushqimit konvikti** është realizuar 232,146 lekë nga 688,746.46 lekë e planifikuar ose në masën 33.7%.

- **Tarifa për shërbime (tregje, leje të perkohshme etj.)** është realizuar 0 lekë nga 2,869,776.94 lekë e planifikuar ose në masën 0%.
- **Tarifa e shërbimit veterinar** është realizuar 0 lekë nga 342,685.13 lekë e planifikuar ose në masën 0%.
- **Tarifa e perkohshme për investime në bashki** është realizuar 380,000 lekë nga 3,443,732.32 lekë e planifikuar ose në masën 11%.
- **Të ardhurat nga menaxhimi i aseteve (tarifë qiraje)** është realizuar 2,840,589.30 lekë nga 8,803,537.54 lekë e planifikuar ose në masën 36.1%,
- **Të ardhurat nga qiratë e dyqaneve të tregut** është realizuar 465,000 lekë nga 1,286,977.69 lekë e planifikuar ose në masën 36.1%.

Konkluzion: Taksa vendore për ujin rezulton që nuk është përfshirë në parashikimin e te ardhurave për vitin 2023. Gjithashtu kjo taksë nuk është përfshirë në paketën fiskale të miratuar me VKB-në nr. 83, datë 23.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2023”. Bashkia shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit të transferuar në pronësi, që të plotësojë nevojat për ujë për ujitje, të largojë ujin e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit. Për këtë arsye bashkia duhet të sigurojë të ardhura për mirëmbajtjen e mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit, duke përcaktuar dhe mbledhur tarifën e shërbimit të ujitjes. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, Kreu IV, nenet 15-20.

- Taksat dhe tarifave vendore që janë përcaktuar në paketë fiskale dhe në program buxhetor, por kanë realizim në nivel shumë të ulët.

Konkluzion: Tarifa e perkohshme për investime në bashki është realizuar 380,000 lekë nga 3,443,732.32 lekë e planifikuar ose në masën 11%. Në paketën fiskale është përcaktuar tarifë vendore në fushën e ndërtimit Kreu II, pika 4 në të cilën përcaktohet: “Subjektet që realizojnë projekte dhe punë publike pavarësisht se ku e kanë deklaruar selinë e tyre të paguajnë një “Tarifë vendore” për çdo kantier ndërtimi të hapur Brenda territorit të Bashkisë Kukës në raport me kohëzgjatjen e kantierit dhe vlerës së investimit (tab.1 dhe 2). Kjo tarifë do të përfshijë brenda saj dëmtimin në infrastrukturë, ndikimin në mjedis etj si dhe shqetësimet që vijnë komunitetit për shkak të kryerjes së investimeve”. Për subjektet që investojnë nga 5 mil-10 mil lekë tarifa është 100,000 lekë. Për subjektet që investojnë nga 10 mil-50 mil lekë tarifa është 140,000 lekë në vit. Për subjektet që investojnë mbi 100 mil tarifa është 200,000 lekë në vit.” Llogaritja e detyrimit për Tarifën vendore për subjektet që kanë realizuar projekte investimi për vitin 2023 me fondet e bashkisë është si më poshtë vijon:

lekë					
Nr.	Emërtimi i kontratave të investimeve të lidhura për investime mbi 5 mil, viti 2023	Vlera e kantatës/lekë	Operator	Data e kontratës	Detyrimi sipas paketë fiskale
1	Ndërtim i rrugës së Fshatit Kalimash	23,066,834	“O” shpk	24.03.2023	140,000
2	Rehabilitimi i Urës fshat Gështenje- Ogjoz	10,180,188	“G” shpk	12.07.2023	140,000
3	Rehabilitim i gjimnazit Bajram Avdiu, Bica	59,133,864	“D” shpk	04.09.2023	140,000
4	Rehabilitim i qendrës lagje Gostil	24,875,988	“M” shpk	11.04.2023	140,000
	Totali				560,000

Burimi: Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve publike, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit rezultojnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kukës për vitin 2023, për tarifën vendore për subjektet që realizojnë projekte investimi me fondet e Bashkisë Kukës në vlerën 560,000 lekë, për 4 subjekte: “O” shpk në vlerën 140,000 lekë, “G” shpk në vlerën 140,000 lekë, “D” shpk në vlerën 140,000 lekë dhe “M” shpk në vlerën 140,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 5, germa (a), ligjin nr. 139/2015, datë

17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3. germa a,b,ç, me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; nenet 6 dhe 9, me me paketën fiskale 2023, Kreu II, pika 4, nënpika 1 tabela nr.1, me Rregulloren e Bashkisë miratuar me Urdhrin nr.328, datë 05.04.2022, nenet 67/b dhe 68/b.

Kokluzion: Referuar treguesve të programimit dhe realizimit të të ardhurave rezultoi se, janë realizuar në nivel shumë të ulët ose në nivel 0 lekë të disa taksave dhe tarifave:

a. Tarifa për shërbime (tregje, leje te perkoh. etj.) për vitin 2023 është realizuar 0 lekë nga 2,869,776.94 lekë e planifikuar ose në masën 0%. Drejtoria e të ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve Publike dhe Tregjeve publike nuk kanë arritur të mbledhin të ardhura për tarifën e tregjeve publike në administrim të bashkisë për vitin 2023. Në paketën fiskale Kreu II, pika 14 “tarifa e tregut të lirë është 600 lekë në muaj ose 7200 lekë në vit, parashikuar për ta mbledhur Sektori i tregut.

b. Tarifa e shërbimit veterinar për vitin 2023 është realizuar 0 lekë nga 342,685.13 lekë e planifikuar ose në masën 0%. Drejtoria e të ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka siguruar informacion për numrin e therjeve të bagëtive gjatë vitit ushtrimor dhe nuk ka ndjekur procedurat për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e therjes dhe shërbimit për to, duke sjellë të ardhura të munguara.

c. Tarifa e parkimit për vitin 2023 është realizuar 80,000 lekë nga 344,373.23 lekë e planifikuar ose në masën 13.7%. Bashkia Kukës nuk ka një plan të detajuar për mbledhjen e tarifës së parkimit.

Këto veprime ose mos veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore’, neni 5, germa (a), me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3. germa (a, b,ç), me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, nenet 6 dhe 9 “Arkëtimet”, me paketën fiskale Kreu II, pika14 dhe me Rregulloren e Bashkisë miratuar me Urdhër nr.328 ,datë 05.04.2022, neni 67/b, neni 68/b.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. P.G. me detyrë Drejtor i drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave (për periudhën 24.05.2023-vazhdim), z.V. G. me detyrë ish-Shef i Sektorit të Kontabilizimit dhe Shërbimit të Tatimpaguesve (për periudhën 01.01.2023-05.09.2023), z. E. M. Shef i Sektorit të Menaxhimit të Ndërmarrjeve publike dhe Tregjeve publike.

➤ Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor:

- Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2023 .

Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Kukës, rezultoi se ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, për biznesin, taksat dhe tarifën vendore, i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2022** vlera debitorëve është **155,256,316.77 lekë** dhe në fund të **vitit 2023** vlera debitorëve është **204,209,277.98 lekë**. Kjo vlerë është evidentuar në kontabilitet dhe është pjesë e gjendjes së llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresivë paraqitet në Aneks.

Nr	LLOJI I DEBITOREVE	Periudha (1 VJECARE) 31.12.2022 deri me 31.12.2023					
		Lloji i Detyrimeve	Shuma e Detyrimeve Progresiv 2022	Sistmime shtese ne gjendjen e vitit 2022	Shtesa	Pakesime	Shuma e Detyrimeve Progresiv 2023
1	Biznes i Vogel	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndricimi, gjelbrimi, Takse ndertese, Takse table	32,385,114.83		157,958.61	32,543,073.44
2	Biznes i Madh	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndricimi, gjelbrimi, reklame, Tarife leje e licenca, Takse ndertese, Takse Tabele.	115,434,413.51		52,225,269.49	167,659,683
3	Istitucione Shtetore	Taksa e Tarifa vendore		7,436,788.19		3,430,267.36	4,006,520.83
TOTALI			155,256,316.53		52,383,228.10	3,430,267.36	204,209,277.27

Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Kukës paraqitet:

Në celje të vitit 2023 vlera e borxhit tatimor është 155,256,316.53 lekë e përbërë nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për personat fizikë/juridikë në vlerën totale prej 147,819,528.34 lekë (taksa-tarifa);

- Detyrime nga institucione publike në vlerën 7,436,788.19 lekë;

V lera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2023 është 48,952,960.74 lekë nga të cilat:

- Shtuar detyrimet nga taksat dhe tarifat për personat fizikë/juridikë me shumën

52,383,228.10 lekë;

- Pakësuar nga arkëtimet e institucioneve shtetërore me shumën 3,430,267.36 lekë;

Në fund të vitit 2023 gjendja e debitorëve në vlerë progresive është 204,209,277.27 lekë e përbërë nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për personat fizikë/juridikë në vlerën totale prej 200,044,797.83 lekë për 486 biznese (taksa-tarifa dhe qira);

- Detyrime nga institucione publike në vlerën 4,006,520.83 lekë;

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit debitorë është në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 90,91,93, me VKB nr. 83, datë 23.12.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës”, me ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

• Masat e marra për uljen e borxhit

Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Kukës është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifatat vendore.

■ Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor të sipër cituar. Përkatësisht, janë nxjerrë urdhrat që ju janë dërguar bankave të nivelit të dytë për urdhër njoftim për bllokimin e llogarive bankare të 438 tatimpaguesve debitorë për vitin 2022 dhe 309 janë bërë bllokime për vitin 2023.

Ne vijim të punës për vjeljen e detyrimeve që kanë subjektet ndaj Bashkisë Kukës janë dërguar shkresa për masën e sigurisë me nr.prot 2546, datë 16.05.2024, drejtuar K/Regjistruesit të barrës siguruese për marrjen e masave mbi pasuritë e luajtshme për vendosjen e barrës siguruese, si dhe sekuestrimi i pasurisë.

■ Nga grupi i KLSH u bë shqyrtimi i të dhënave për 17 subjekte debitorë të vëna në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në lidhje me masat e marra për arkëtimin e debitorëve për subjektet, që kanë vlerat më të larta të detyrimeve (17 subjekte me vlerë 122,815,008 lekë) dhe masat e marra sipas informacionit të DAPLL, të cilat paraqiten në Aneks:

Masat e marra për debitorët.

Nr.	Emri i subjektit	DEB. 31.12.2023 + Penalitet	Njoftim dhe kërkesë për te paguar	Urdhër bllokimi për llogaritë bankare	Paguar
1	G. P.	1,746,274.	Nr.1454.prot., dt 18.3.2024	Nr.27546/7.prot.,datë 30.05.2024	
2	A. F.	1,486,692.	Nr.1452.prot.,dt 18.03.2024	Nr.2744/3., datë 30.05.2024	
3	K./H. B.	8,447,924	Nr.1449.prot., dt 18.3.2024	Nr.2756/5.prot., datë 30.05.2024	
4	A. & N shpk(n. A.)	2,000,227	Nr.1450., datë 18.03.2024	Nr.2744/1.prot., datë 30.05.2024	
5	B.(K. D.)	2,000,000	Nr.1250., datë 05.03.2024	Nr.1730., datë 04.04.2024	
6	K. Ch. m	3,274,880	Nr.1451., datë 18.03.2024	Vendim apelimi paguar ne qersor 2024	
7	T. B.	4,971,166	Nr.1448., datë 18.03.2024	Nr.2744.30.05.2024 dhe Nr.2995., datë 18.06.2024	
8	E. P. (S. M.)	6,164,696	Nr.1255., datë 05.03.2024	Nr.2375.,prot datë 01.05.2024	6,164,696
9	Dr.R.P.K.E.	8,488,181	Nr.1421., datë 18.03.2024	Nr.2744/10 datë 30.05.2024	
10	A. E.	18,924,284	Nr.2412., datë 07.05.2024	Nr.2786., dt 04.06.2024,Urdher ekzekuti Nr.18.06.2024	
11	Gj. S. P.	9,154,327	Nr.1254., datë 05.03.2024	Nr.1385,dt18.03.2024,Urdh ekzek nr.1714, dt 3.04.2024	
12	A. N. C.	9,577,298	Nr.1446.prot., dt 18.03.204	Nr.2744/12.,	
13	T. A. C.	24,422,358	Nr.1444., datë 18.03.2024	Nr.2744/10 datë 30.05.2024	
14	B. Gj.	1,785,291	Nr.1607., datë 28.03.2024		
15	B.	6,954,381	Nr.1627., datë 28.03.2024		1,435,255
16	K. H.	4,348,388	Nr.4062., datë 119.09.2024		
17	M-Xh-2014	9,068,635	Nr.1440., datë 18.03.2024		
	Totali	122,815,008			7,599,951

Burimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave

Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme të paraqitura konstatohet se, nga 17 subjektet e njoftuara për pagesën e detyrimeve me vlerë detyrimi 122,815,008 lekë, për 13 biznese është hartuar urdhër bllokimi i llogarive bankare, nga të cilët 1 subjekt ka paguar detyrimin e plotë dhe 1 subjekt ka paguar pjesërisht detyrimin dhe 1 subjekt ka vendim apelimi nr.91, datë 21.06.2024 për rivlerësim detyrimi. Ndërsa për 4 subjekte nuk është kryer urdhër bllokimi për llogaritë bankare.

Gjithashtu, rezulton se nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave (DAPLL) nuk janë marrë masa të mëtejshme për arkëtimin e detyrimeve, si urdhër i bllokimit të llogarive bankare, masa të sigurimit të detyrimit tatimor, urdhër sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë për 16 subjektet e mësipërme për vlerën 115,215,057 lekë (122,815,008-7,599,951).

Konkluzion: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave nuk ka marrë masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, ku rezultojnë 16 subjekte me vlerë detyrimi 115,215,057 leke, veprime ose mos veprime në kundërshtim

ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 90,91,93; Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pika 90,91,93; Udhëzimin e Përbashkët nr. 17, datë 20.6.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore” Kreu I , Kreu III pika 1, nënpika 1.1, pikat 2, 3 dhe 4, me Rregulloren e Bashkisë të miratuar me Urdhrin e titullarit nr.328, datë 05.04.2022, nenet 67,68,70.

- **Akt marrëveshjet për pagesën me këste të detyrimeve**

Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Bashkia Kukës ka lidhur marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura me disa subjekte debitorë që sqarohen më të detajuara në vijim.

Nr.	Akt-marrëveshja	Subjekti	Detyrimi në marrëveshje	Shuma e paguar në lekë	Shuma e mbetur në lekë	Afati
1	Nr. 3481 prot, 25.08.2023	L. Sh.	414,879	337,083	77,788	Deri më 22.12.2024
2	Nr 2367 Prot, date 04.07.2023	V. D.	954,525	774,852	179,676	Deri më 04.12.2024
3	Nr. 3749 prot, 07.09.2023	B. P.	339,018	288,155	50,850	Deri më 06.12.2024
Totali			1,708,422	1,400,090	308,314	

- Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për familjarët.

Konkluzion: Në Bashkinë Kukës aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit-gjellbërim-ndriçim dhe taksën e ndërtesës. Nga të dhënat që disponon Bashkia Kukës rezulton se kanë paguar detyrimet për këto dy taksa/tarifa kanë paguar 362 familje në vlerën 1,283,712.34 lekë nga 2852 gjithsej të taksuara për Qytetin e Kukës, ku 22.6 % e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrime për taksat dhe tarifave vendore, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitorë ndaj bashkisë. Bashkia Kukës nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësisve administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitorë nuk ka një regjistrë. Si rezultat, **procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitorë dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë.**

Nga Bashkia Kukës është dërguar shkresë me nr.prot 219, datë 18.01.2024 ASHK Kukës për informacion në lidhje me të dhënat mbi regjistrimin e pronave të paluajtshme private, shtetërore dhe publike, të të drejtave reale mbi to, me qëllim përlllogaritjen e taksës së pasurisë së paluajtshme të ndërtesës, të tokave bujqësore, truallin etj, për Bashkinë (qytet) dhe 10 NJA pjese përbërëse të bashkisë Kukës. Nga ASHK Kukës është kthyer përgjigje me shkresën nr.prot 116/1 date 29.01.2024 që për marrjen e të dhënave duhet të aplikohet në platformën elektronike e-albania shërbime me pagesë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e VKB nr. 83, datë 23.12.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës”, me ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

- **Planifikimi dhe arkëtimi i taksës së tokës bujqësore.**

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23⁴. Sipas Aneksit 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Bashkia Kukës klasifikohet në kategorinë e VI dhe VII, ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën mëposhtme:

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	1,400
II	1,200
III	1,100
IV	1,000
V	900
VI	800
VII-X	700

Referuar VKB-së nr. 83, datë 23.12.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës”, toka bujqësore në Bashkinë Kukës klasifikohet në kategorinë VI-VII me detyrim 700 lekë/ha/vit. Të dhënat e tokës bujqësore referuar raportit të mëparshëm të KLSH-së , për sipërfaqet e tokës bujqësore janë si më poshtë vijon:

Të dhënat mbi tatimin mbi tokën bujqësore /lekë

Nr.	Njësia Administrative	Numri familjeve qe kane toke me AMTP	I qe me	Sipërfaqe ne pro te Bashkisë (ha)	Toke e Marre me AMTP (ha)	Çmimi sipas paketës Fiskale leke/ha	Detyrime vjetore ne leke 31.12.2022
1	NjA Bushtrice	688		567	212	700	148400
2	NjA Kalis	559		560	148	700	103600
3	NjA Gryk-Caj	452		465	193	700	135100
4	NjA Bicaj	1595		707	358	800	286400
5	NjA Shishtavec	990		1343	573	700	401100
6	NjA Zapod	630		319	196	700	137200
7	NjA Ujmisht	904		634	188	700	131600
8	NjA Topojan	855		527	303	700	212100
9	NjA Terthore	889		695	180	800	144000
10	NjA Malzi	1418		521	310	700	217000
11	NjA Kolsh	339		393	119	700	83300
12	NjA Arren	472		99	122	700	85400
13	NjA Surroj	582		236	133	700	93100
14	NjA Shtiqen	337		540	275	700	192500
15	NjA Kukes			447			
	Shuma	10710		8053	3310		2,370,800

Burimi: DAPPL ,raporti i i mëparshëm KLSH-së,

Për sa më sipër vlera e detyrimit e përlllogaritur nga grupi i auditimit është 2,370,800 lekë që duke zbritur realizimin në vlerën 4,577 lekë ngelën për tu arkëtuar 2,366,223 lekë për vitin 2023.

Konkluzion: Në Bashkinë Kukës nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore dhe se Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe taksa e tokës bujqësore. Për **taksën e tokës** për vitin 2023 për vitin 2023 janë arkëtuar 4,577 lekë nga 568,328.37 lekë e planifikuar ose në masën 0,8%, fakt që tregon se familjet fermere nuk taksohen dhe planifikimi i kësaj takse është bërë mbi bazë jo reale, pasi mbi bazën e të dhënave mbi ndarjen e fondit të tokës dhe kategorizimin e saj të ardhurat e planifikuara në vitin 2022 janë në vlerën 2,370,800 lekë.

⁴Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 1.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe VKB-së nr. 83, datë 23.12.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës” pika 4/b. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet kur qytetarët paraqiten në bashki në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifave vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Sektori i Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 700 lekë/ha/vit kur bashkia ka të dhëna.

• Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Në Bashkinë Kukës struktura që administron dokumentacionin dhe përlogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë nga legalizimi i ndërtimeve informale është Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave realizojnë për arkëtimin e TNI.

Gjatë vitit 2023 janë legalizuar 178 ndërtime informale, ku 93 subjekte kanë kryer pagesën dhe 85 subjekte nuk kanë kryer pagesën në vlerën 3,060,990 lekë, duke përjashtuar 3 komunitete myslimane të Shqipërisë që nuk bëjnë pagesë.

Referuar te dhënave të vëna në dispozicion si dhe te dhënave referuar raportit të mëparshëm të KLSH-së në fund të vitit 2022 dhe fund viti 2023, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton si më poshtë vijon:

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

TNI nga legalizimet debitorë në datë 31.12.2022		Shtesat e debitorëve për TNI gjatë vitit 2023		Pakësimet e debitorëve për TNI gjatë vitit 2023		Diferenca shtesa me pakësimet		Debitorët progresivë për TNI në datën 31.12.2023	
nr	vlerë	nr	vlerë	nr	vlerë	nr	vlerë	nr	vlerë
624	23,936,441	85	3,060,989	95	2,424,773	-10	+636,216	614	24,572,657

Burimi DAPPL, raporti i mëparshëm i KLSH-se, përpunoi grupi i auditimit

Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave e Bashkisë Kukës nuk ka marrë masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë (legalizimet) për 614 fatura në vlerën **24,572,657** lekë.

Konkluzion: Nga auditimi i ecursë së pagesave për **taksën e ndikimit në infrastrukturë** nga individë që kanë përfituar nga legalizimi i objekteve informale konstatohet se, në fund të vitit 2022 janë 624 individë debitorë në vlerën 23,936,441 lekë. Gjatë vitit 2023 janë shtuar 85 debitorë në vlerën 3,60,990 lekë dhe janë kryer pagesa nga 95 individë detyrimet për TNI në vlerën 2,424,773 lekë. Pra në fund të vitit 2023 rezulton se, në Bashkinë Kukës kanë detyrime debitorë 604 individë në vlerën **24,572,657** lekë për taksën e infrastrukturës për objekte që kanë legalizuar. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9⁵, pika 4, neni 27, me ligjin nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesat në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, neni 27, pika 3, shkronja “c”, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5⁶ dhe me VKB nr. 83, datë 23.12.2022, “Për miratimin e

⁵ neni 9, pika 3/c “për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi”

⁶ pika 5 “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e

taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës”. Në mënyrë të detajuar debitorët në vlerë progresive për TNI nga legalizimet deri në fund të vitit 2023 paraqiten në Aneks.

Drejtoria e te Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave ka kërkuar me shkresën me nr.prot. 433, datë 16.05.2024 nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dhënat në lidhje me detyrimet e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e përfutur nga individë, për periudhën nëntor 2022-janar 2024 të ardhura nga ASHK, Kukës me emali.

• **Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve**

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë rezulton se, në territorin e Bashkisë Kukës për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj 13 subjekte të cilat janë pajisur me autorizime/leje nga Bashkia për ushtrim aktiviteti për periudha 5 vjeçare, ku 10 subjekte kanë paguar tarifën ligjore prej 1,000,000 lekë dhe 7 subjekte janë debitorë në vlerën 7,000,000 lekë në fund të vitit 2023, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014, neni 4, neni 20/pika 2 dhe me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9⁷. Subjektet në mënyrë të detajuar, që ushtrojnë aktivitet në shitjen e lëndëve djegëse me pakicë me të dhënat e tyre për pajisjen me autorizime dhe pagesat e tyre paraqiten në Aneks:

Nr	Operatori Ekonomik	Adresa	Autorizimi Bazë	Niveli tarifës sipas VKM nr. 344	Pagesa viti 2021-2022	Detyrime për t'u paguar për autoriz 2023	Shënime
1	K. A. shpk	Nange-Bicaj	24.04.2023 -23.04.2024	1,000,000	pagu		Ish Kastrati (Ne proces)
2	“V.B. N”shpk	Komuna Terthore	29.03.2023 -28.03.2028		pagu	1,000,000	
3	“G. C.”shpk	Rr.Prizrenit	01.02.2023 - 31.01.2027	800,000	pagu		
4	“U. C.”shpk	Rr.Mehmet Hoxhe Brruti	28.02.2023 - 27.02.2028	1,000,000	pagu		
5	“U. C.”shpk	Rr.Deshmoreve	02.02.2023 - 01.02.2028	1,000,000			
6	“B. P.”shpk	Lagjja 3,Rruga Mahmut Daci	09.03.2023 - 08.03.2028		pagu	1,000,000	
7	“V. Sh.”shpk	Rr.Prizrenit					Mbyll,Proc Gjyqes S.P.A.
8	S. P. A.	Rr.Prizrenit					Proç gjyqes me V. Sh.
9	“D. O.”shpk	Rr.Kukes-Prizren	22.06.2022 - 21.06.2023	200,000			Mbyllur
10	“K. D.”	Fshati Bardhoc	02.07.2019 - 01.07.2024	1000,000	pagu		
11	N. Shpk	Gjegjan	15.02.2023 - 14.02.2028	1,000,000	pagu	1,000,000	
12	E. O-2017	Fshati Bardhoc	21.02.2022 - 20.02.2023	200,000			Mbyllur
13	B.shpk	Lagjja Nr.1	03.03.2023 - 02.03.2028	1,000,000		1,000,000	
14	B.shpk	Lagjja Nr.2	03.03.2023 - 02.03.2028	1,000,000		1,000,000	
15	K.shpk	Lagjja Nr.3 Prane Ujesjellesit	24.04.2020 - 24.04.2025	1,000,000			
16	D. 2001	Kolsh		1,000,000		1,000,000	
17	G.2 P.	Lagjja 3	23.03.2023 - 22.03.2028	1,000,000		1,000,000	
						7,000,000	

Burimi: Bashkia Kukës

ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

⁷ “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milionë) lekë për bashkitë e tjera”.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. P. G. me detyrë Drejtor i Drejtorisë i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave (për periudhën 24.05.2023-vazhdon), me z.V. G. me detyrë ish-Shef i Sektorit të Kontabilizimit dhe Shërbimit të Tatimpaguesve (për periudhën 01.01.2023-05.09.2023), z. K. K. me detyrë Shef i Sektorit të Kontabilizimit dhe Shërbimit të Tatimpaguesve (për periudhën 11.09.2023-vazhdon).

3.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

3.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

3.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë;

3.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.

Për vlerësimin e raportimit financiar u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2023 të shoqëruar me formatet 1-9.

2. Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme,

3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2023, libri i aktiveve.

4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2023.

6. Aktrakordimet me Degën e Thesarit Kukës në mbyllje të vitit buxhetor 2023.

8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel” si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret, shpenzimet të ardhurat etj.).

• Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2023 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Kukës” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022.

• Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.

Bashkia Kukës për vitin 2023 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, pasi nuk ka në varësi njësi shpenzuese me nipt më vete, pasi Agjencia e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit Kulturës i janë bashkuar Aparatit të Bashkisë në vitin 2016.

• Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Kukës për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr.prot.1636 datë 29.03.2024. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Kukës dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjësi i Finances. Pra në këtë rast nuk kemi delegime të detyrave.

• Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i

mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

• ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për sa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mosndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

• ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të aparatit Bashkisë.***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel"
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi pershkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimin, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit,

akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësishë ekonomike.

• ***Baza e dhënies së opinionit së raportimit financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar,

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël,

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar, dhe detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilanc.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 “Disponibilitete në

Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në me formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2023”

Totali i Aktivit për vitin 2023 është në vlerën 4,583,562,186 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Formati nr.1		Aktivi i Bilancit 2023		Në lekë
Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	AKTIVET	4,583,562,186	4,122,226,308
2		I. Aktivet Afat shkurtër	1,144,427,157	1,011,434,796
3		1. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	337,246,025	279,726,426
4	531	Mjete monetare në Arke		
5	512,56	Mjete monetare në Banke	7,903,091	29,247,092
6	520	Disponibilitete në Thesar	329,342,934	250,479,334
7	50	Letra me vlerë		
8	532	Vlera të tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhënie		
10	59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	110,320,628	102,630,941
12	31	Materiale	15,336,583	9,513,723
13	32	Inventar i imet	94,984,045	93,117,218
14	33	Prodhim në proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe në rritje e majmeri		
18	37	Gjendje të pa mbritura, ose prane të treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provizione për zhvlerësimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari të Arketushme	696,860,504	629,077,429
22	411	Kliente e llogari të ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	106,992	106,992
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore që mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqërore		
28	436	Sigurime Shëndetsore		
29	437,438,	Organizma të tjera shtetërore		
30	44	Institucione të tjera publike		
31	465	Efekte për të arketuar nga shitja e letrave me vlerë		
32	468	Debitore të ndryshëm	573,235,944	509,121,884
33	4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	123,517,568	119,848,553
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes të mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime		
41	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0
42		II. Aktivet Afat gjatë	3,439,135,029	3,110,791,512
43	20	1. Aktive Afatgjatë jo materiale	13,032,892	13,032,892
44	201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
45	202	Studime dhe kërkime	13,032,892	13,032,892
46	203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjatë materiale	2,630,514,411	2,691,262,942
48	210	Toka, Troje, Terene	70,974,458	70,974,458
49	211	Pyje, Plantacione	123,645,599	123,645,599
50	212	Ndertesa e Konstruksione	1,087,848,828	1,145,104,029
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,295,534,500	1,287,925,877
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	19,020,106	18,495,383
53	215	Mjete Transporti	19,367,719	24,209,649
54	216	Rezerva Shtetërore		

55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	8,710,710	15,495,456
57	24	Aktive afatgjata te demtuara	5,412,491	5,412,491
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	15,000,000	15,000,000
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet	15,000,000	15,000,000
62		4.Investime	780,587,726	391,495,678
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale	60,865,146	39,654,832
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	719,722,580	351,840,846

A. **AKTIVE AFATSHKURTRA.**

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 337,246,025 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “ Teprica e likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte” të paraqitur në Aneks.

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”**, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 329,342,934 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas aktrakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2023”.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 110,320,628 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 102,630,941 lekë, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej 7,689,687 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 15,336,583 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 9,513,723 lekë, me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 5,822,860 lekë nga blerje të mallrave gjatë vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 94,984,045 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 93,117,218 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 1,866,827 lekë, e cila përfaqëson rritje te inventarit te imët për vitin 2023.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 696,860,504 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 629,077,429 lekë, ku kemi shtese duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes se detyrimeve te debitorëve të ndryshëm.

- **Gjendja e llogarisë 423, 429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba”** në aktiv të bilancit paraqitet si në mbyllje të vitit 2023 106,992 leke dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 106,992 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 573,235,944 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 509,121,884 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 64,114,060 lekë, e cila i përket debitorëve të krijuar gjatë vitit 2023 nga taksat dhe tarifat vendore dhe nga detyrimet per gjoba nga IMTV. Analiza e gjendjes së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi në zëra	Gjendje 31.12.2022	Sisteme (shtesa)	Shtuar gjate vitet ushtrimor	Sisteme (pakesime)	Pakesuar gjate viti ushtrimor	Gjendje 31.12.2023
1	Gjoba IVMT	321,310,000		19,588,300			340,898,300

2	Zyra e tatimeve	135,697,321		68,511,957			204,209,278
3	E mbartur (e papercaktuar)	28,128,366					28,128,366
	TOTALI llog 468	485,135,687	0	88,100,257	0	0	573,235,944

Konkluzion: Në gjendjen prej 573,235,944 lekë të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2023 është përfshirë vlera prej 28,128,366 lekë e mbartur nder vite, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 15 nën-pika b, pika 4.2, pika 3.3. Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

- **Gjendja e llogarisë 4342** “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 123,517,568 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2023, që trashëgohen në vitin 2024. Kjo gjendje ka në analizë ose përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 68,877,666 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 33,528,513 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 5,134,016 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 14,525,760 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 1,221,370 lekë dhe vlerën pjesore prej 230,243 lekë të llog. “Organizma të tjera shtetërore” të planifikuar për likuidim në vitin 2023. Gjendja e llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” pasqyron detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundërpartit në pasiv të bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e AAGJM, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të AAGJM në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi AAGJM;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranura dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 **“Aktivet Afatgjata” në aktiv të bilancit** paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,439,135,029 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,110,791,512 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,038,034,192 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,953,691,395 të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto 13,032,892 lekë si në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën prej 13,032,892 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet si në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 13,032,892 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet në Aneks.

STUDIME-KERKIME	Vlera
Studime e Kerkime	166,911
Projekte	1,345,000
Projekte	300,000
Projekt Rikonstruksion i Shkolles Bardhoc	471,573
Projekte te ndryshme	190,800
Projekte te ndryshme	186,000
Projekte	500,000
Studime projektme	280,000
Projekte	1,114,541
Studime e Kerkime	1,056,953
Totali	5,611,778

Referuar analizës së gjendjes së llog.202 *“Studime dhe kërkime”* rezulton se vlera e saj është e mbartur nga vitet e kaluara për shumën 5,611,778 lekë i përket viteve 2011-2013 dhe nuk rakordon me vlerën në bilanc për shumën 7,420,514 lekë. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ka mundur të siguroj dokumentacionin e nevojshëm për të bere saktësimin e e vlerave dhe sistemimin e tyre, meqenëse janë mbartje nga ish Komunat Surroj, Zapod, Malzi, Tërthore, Arrën, Kolsh Bushtrice dhe Bicaj. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik i projekt-studimeve të blera dhe mos identifikimi i tyre nuk ka bërë të mundur përcaktimin se kujt investimi të kryer apo jo i përkasin, në mënyrë që vlera e tyre ti kalohej si vlerë e shtuar nëpërmjet veprimeve kontabël çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizim. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së

përgjithshme” Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, i cili përcakton se: “Për aktivet afatgjata jo materialë, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%”

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,630,514,411 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 2,691,262,942 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,025,001,300 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,940,658,503 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 70,974,458 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 70,974,458 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2023 është 70,974,458 leke dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 70,974,458 lekë. Referuar analizës së kësaj llogarie rezulton se **inventari kontabël** është në vlerën 273,575,103 lekë, i cili **nuk rakordon për vlerën 202,600,645 lekë me gjendjen e paraqitur në bilanc**. Për këto aktive nuk ka inventar fizik.

Inventari kontabel i llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” me datë 31.12.2023

Nr	TERRENE	Vlera
1	TERRENE SPORTIVE NE SHKOLLAT E KUKESIT	4,944,268
2	TERRENE SPORTIVE NE ARSIM 2007(UNDP BASHKI)	1,139,673
3	TERRENE SPORTIVE NE ARSIM 2007(UNDP BASHKI)	1,160,671
4	TERRENE SPORTIVE NE ARSIM 2007(UNDP BASHKI)	1,544,262
5	TERRENE ARSIMORE (OBORRE+ KENDE LOJRASH ETJ)	11,202,702
6	STADIUMI I QYTETIT "ZEQIR IMERI"	110,000,000
7	FUSHA E STADIUMIT FUTBOLLIT	30,495,000
8	KENDI I LOJRAVE ME DORE	98,159,834
9	TERREN SPORTIV SHK"BAJRAM CURRI"	3647120
10	TERREN SPORTIV SHK"RIZA SPAHIU"	10621725
11	TRULL PER AMBULANCA	400,000
12	TERRENE SPORTIVE	259848
	Totali	273,575,103

-**Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në shumën prej 123,645,599 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 123,645,599 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 123,645,599 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 123,645,599 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se **inventari kontabël** është në vlerën 101,458,750 lekë dhe **nuk rakordon për vlerën 22,186,849 lekë me gjendjen e paraqitur në bilanc**. Për këto aktive nuk ka inventar fizik. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet në Aneks.

Inventari kontabël i llogarisë 211 "Pyje, plantacione " me datë 31.12.2023

Nr	PYJE, PLANTACIONE	Vlera	Nr	PYJE, PLANTACIONE	Vlera
1	GJELBERIMI I RRUGEVE KRYESORE TE QYTETIT	6,138,900	19	PARKU I PISHAVE MBI FUSHEN E SPORTIT	772,000
2	GJELBERIM I LAGJES NR.1 TE QYTETIT	3,904,000	20	ZONA DEPRESIVE (MINI FUSHA E FUTBOLLIT)	112,000
3	GJELBERIM I LAGJES NR.2 TE QYTETIT	5,418,066	21	GJELBRIM GJYKATE- PROKURORI	381,020
4	GJELBERIM I LAGJES NR.3 TE QYTETIT	1,038,000	22	GJELBRIM ISH SHTEPIA E USHTARAKEVE	143,700
5	GJELBERIM I LAGJES NR.4 TE QYTETIT	2,971,808	23	GJELBRIM ISH SHTEPIA E OFICEREVE	183,560
6	GJELBERIM I LAGJES NR.5 TE QYTETIT	2,011,642	24	GJELBERIM I PARKUT TEK SHETITORJA LAGJE NR.5	5,797,040
7	GJELBERIM I LAGJES NR.6 TE QYTETIT	3,972,236	25	GJELBRIMI LOKAL "BUKURIA" LAGJE NR.2	92,000
8	GJELBERIM I ZONES QENDER(BASHKIA)	3,139,697	26	GJELBRIMI I PARKU I FUGONEVE TE AXHENSIA	2,618,680
9	BREZ PYJOR PISHA(LOKAL MUSTAFA- KARBURANTI)	8,470,000	27	GJELBRIMI I OBJEKTIT "TURIZMI I RI"	2,223,980
10	PARKU "ZABEL" TEK SPITALI	11,535,063	28	ZONA E SPITALIT USHTARAK(PISHAT)	28,000
11	LULISHTE BAR MUSTAFA(HYRJA E QYTETIT)	54,780	29	BREZI PYJOR TREGU - LAGJE NR1-UJESJELLES	2,781,500
12	LULISHTE PARA SHKOLLES MESME" H.NELA"	381,528	30	BIMESIA DEKORATIVE FIDANISHTES NANGE	21,090,800
13	ZONE E GJELBERT PRANE SPITALIT USHTARAK	42,000	31	BLERJE FIDANESH NJESIA NR.1;2,4.	643,200

14	GJELBERIM NE VARREZAT E DESHMOREVE	4,883,800	32	GJELBRIMI TURIZMIT TE RI	410,300
15	GJELBERIM NE VARREZAT PUBLIKE	1,048,500	33	PYJE E KULLOTA	1,160,000
16	GJELBERIM I SHKOLLAVE TE QYTETIT	1,828,080	34	PYJE E KULLOTA	2,183,485
17	GJELBERIM I (PARKU I PENSIONISTEV) LAGJE NR.2	1,719,900	35	PYJE E KULLOTA	2,183,485
18	LULISHTE KRYQEZIM-POLIKLINIKE-LAGJE NR.2	96,000		Totali	101,458,750

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,087,848,828 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,145,104,029 lekë ku diferenca prej 57,255,201 leke përfaqëson vlerën e amortizimit të përlogaritur. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,672,523,297 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,672,523,297 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se **inventari kontabël** është në vlerën 1,294,797,949 lekë, i cili **nuk rakordon për vlerën 377,725,348 lekë me gjendjen e paraqitur në bilanc**. Për këto aktive nuk ka inventar fizik. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet per vitin 2023 paraqiten në Aneks.

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,295,534,500 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në 1,287,925,877 lekë. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,831,105,884 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,759,100,967 lekë. Gjatë vitit 2023 janë bërë shtesat në vlerën 7,608,623 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se **inventari kontabël** është në vlerën 1,063,823,718 lekë, i cili **nuk rakordon për vlerën 767,282,166 lekë me gjendjen e paraqitur në bilanc**. Për këto aktive nuk ka inventar fizik. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet per vitin 2023 paraqiten në Aneks.

Konkluzion: Referuar analizës të gjendjes së llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezulton se, nuk është zbritur vlera prej 13,545,856.14 lekë e investimeve të kryera në 11 objekte për ujësjellësa e rrjetin shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji, objekte dhe vlerë, të cilat Bashkia Kukës nuk ia ka transferuar Ujësijellës Kanalizime SHA Kukës (në varësi të AKUK) në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2023 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, me VKM nr.153, datë 03.04.1993 “Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore, të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” i ndryshuar, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 31.

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 19,020,106 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 18,495,383 lekë. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 64,964,086 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 63,514,594 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se **inventari kontabël** është në vlerën 10,415,206 lekë, i cili **nuk rakordon për vlerën 54,548,880 lekë me gjendjen e paraqitur në bilanc**. Për këto aktive nuk ka inventar fizik. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet per vitin 2023 paraqiten në Aneks.

Inventari kontabël i llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” me datë 31.12.2023

Nr	INSTALIME TEKNIKE, MAKINERI E PAISJE	Vlera	Nr	INSTALIME TEKNIKE, MAKINERI E PAISJE	Vlera
1	POMPE UJI ME RELE	74,401	19	Dere hekuri	25,000
2	SHARP (SAJMIR HALILAJ)	3,000	20	Qelesa pune	1,770
3	KOKE SHARPI DYSHE	3,500	21	Kontinier	900,000
4	APARAT TRING	11,000	22	Kompresor ajri	1,762,500

5	KONDITIONER	70,000	23	Krevata marinari	89,100
6	POMP E QARKULLIMIT GAZIT KALDAJES	40,000	24	Tub 71mm	2,640
7	POMP E QARK GAZIT KALDAJES	5,000	25	Lidhese uji	8,250
8	TRANSFORMATOR UJI	14,000	26	Lidhese uji	468
9	XHENERATOR	270,000	27	Kompresor ajri	1,762,500
10	KONDITIONER	56,000	28	Aparat uje mates	60,000
11	LABORATORI I KIMISE	245,409	29	Aparat uje mates	8,000
12	LABORATORI I FIZIKES	41,909	30	Pompe Gjevis	60,000
13	Elektropompe	780,000	31	Motorr Shell	30,000
14	Elektropompe	700,000	32	Baraban	30,000
15	Elektropompe	664,440	33	Gure fresibel	22,800
16	Elektro pompe	779,679	34	Kondicioner	216,000
17	Elektro pompe	683,640	35	Sistem bolieri dhe pompe, tualeti kati IV	895,200
18	Panel komsandimi 7.5kë	99,000		Totali	10,415,206

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 19,367,719 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 24,209,649 lekë dhe diferenca prej 4,841,930 leke përfaqëson vlerën e amortizimit të përlogaritur, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet si në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 174,287,211 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 174,287,211 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se **inventari kontabël** është në vlerën 189,429,719 lekë, i cili **nuk rakordon për vlerën 15,142,508 lekë me gjendjen e paraqitur në bilanc**. Për këto aktive nuk ka inventar fizik. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve në fund të vitit 2023 paraqiten në Aneks:

Inventari kontabel i llogarisë 215 "Mjete transporti " me datë 31.12.2023

Nr	MJETE TRANSPORTI	Vlera	Nr	MJETE TRANSPORTI	Vlera
1	M. BENZ-AUTOBOT UJI	923,880	22	M.BENZ ATEGO AUTOZJARRFIKESE	29,176,830
2	M. BENZ-SPRINTER 408CDI	2,460,000	23	M.BENZ ATEGO AUTOZJARRFIKESE	29,176,830
3	DAIMLER BENZ -1017A 4*4	4,329,000	24	MITSUBISHI PAJERO 3200CC	948,000
4	IVECO-SPA EURO CARGO PASTRIMI	6,561,793	25	APV - ISUZU (MAKINE MBETURINASH)	11,070,000
5	DENNIS ELITE 2-EAGLE ELITE 2	4,914,000	26	KAMION VETSHKARKUES	3,540,000
6	M.BENZ-Ë124	999,980	27	KAMION VETSHKARKUES	3,540,000
7	IVECO-ACL 75 6611M	1,500,000	28	KAMION MULTIFUNKSIONAL	7,290,000
8	SANGGYONG-KORANDO	1,240,000	29	KAMION MULTIFUNKSIONAL	7,290,000
9	M.BENZ ML 270 CDI	2,898,000	30	FADROME NEË HOLLAND B115B	2,340,000
10	LAND ROVER - LJGM DISCOVERY	1,975,000	31	FADROME NEË HOLLAND B115B	2,340,000
11	CAT PILAR-CE93428B	4,329,000	32	FADROME HIDROMEK HMK102B	2,340,000
12	ESKAVATOR J.C.B 3CX-97TPA/DË	7,998,000	33	TRAKTOR ME ZINGJIRE	3,120,000
13	KAMIONÇINE M.BENZ -814D	1,494,000	34	KRIPORE	708,000
14	AUDI Q7	3,000,000	35	KRIPORE	708,000
15	FORISTRAD SANGYONG REXTON	2,856,000	36	THIKE BORE	1,860,000
16	Ë.SHARON 7M	947,880	37	THIKE BORE	1,860,000
17	CASE-695SR 4PS	6,132,000	38	AUTOBUS MERCEDES BENZ	1,669,680
18	VOLFSËAGEN -7HZ CARAVELLE	2,142,000	39	KAMIONÇINE VETE SHKARKUESE , Nr.Dyreve 4	1,680,000
19	ESKAVATOR NEË HOLLAND -B115B (BORDI KULLIMIT)	12,792,000	40	KAMIONÇINE VETE SHKARKUESE , Nr.Dyreve 2	2,402,400
20	FORISTRAD DACIA SANDERO (BORDI KULLIMIT)	1,399,800	41	MAKINE AUTOVINÇ ME KOSH	1,800,000
21	DAIMLER BENZ AG 1619 AUTOBOT	3,677,646		Totali	189,429,719

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 8,710,710 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 15,495,456 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 82,088,274 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 71,199,886 lekë.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2023 paraqiten në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksim gjate vit	Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
c	1	2	3	4	5	6	8	9	10
I. AAGJ/JO MATERIALE	13,032,892	0	13,032,892		0		13,032,892	0	13,032,892
Studime dhe kerkime	13,032,892		13,032,892				13,032,892	0	13,032,892
Koncesio, patent,licenca e ngjash			0				0	0	0
II. AAGJ/ MATERIALE	3,940,658,503	1,249,395,561	2,691,262,942	84,342,797	145,091,328		4,025,001,300	1,394,486,889	2,630,514,411
Toka,troje,Terene	70,974,458	0	70,974,458	0			70,974,458	0	70,974,458
Pyje,Kullota Plantacione	123,645,599	0	123,645,599				123,645,599	0	123,645,599
Ndertime e Konstruksione	1,672,523,297	527,419,268	1,145,104,029		57,255,201		1,672,523,297	584,674,469	1,087,848,828
Rruge,rrjete,vepra ujore	1,759,100,967	471,175,090	1,287,925,877	72,004,917	64,396,294		1,831,105,884	535,571,384	1,295,534,500
Instal teknik,makin,pais,vegl pun	63,514,594	45,019,211	18,495,383	1,449,492	924,769		64,964,086	45,943,980	19,020,106
Mjete transporti	174,287,211	150,077,562	24,209,649		4,841,930		174,287,211	154,919,492	19,367,719
Rezerva shtetore	0	0	0				0	0	0
Kafshe pune e prodhimi	0	0	0				0	0	0
Inventar ekonomik	71,199,886	55,704,430	15,495,456	10,888,388	17,673,134		82,088,274	73,377,564	8,710,710
AQT te demtuara	5,412,491	0	5,412,491				5,412,491	0	5,412,491
Caktime	0	0	0				0	0	0
Inventar ekonomik	3,953,691,395	1,249,395,561	2,704,295,834	84,342,797	145,091,328		4,038,034,192	1,394,486,889	2,643,547,303

- **Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale** paraqitet në bilanc në vlerën 1,394,486,889 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36.

Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit dhe jo aktiv për aktiv.

Për aktivet e llogarive: 202 “Studim-Projektime”; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 218 “Inventar Ekonomik”, në të cilat përfshihen pajisjet kompjuterike llogaritja e amortizimit është aktiv për aktiv, dhe mund të verifikoheshin se si janë llogaritur amortizimi për pajisjet kompjuterike.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Kukës

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2023 për Bashkinë Kukës dhe Njësitë Administrative ne varësi.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit per vitin 2023 ka dalë urdhri nr.41, datë 12.01.2024 “Per fillimin e procedurës se inventarizimit te vlerave materiale (aktiveve) pajisjeve/mjeteve në inventar te Bashkise Kukës” dhe urdhri nr.40, datë 12.01.2024 “ Për fillimin e procedurës së inventarizimit të vlerave materiale (aktiveve) pajisjeve/mjeteve në inventar të Njësiave Administrative te Bashkisë Kukës”. Në bazë të këtyre urdhrerave është përcaktuar komisioni i inventarizimit i përbërë nga 69 punonjës total. Komisionet e inventarizimit kanë kryer inventarizimin të aktiveve të llogarive 218 “Inventar ekonomik”, llog. 31 “Materiale” dhe llog. “Inventar i imët” si për Aparatin e Bashkisë dhe për njësitë në varësi si Njësitë Administrative, shkollat, kopshtet dhe çerdhet (qytet dhe fshat), Qendra Kulturore e Fëmijëve, Qendra Kulturore (Muzeu dhe Pallati i Kulturës). Për vitin 2023 nuk janë nxjerre aktive afatgjata jashtë përdorimit.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se, inventarizimi ka filluar pas mbylljes së vitit ushtrimor 2023 dhe ka përfunduar pas hartimit të PF. Komisionet inventarizimit nuk kanë evidentuar procesin e inventarit në fletët e inventarëve, sipas formatit tip, por kanë formën e kartelave të magazinës, duke mos përfshirë rubrikën e inventarit fizik dhe rezultatin nga krahasimi me inventarin kontabël si dhe nuk

janë të konfirmuara nga komisioni, por vetëm specialisti i aseteve dhe pronave në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit. Aktivët e inventarizuar nuk janë të ndara sipas llogarive, por janë listuar të gjitha aktivët e llogarive 31 “Materiale”, llog.32 “Inventar i imët” dhe llog.218 “Inventar ekonomik” me një vlerë totale prej 147,885,686 lekë, e cila **nuk rakordon për shumën 28,854,348 lekë** me vlerën kontabël të këtyre llogarive së bashku të paraqitur në bilanc prej 119,031,338 lekë. Nuk është hartuar një relacion përmbledhës për gjithë inventarin e AAGJM, ku të përshkruhen mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit. Gjithashtu mungon dokumentimi i procedurës nëpërmjet procesverbaleve përkatëse dhe i rezultatit të inventarizimit në përmjet hartimit të raportit të inventarizimit nga Komisioni Inventarizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pika 85⁸, me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

Konkluzion: Referuar të dhënave të kontabilitetit dhe analizës të pjesës më të madhe të llogarive të AAGJM rezulton se, inventarët kontabël dhe fizik nuk rakordojnë me gjendjet në bilanc të llogaritë:

- Inventari kontabël i llog.210 “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 273,575,103 lekë, i cili nuk rakordon për vlerën 202,600,645 lekë me gjendjen prej 70,974,458 lekë të paraqitur në bilanc;

- Inventari kontabël i llog.211 “*Pyje, Plantacione*” është në vlerën 101,458,750 lekë, i cili nuk rakordon për vlerën **22,186,849 lekë** me gjendjen prej 123,645,599 lekë të paraqitur në bilanc;

- Inventari kontabël i llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” është në vlerën 1,294,797,949 lekë, i cili nuk rakordon për vlerën **377,725,348 lekë** me gjendjen prej 1,672,523,297 lekë të paraqitur në bilanc;

- Inventari kontabël i llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” është në vlerën 1,063,823,718 lekë, i cili nuk rakordon për vlerën **767,282,166 lekë** me gjendjen prej 1,831,105,884 lekë të paraqitur në bilanc;

- Inventari kontabël i llog. 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” është në vlerën 10,415,206 lekë, i cili nuk rakordon për vlerën **54,548,880 lekë** me gjendjen prej 64,964,086 lekë të paraqitur në bilanc;

- Inventari kontabël i llog. 215 “*Mjete Transporti*” është në vlerën 189,429,719 lekë, i cili nuk rakordon për vlerën **15,142,508 lekë** me gjendjen prej 174,287,211 lekë të paraqitur në bilanc.

Në këto llogari azhurnimet bruto për një pjesë të aktiveve janë kryer me një emertim të pa adresuar, ku vlerat e tyre nuk dihet se çfarë përfaqësojnë, pasi nuk janë të analizuar me emërtesa të sakta dhe të plota. Për këto aktive mungon inventari fizik. Rregjistri historik i aktiveve AAGJM mbi të cilin kanë dalë dhe vlerat kontabël të llogarive të klasës 20 -21 është i pasaktë dhe i pa plotë, gjë që e tragojnë mos rakordimet me vlerat e bilancit. Këto veprime

⁸ “Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për :

- a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/perdorim të personelit të njesise publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit..
- b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.
- c. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.”

janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik” kapitulli III, pika 30, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitet e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Konkluzion: Gjendja e ***llog. 24 “Äktive afatgjata të dëmtuara”*** si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 5,412,491 lekë. Për këtë vlerë nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

- Gjendja e ***llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”*** si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 15,000,000 lekë, vlerë e cila përfaqëson kapitalin e derdhur për Shoqërinë “Klub futbolli Përparimi” sha.

- ***Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”*** në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 719,722,580 lekë, e cila duhet të paraqesë vlerën pjesore të paguara të kontratave deri në verë të plotë të investimeve që janë në vazhdim të pa kapitalizuara. Nga analiza e kësaj llogarie paraqitet në tabelën e mëposhtme: Rastet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emertesa	Vlera
1	Pyllezim me akacie ne ngastren nr 78/C, EP Bushtrice	5,073,126
2	Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare Fshat	9,188,134
3	Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare Mamez	8,321,208
4	Rikonstruksion I shkolles se mesme Shtiqen	3,273,700
5	Rikonstruksion I shkolles se mesme Shtiqen	5,253,500
6	Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare Fshat	6,307,491
7	Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare Mamez	2,273,058
8	Kolaudim I punimeve "Rikonstruksion I shkolles se fshatit Fshat"	32,640
9	Mbikeqyrje e punimeve "Rikonstruksion I shkolles se fshatit Shtiqen"	195,845
10	Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare Fshat	2,110,000
11	Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare Fshat	2,980,619
12	Restaurim I lapidarit dhe varrezave te Deshmoreve te Atdheut	6,944,964
13	Restaurim I lapidarit dhe varrezave te Deshmoreve te Atdheut	7,037,047
14	Restaurim I lapidarit dhe varrezave te Deshmoreve te Atdheut	5,673,873
15	Rikonstruksion I lapidarit Kolejsjan Kukes	388,625
16	Rehabil I rrug hyrese per tek varrez e deshmor, Murrit rrethue, Muzeut, Punime grafike e reklama , punime plotesue te kompletuara	7,645,369
17	Rehabil I rrug hyrese per tek varrez e deshmor, Murrit rrethue, Muzeut, Punime grafike e reklama , punime plotesue te kompletuara	4,708,200
18	Rehabil I rrug hyrese per tek varrez e deshmor, Murrit rrethue, Muzeut, Punime grafike e reklama , punime plotesue te kompletuara	4,260,384
19	Mbikeqyrje Rehab rrug hyres per tek varrez e deshmor, Murit rrethue, Muzeut, Punime grafike e reklama, punime plotes te komplet	230,388
20	Ndertim I Terreneve Sportive -Shkolla Shtiqen	5,456,812
21	Ndertimi I terreneve sportive shkolla Shtiqen	3,630,480
22	Ndertimi I terreneve sportive Fshati Shtiqen	2,676,565
23	Kolaudim I punimeve "Ndertim I terreneve sportive Shkolla Shtiqen"	27,600
24	Ndertim I terreneve sportive	2,000,000
25	Mbikeqyrje punimesh "Rikonstruksion I rruges fshati Kolesjan"	103,200
26	Mbikeqyrje punimesh "Sistemim-Asfaltim ne unazen veriore te qytetit Kukes"	275,040
27	Mbikeqyrje punimesh Rikonstruksion I shkolles fshatit Fshat	105,480
28	Sistemim asfaltim I rruges Pallati I Kultures-Godina e Turizmit, Kukes	15,975,289
29	Asfaltimi I Rruges se fshatit Bushat	8,615,064
30	Rehabilitim I rruges Rilindja	9,914,721
31	Rehabilitim I Kanalit Ujites Bushat	7,203,906
32	Rehabilitim I Kanalit Ujites Bushat	2,796,094
33	Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare Fshat	108,439
34	Kolaudim I punimeve "Rehabilitimi I kanalit ujites Bushat"	30,000
35	Rehabilitim I kanalit ujites Shkinak-Leshe	1,676,008
36	Rehabilitim I kanalit ujites Bushat	2,703,711
37	Rehabilitim I kanalit ujites Bushat	1,632,804
38	Mbikeqyrje e punimeve "Rehabilitim I Kanalit ujites Bushat	315,420
39	Kolaudim I punimeve "Rehabilitim I kanalit ujites Shkinak-Leshe", Bushtrice	15,000
40	Optimizimi I furnizimit me uje faza II	61,198,022
41	Supervizim punimesh Studim-Projektim I optimizimit te furnizimit me uje te qytetit Kukes	772,140
42	Blerje makine teknologjike	11,070,000
43	Kamion multifunksional Ford Cargo Nr shasie NMOB19TEDE6M58500	7,290,000
44	Kamion multifunksional Benz Nr shasie NMB37532312066680	7,290,000

45	Fadrome Neë Holand Nr shashie N86H18678	2,340,000
46	Fadrome Hidromek Nr shashie 35B150022	2,340,000
47	Fadrome Neë Holand Nr shashie N86H19973	2,340,000
48	Kamion Veteshkarkimi Ford Nr shashie NMOB13TEDEDD5K51106	3,540,000
49	Kamion Veteshkarkimi Ford Nr shashie NMOB13TEDD5E52950	3,540,000
50	Pjese Makine	5,136,000
51	Traktor me zingjir	3,120,000
SHUMA TOTALE		257,135,966

Konkluzion: Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 719,722,580 lekë, e cila duhet të paraqesë vlerën pjesore të paguara të kontratave deri në vlerë të plotë të investimeve që janë në vazhdim të pa kapitalizuara. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se në gjendjen e saj ekzistojnë rreth 51 aktive në vlerën 257,135,966 lekë, të financuara në vlerë të plotë e të kapitalizuara nga kryerja e investimeve dhe janë marrë në dorëzim në vitet e mëparshme, të cilat në fakt nuk duhet të ishin pjesë e kësaj gjendje në këtë llogari, por duhet të shpërndaheshin në llogaritë e aktiveve përkatëse, sipas llojit nëpërmjet veprimeve kontabël. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 16/b,d dhe 18/a,b, Aneksi 1, Pika 2 Klasa 2.

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

në lekë				
Nr.	Referenca		Ushtrimi	Ushtrimi
Reshti	e	EMERTIMI	i	Paraardhes
	Llogarive		Mbyllur	
65	B	PASIVET (DETYRIMET)	753,096,997	667,862,894
66		I. Pasivet Afat shkurtra	753,096,997	667,862,894
67		1. Llogari te Pagushme	232,940,823	211,820,780
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	68,877,666	66,592,381
69	42	Detyrime ndaj personelit	33,528,513	26,796,617
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	5,134,016	5,403,554
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	14,525,760	19,200,272
76	436	Sigurime Shendetesore	1,221,370	1,601,424
77	437,438,	Organizma te tjere shtetore	230,243	254,305
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.etrave me vlere	15,000,000	15,000,000
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	41,236,493	23,392,531
82	467	Kreditore te ndryshem		392,934
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime)	53,186,762	53,186,762
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	520,156,174	456,042,114
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	470	Llogari ne pritje - Te ardhura per tu marre	520,156,174	456,042,114
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit		
91		II. Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	3,830,465,189	3,454,363,414
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	3,830,465,189	3,454,363,414
98	101	Teprica (Fondi I akumuluar)/Deficiti i akumuluar	2,648,214,226	2,799,751,118
99	12	Rezultatet e mbartura	11,461,860	80,452,936
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	295,796,128	149,444,012
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve	170,901,918	99,327,830

	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale te Brendshme	591,767,969	223,886,235
104	106	Teprica e Granteve kapitale te Huaja	112,323,088	101,501,283
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	4,583,562,186	4,122,226,308

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 753,096,997 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- ***Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”*** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarie në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 68,877,666 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 66,592,381 lekë, vlerë e cila ka ardhur në rritje, duke shtuar faturat e palikujduara për mallra, shërbime dhe investime të periudhës së fundvitit ushtrimor. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se, përbëhet nga 13 fatura të palikujduara ndaj të tretëve, borxh i krijuar në nëntor-dhjetor të vitit 2023, ku në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analiza e gjendjes së llog.401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”

Nr	Operatori Ekonomik	Shuma	Nr	Operatori Ekonomik	Shuma
1	I. D.	928,120	22	O. Shpk	83,080
2	B. sh.p.k	416,200	23	K. sha	2,443,720
3	B. sh.p.k	95,500	24	P. C. shpk	25,333
4	B. sh.p.k	53,300	25	P. C. shpk	33,600
5	E. P.	1,008,000	26	H.C.E-17 shpk	4,800
6	L. S.	780,000	27	R. 95 shpk	33,120
7	G- C GKG	1,840,000	28	N. S. shpk	19,800
8	R. shpk	36,372	29	I-D shpk	34,800
9	N. B.	99,600	30	P. shpk	108,000
10	N. S. shpk	20,400	31	I. Shpk	1,500,000
11	J. Projekt	33,000	32	O. shpk	1,246,524
12	Sh. Isp	259,020	33	A. shpk	1,223,129
13	Sh. Isp	86,340	34	M. shpk	10,969,243
14	Sh. Isp	86,340	35	C. shpk	35,949,383
15	Sh. Isp	86,340	36	B. H.	9,000
16	Sh. Isp	86,340	37	B. shpk	856,374
17	FEDERATA SHQIPTARE E VOLEJBOLLIT	6,500	38	M. H.	97,500
18	FEDERATA SHQIPTARE E BOKSIT	40,000	39	B. H.	97,000
19	O. shpk	6,436,884	40	D. shpk	42,960
20	B. T.	300,000	41	D. shpk	526,644
21	N. B.	35,400	42	L. D. shpk	840,000
Detyrimi Total 31.12.2023					68,877,666

- ***Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”*** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 33,528,513 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2024.

- ***Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”*** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën kontabël 5,134,016 lekë, e cila përfaqëson vlerën e detyrimeve të prapambetura për tatimin mbi të ardhurat personale në vlerën 3,475,102 dhe vlerën 1,658,914 sipas listëpagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2023 për detyrimet e tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2024.

- ***Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”*** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 14,525,760 lekë, e cila përfaqëson vlerën e detyrimeve të prapambetura për sigurime shoqërore në vlerën 5,600,346 dhe vlerën 8,925,414 sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor për 2023 sigurimet shoqërore, që do të paguhen në janar të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 436** “Sigurime shëndetësore” në fund të vitit 2023 është në vlerën kontabël 1,221,370 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 4341** “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet si në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 53,186,762 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit në vlerën 573,342,936 lekë përkatësisht: (gjendja e llog.468 "debitorë të ndryshëm" në vlerën 573,235,944 lekë + gjendja e llog.423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" në vlerën 106,992 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 466** “Kreditorë për mjete në ruajtje” përfshin garancitë e ngurtësuarra për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 41,236,493 lekë. Për këtë gjendje të llog. 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Kukës,

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 0 lekë. Kjo gjendje nuk është e saktë, pasi në këtë llogari duhej të kontabilizoheshin diferenca e faturave të palikujduara të krijuara mbi afatin prej 60 ditë të pagesës, të cilat në fakt janë kontabilizuar në llog.401-404 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” si dhe mungon vlera e faturave prej 86,668,986 lekë të energjisë elektrike, shërbimit postar dhe të ujit të pijshëm, detyrim e hershëm i raportuar në MF. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III pika 3.1 nënpika 42, Aneksi 1 pika 3.3/c.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim, sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2023 paraqitet në Aneks.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 1,865,766,082 lekë.

lekë, si dhe referuar aktrakordimit me Degën e Thesarit Kukës paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 53,975,046 lekë, i cili kuadron me aktrakordin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike 7002 “Tatim mbi biznesin e vogël” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 322,915 lekë e cila përfshin taksën mbi Biznesin e vogël, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë 7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 16,352,024 lekë, e cila përfshin taksën mbi ndërtesën dhe truallin, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë 7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 37,300,107 lekë, e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë 71 “Të ardhurat jo tatimore” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 66,606,953 lekë, i cila kuadron me aktrakordin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë 7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 3,257,156 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me aktrakordin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të thesarit.

b. Gjendja e llogarisë 711 “Shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 63,346,792 lekë, e cila përfshin tarifatat administrative, kamatvonesa,

tarifa shërbimesh, licenca etj. Kjo vlerë me aktrakordimin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* është në vlerën prej 0 lekë, vlerë e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë analoge 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"* në aktivin e bilancit, pasi kjo gjendje pasqyron detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 1,569,969,954 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 600 *"Paga, shpërblime e të tjera personeli"* për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 458,661,049 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 601 *"Kontribute për sigurime"* për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 76,975,228 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 602 *"Blerje mallra e shërbime"* paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 146,707,405 lekë.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 604 *"Transferime korente të brendshme"* paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 6894,982,554 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 606 *"Transferime për buxhetet familjare e Individe"* paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 892,900,706 lekë, e cila rakordon me aktrakordimin me thesarin.

Per vitin 2023 totali i të ardhurave është në vlerën 1,865,766,082 lekë dhe totali shpenzimeve është në vlerën 1,569,969,954 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 295,796,128 rakordon me gjendjen e llog.85 *"Rezultatit të ushtrimit"*

Gjithashtu gjendja e llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit"* është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2023 është në vlerën -7,689,687 lekë.

Formati nr.6 "Investimet dhe burimet e financimit"

- Zëri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën 84,342,797 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 82,934,123 lekë fonde të akorduara për investime, vlera prej 1,408,674 lekë investime të dhuruara në natyrë.

Nga testi kontrollit për vitet 2023 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Bashkia Kukës për veprimet me arkë, ku për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likujduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe kreut III, pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 *"Për limitin e arkës"*.

Liqishmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët (nëpërmjet nënshkrimit elektronik).

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga

punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të aktrakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- Pagesat e kryera jashtë afatit 30 ditë të paraqitjes së faturës.

Konkluzion: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2023 me urdhër-shpenzime në 60 raste faturash me vlerë 285,654,535 lekë, mbi afatin 30 ditë të faturave për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Kukës, ku 49 raste në vlerën 38,733,479 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llog. 602 “shpenzime operative” dhe në 11 raste në vlerën 246,921,056 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llog.231 “investime”, ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh dhe nga mungesa e akordimit të fondeve nga ministrite e linjes për financimet me buxhet shteti, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve. Likuidimi me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”. Rastet më konkretisht paraqiten në Aneks.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. M. I. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit (për periudhën 01.01.2023 -06.06.2023) dhe z. R. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit (për periudhën 06.06.2023-15.06.2024) në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe mbajtjes së kontabilitetit e hartuesit të PF.

2.4. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve dhe pyje e kullota) të transferuara sipas VKM.

2.4.1.Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

2.4.2.Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontrata e lidhura.

Për këtë pikë programi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Inventarët e aseteve të kaluara me VKM Bashkisë dhe NJA nga Pushteti Qendror.
2. Listat e aseteve të kaluara në pronësi të bashkisë së bashku me certifikatat hipotekore, si dhe lista e aseteve për të cilat janë përgatitur dokumentet tekniko-ligjore të depozituar në ASHK për pajisjen e Bashkisë me certifikatë hipotekore pronësie për këto asete.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- **Asetet e kaluara nga pushteti qendror pranë Bashkisë Kukës paraqiten, sipas VKM-ve**

Referuar të dhënave të Sektorit të Menaxhimit të Aseteve rezulton se, janë 4427 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë **Kukës**

dhe 14 e Njësive Administrative, listat e të cilave janë të miratuara me VKM-së përkatëse. Në mënyrë të përmblendhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Njësia Vendore	VKM		Në Pronësi/ përdorim Në numër	Listat në numër faqesh	Gjithsej prona të numeruara të transferuara	Faza e transferimit	Nga këto regjistruar Ne ASHK
		Numër	Datë					
1	Bashkia Kukës	167	10.03.2010	1520	1 - 794	1520	Perfundimtare	20
		37	18.01.2012	332	795 - 957	332	Perfundimtare	
		618	12.09.2012	8	958 - 965	8	Perfundimtare	
		115	13.02.2013	34	945 - 952 966 - 988	34	Perfundimtare	
	Nj.Adm.Kolsh	1382	17.10.2008		1 - 198	32	Fillestare	
2	Nj.Adm.Arrën	1700	03.09.2008		1 - 555	78	Fillestare	
3	Nj.Adm.Bushtricë	1263	17.09.2008		1 - 310	198	Fillestare	
4	Nj.Adm.Topoan	897	17.09.2008		1 - 119			
		45	27.01.2010		120 - 446	157	Fillestare	
5	Nj.Adm.Malzi	792	16.11.2006		1 - 524	984	Fillestare	
	Nj.Adm.Bicaj	1383	17.10.2008		1 - 1259	165	Paraprake	
	Nj.Adm.Ujmisht	71	21.01.2009		1 - 300	134	Paraprake	
	Nj.Adm.Shtiqen	1468	05.11.2028		1 - 27	73	Fillestare	
	Nj.Adm.Tërthore	942	26.12.2012		1 - 218	377	Paraprake	
	Nj.Adm.Surroj	569	14.07.2010		1 - 793	145	Perfundimtare	
	Nj.Adm.Kalis	186	19.02.2009		1 - 136	33	Fillestare	
	Nj.Adm.Zapod	112	03.02.2008		1 - 126		Paraprake	
		1002	10.12.2010		127 - 242	78	Paraprake	
	Nj.Adm.Gryk-Çajë	927	02.07.2008		1 - 223	34	Fillestare	
	Nj.Adm.Shishtavec	458	06.05.2009		1 - 141	45	Fillestare	
	Shuma					4427		

- Për **Bashkinë Kukës** janë transferuar 1520 prona me VKM nr. 167, datë 10. 03. 2010 (*prona 1520*), me VKM nr. 37, datë 18. 01. 2012 (*prona 332*), me VKM nr. 618, datë 12. 09. 2012 (*prona 8*), VKM nr. 115 datë 13. 02. 2013 me VKM nr. 815, datë 04. 06. 2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Kukës, të Qarkut Kukës” (*prona 34*).

- Për **Njësine Administrative Kolsh** janë transferuar 32 prona me VKM nr. 1382, datë 17.10.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Kolsh, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë fillestare.

- Për **Njësine Administrative Arrën** janë transferuar 78 prona të paluajtshme me VKM nr. 1700, datë 03/09/2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Arrën, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë fillestare.

- Për **Njësine Administrative Bushtricë** janë transferuar 198 prona të paluajtshme me VKM nr. 1263, datë 17.09.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Bushtricë, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë fillestare.

- Për **Njësine Administrative Topoan** janë transferuar 157 prona të paluajtshme me VKM nr. 45, datë 27.01.2010 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Bushtricë, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë fillestare.

- Për **Njësine Administrative Malzi** janë transferuar 984 prona të paluajtshme me VKM nr. 1113, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Malzi, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë fillestare.

- Për **Njësine Administrative Bicaj** janë transferuar 165 prona të paluajtshme me VKM nr. 1383, datë 17.10.2008 “Për miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Malzi, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë paraprake.

- Për **Njësine Administrative Ujmisht** janë transferuar 134 prona të paluajtshme me VKM nr. 71, datë 21.01.2009 “Për miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të

paluajtshme shtetërore të Komunës Ujmisht, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë paraprake.

- Për **Njësinë Administrative Shtiqën** janë transferuar 73 prona të paluajtshme me VKM nr. 1468, datë 05.11.2008 “Për miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Shtiqen, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë fillestare.

- Për **Njësinë Administrative Tërthore** janë transferuar 377 prona të paluajtshme me VKM nr. 942, datë 28.12.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Tërthore, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë përfundimtare.

- Për **Njësinë Administrative Surroj** janë transferuar 145 prona të paluajtshme me VKM nr. 569, datë 14.07.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Surroj, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë përfundimtare.

- Për **Njësinë Administrative Kalis** janë transferuar 33 prona të paluajtshme me VKM nr. 186, datë 19.02.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Kalis, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë fillestare.

- Për **Njësinë Administrative Zapod** janë transferuar 34 prona të paluajtshme me VKM nr. 1002, datë 10.12.2010 “Për miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Zapod, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë paraprake.

- Për **Njësinë Administrative Gryk-Çajë** janë transferuar 45 prona të paluajtshme me VKM nr. 927, datë 02.07.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Gryk-Çajë, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë fillestare.

- Për **Njësinë Administrative Shishtavec** janë transferuar 45 prona të paluajtshme me VKM nr. 458 datë 06.05.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Shishtavec, të Qarkut Kukës”, të cilat janë në fazë fillestare.

- **Pyjet dhe Kullotat**, janë transferuar në mënyrë të përmbledhur për gjithë territorin e Bashkisë Kukës në mënyrë përfundimtare gjithsej 3092 prona me VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave /Bashkive” me siperfaqe prej: 42566.99 ha. Nga ndryshimet e bëra me VKM nr. 684, datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.433, datë 08.06.2016 rezulton që, numri i pasurive është reduktuar në 3075 prona dhe siperfaqja është reduktuar në 41615.76 ha. Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me rregjistrimin e prona pyje dhe kullota rezulton se: Në vitin 2021 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka kontaktuar Kompaninë Datech për rregjistrimin e pronave dhe pyje dhe kullota të Bashkisë Kukës pranë ASHK. Për këtë ka bërë shpallje publike të këtyre pronave në ambientet e Brendshme të Bashkisë Kukes, sipas afateve ligjore 40 ditore për ankesa, kërkesa e dokumente plotësues etj. Pas përfundimit të regjistrimit të këtyre pronave pyje dhe kullota, Kompania Datech i ka sjellë në vitin 2021 Bashkisë listen e inventarit të përditësuar të pronave pyje dhe kullota, ku një kopje të tij e ka Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP) Tiranë, sipas transferimit përmbledhës gjithsej 3075 prona pyje dhe kullota të transferuara përfundimisht me VKM nr.684, datë 02.09.2020.

Me VKM nr. 59, datë 26.1.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore park kombëtar (kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore” dhe me VKM nr. 60, datë 26.1.2022 “Për shpalljen e ekosistemeve natyrore rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (kategoria IV), si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie” është

reduktuar perseri numri i pronave në 2901 prona dhe sipërfaqja e fondit pyjor është reduktuar në 40057.78 ha, e cila përbëhet nga:

- Pyje 34333.9 ha
- Kullotë 3446.18 ha
- Livadhe 2.4 ha
- Toka jo produktive, inproduktive, shkëmbore 2275.31 ha

Megjithatë procesi i regjistrimit në ASHK i pronave pyje-kullota nuk është realizuar, pasi mungon përgjigja e këtyre institucioneve për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave, si dhe nuk është përgatitur dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor i tyre dhe për pasojë nuk është aplikuar dhe nuk është kryer finalizimi i hipotekimit të këtyre pronave.

Në bazë të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, kreu III, neni 11, pika 2/b Drejtoria e Pyjeve ka të miratuar plan afatgjatë është hartuar plan menaxhimi e mbarështimi për pyjet dhe kullotat me vlefshmëri përdorimi për një periudhë 10 vjecare 2021-2031 në 5 ekonomi pyjore me shtrirje të gjërë. Ky plan afatgjatë mbarështimi I pyjeve dhe kullotave është miratuar me VKB nr.27 datë 30.03.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr.311, datë 12.04.2022 dhe i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.329, datë 26.10.2022.

- Asetet e regjistruara si pronë e Bashkisë pranë ASHK-Drejtoria Vendore Kukës

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, në total janë regjistruar 20 prona objekte inventari në rrugë, trotuare dhe sheshe, të cilat i përkasin aktiveve të klasifikuara si AAGJM të evidentuara me vlerë në PF dhe 7 prona nga listat e pronave të transferuara. Në mënyrë të përmblodhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si me poshtë:

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. pas	Nr. dok. hipotekor	Data e regjistrimit	ZK	Adresa	Sipërfaqja m ²	Sipërfaqja ndërtimore m ²	Pasqyruar ose jo në bilancin e Bashkisë.
1	Rrugë	23/9	2315002076	16/01/2023	2315	L.1,Kukës	601	0	
2	Trotuar	23/66	2315002125	17/01/2023	2315	L.1,Kukës	118	0	
3	Rrugë	22/1	2315015001	17/01/2023	2315	Kukës	2656	0	
4	Trotuar	23/68	2315002127	16/01/2023	2315	L.1,Kukës	471	0	
5	Trotuar	22/23	2315015018	17/01/2023	2315	L.1,Kukës	510	0	
6	Trotuar	17/51	2315012217	16/01/2023	2315	L.5,Kukës	251	0	
7	Rrugë	17/44	2315011169	16/01/2023	2315	L.5,Kukës	178	0	
8	Rrugë	17/32	2315005098	16/01/2023	2315	L.5,Kukës	330	0	
9	Shesh	17/18	231504077	16/01/2023	2315	L.5,Kukës	33	0	
10	Pyll	17/16	2315012229	16/01/2023	2315	L.5,Kukës	2192	0	
11	Trotuar	22/158	231533167	16/01/2023	2315	Kukës	952.4	0	
12	Shesh	17/8	2315002174	10/01/2023	2315	L.5,Kukës	2324	0	
13	Rrugë	17/23	2315004222	17/01/2023	2315	Kukës	234	0	
14	Pyll	17/34	2315014226	17/01/2023	2315	Kukës	710	0	
15	Rrugë	17/35	2315003130	17/01/2023	2315	L.5,Kukës	101	0	
16	Rrugë	17/36	2315005099	17/01/2023	2315	Kukës	302	0	
17	Rrugë	17/15	2315013142	17/01/2023	2315	Kukës	181	0	
18	Rrugë	17/12	231512192	17/01/2023	2315	L.5,Kukës	3131	0	
19	Shesh	34/212	2315037227	04/05/2023	2315	Rr.6,Kukës	192.1	0	
20	Shesh	27/186	2315037235	18/07/2023	2315	L.2, Kukës	2710.86	0	

Gjatë vitit 2023 janë bërë 20 aplikime për regjistrim pronash në ASHK edhe aplikime të tjera që janë në proces. Ndërsa për 50 prona është përgatitur dokumentacioni tekniko-ligjor, por nuk është vazhduar me aplikimet dhe procedurat për regjistrimin e tyre në ASHK për arsye financiare.

Referuar të dhënave të Sektorit të Administrimit të Pronave Publike rezulton se, janë 4427 pasuri të paluajtshme publike, shtetërore, janë transferuar në pronësi/përdorim Bashkisë Kukës, ku i kanë kaluar përfundimisht 1894 pasuri Bashkisë (Qendër) dhe 145 pasuri NJA Surroj sipas listave përfundimtare të miratuara me VKM-ët përkatëse, ndërsa për 2388 pasuri

të 13 Njësi Administrative si **Kolsh, Arrën, Bushtricë, Topojan, Malzi, Shtiqën, Kalis, Gryk-Çajë, Shishtavec** janë në fazën fillestare të miratimit dhe **Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Zapod** janë në fazën e miratimit të listave paraprake. Nga këto prona janë hipotekuar 20 prona dhe janë në proces hipotekimi 20 prona të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë inventarizimi dhe përditësimi i të dhënave të këtyre pronave, pasi duhet që përmjet verifikimit në terren, dokumentacionit dhe korrespondencës zyrtare me institucionet përkatëse për statusin e tyre duhen identifikuar e propozuar e marrjen masave për ndjekjen e procedurave ligjore për të vepruar me ato prona që janë inekzistente fizikisht, të zaptuara, të kthyer prona apo të privatizuara të cilat duhen identifikuar në listat e pronave.

Spektori i Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Publike, në bazë të nenet 109-110 të Rregullores së Brendshme të miratuar me urdhrin e titullarit nr.328, datë 05.04.2024 ka si objekt të veprimtarisë së saj inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave dhe regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, por kjo strukturë është miratuar me 3 punonjës, me 1 përgjegjës dhe 2 specialist. Krahas kësaj strukture, që në fakt nuk ka kapacitete të plota për të kryer këtë proces Titullari i Bashkisë nuk ka nxjerrë asnjë urdher për ngritjen e grupeve të punës për verifikimin e gjendjes faktike të pronës në terren dhe matjen faktike të pasurisë, për kryerjen dhe verifikimin e gjendjes juridike të pronës nëpërmjet ASHK për informacion të plotë për gjendjen e pronës, përpunim i të dhënave të hedhura në sistemin përkatës të secilës pasuri sipas ZK, plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për çdo pronë dhe dërgimi i dosjes përkatëse me listën e pronave shtetërore të përditësuar pranë DV-ASHK Kukës.

Në mungesë të inventarizimit, përditësimit dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

Mos kryerja e procedurave për mos përditësimin e listave paraprake dhe fillestare të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM për 13 NJA Kolsh, Arrën, Bushtricë, Topojan, Malzi, Shtiqën, Kalis, Gryk-Çajë, Shishtavec, Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Zapod, si rrjedhojë mos paraqitja më pas pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e të dhënave të listë-inventarëve të pronave, mos regjistrimi në ASHK në favor të Bashkisë i pjesës më të madhe të këtyre pronave të listuara, si dhe mosvlerësimi i tyre janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18,22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësive në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”.

➤ *Të ardhura të munguara nga mos pagesa e qirave të kontratave të aseteve.*

Bashkia Kukës në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 31 kontrata me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 1-10 vjet për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Nga këto:

Në bazë të VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” dhe

Udhëzimit nr. 13, datë 26.04.2018, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, nga Bashkia Kukës janë lidhur 12 kontrata 1-vjeçare, nga të cilat në 10 raste kontratat janë dhënë me qira objekti (parkim dhe dyqan) brenda ambjentëve të tregut agro-ushqimor të qytetit Kukës, në 1 rast kontrate dhënie me qira sipërfaqe trualli për shoqëri private për vendosje reklamash për subjekte të ndryshme dhe në 1 rast kontratë qiraje për lokal tek pallati i kulturës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të këtyre kontratave rezulton se, nuk kanë paguar detyrimin kontraktor 10 subjekte deri në fund të vitit 2023 në vlerën vjetore 693,000 lekë, vlerë të cilën e kanë paguar në vitin 2024 në kundërshtim me nenin 5 të kontratës, pasi në kontratë parashikohet pagesë mujore sipas tarifës së qirasë lekë/në muaj. Në të gjitha rastet kontratat për dhënien me qira të objekteve të tregut nuk është shoqëruar me inventarizimin fizik të gjendjes fizike me procesverbalin e marrjes në dorëzim në kundërshtim me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 826/pika 4, i cili përcakton se: *“Qiradhënësi me anë inventarit i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme, si tokën bujqësore, kullotat, ndërtesat e banimit e ato ndihmëse në shërbim të veprimtarisë bujqësore e blegtorale, si dhe sendet e luajtshme në shërbim të kësaj veprimtarie”*

Kontratat aktive dhe jo aktive për asetet e dhëna me qira

Nr.	Subjekti	Kontrata nr. datë	Sipërf	Afati në vite	Vlera Vjetore e Qirasë	Aktiviteti	Detyrimi në 2023	Paguar	Debitore 2023	Shenime
1	A. M.	17.08.2023	16.25 m2	5 muaj	4.875	Dyqan	4.875	4.875		
2	A. shpk	24.01.2023	142 m2	1 vit	1.917.000	Vendos reklama	1.917.000	1.917.000		
3	F. C.	02.05.2023	25 m2	5 vite	3750 lek/ muaj	Lokal Q.Kulture	30.000(8-muaj	-	30,000	pagu 2024
4	G. P.	12.01.2023	160 m2	1 vit	8.000 lek/ muaj	Dyqan te tregu	96.000		96,000	pagu 2024
5	A. N.	17.01.2023		1 vit	5.000 lek/muaj	Dyqan te tregu	60.000	5.000	55,000	pagu 2024
6	A. D.	17.01.2023		1 vit	10.000 lek/muaj	Dyqan te tregu	120.000	70.000	50,000	pagu 2024
7	A. D.	17.01.2023		1 vit	5.000	Dyqan te tregu	60.000	5.000	55,000	pagu 2024
8	S. B.	17.01.2023		1 vit	8.000	Dyqan te tregu	96.000	-	96,000	pagu 2024
9	H. Sh.	17.01.2023		1 vit	10.000	Dyqan te tregu	120.000	110.000	1,000	
10	N. Sh.	17.01.2025		1 vit	5.000	Dyqan te tregu	60.000	-	60,000	pagu 2024
11	B. A.	17.01.2024		1 vit	10.000	Dyqan te tregu	120.000	90.000	30,000	pagu 2024
12	S. R.	17.01.2024		1 vit	20.000	Dyqan te tregu	240.000	20.000	220,000	pagu 2024
									693,000	

• Janë lidhur 11 kontrata për shfrytëzimin e parcelave nga fondi pyjor/kullosor, për aktivitet për agroturizëm, vend-depozitim minerali dhe erë-matëse, etj. Kontrata e qiradhënies të lidhura nga Bashkia Kukës me treguesit e tyre pagesat dhe detyrimet e papaguara paraqiten në Aneks.

Kontratat për dhënie me qira të parcelave pyjore/kullosore për rrugë, shesh depozitimi minerali, agroturizëm

Nr.	Subjekti	Kontrata nr. datë	Sip ha	Rruge km	Afati në vite	Vlera Vjetore e Qirasë	Debitor 31.12.2022	Detyrimi në 2023	Paguar	Debitor 2023	Lloji i aktivitetit
1	V. Sh. p.f	13.03.2023	0.677		5	70,400	0	70,400	70,400		Bujtina
2	M. L. p.f	02.06.2023	0.2		10	10,000	0	10,000	10,000		Bujtina e lokal
3	"N. - B"sh.p.k	27.03.2017	1.085		8	108,500	0	108,500	108,500		Shesh Depozitimi
4	Q. Ll. p.f	17.09.2017	1		8	101,000	0	101,000	101,000		Shesh Depozitimi
5	T. A. sh.a	07.09.2016	0.015		9	82,500	0	82,500	82,500		Antene
6	V. I.- shpk	30.07.2019	1.2		5	300,000	0	300,000	300,000		Shesh Depozitimi
7	V. I.-shpk	30.07.2019		1.748	5	105,348	0	105,348	105,348		Rruge
8	"A-K" sh.p.k	30.05.2022	1		5	160,000	0	160,000	160,000		Shesh Depozitimi
9	"H. P." p.f	03.02.2022	0.07		5	6,300	0	6,300	6,300		Bujtina
10	Ë. S. sh.p.k	17.07.2022	0.32		2	58,880	0	58,880	58,880		Ere-matëse
11	F. Ll. p.f	21.10.2022	0.5		9	230,000	0	230,000	230,000		Bujtina
									1,232,928		

Në vitin 2023 janë lidhur 2 kontrata nga ish-nën/Kryetari i Bashkisë (i deleguar) me persona fizik :

1. Me shkresën nr.prot. 73, datë 02.06.2023 është lidhur kontratë qiraje me personin fizik (PF) M. L., miratuar me VKB nr.09, datë 27.02.2023, ku sipas nenit 1 “Objekti i kontratës” dhe neni 2 “Qëllimi” përcaktohet: “Dhënie me qira e pasurisë të sipërfaqes prej 0.2 ha e ndodhur në ekonominë pyjore, Bushtricë NJA Bushtricë Bashkia Kukës (Rruga nacionale Kukës-Peshkopi), ngastra 83/a për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënd lojrash, mjedise sportive-shlodhëse etj.). Afati i kontratës është 10-vjeçar.

2. Me shkresën nr.prot. 48, datë 13.03.2023 është lidhur kontratë qiraje me personin fizik (PF) V. Sh., miratuar me VKB nr.68, datë 25.11.2022, ku sipas nenit 1 “Objekti i kontratës” dhe neni 2 “Qëllimi” përcaktohet: “Dhënie me qira e pasurisë të sipërfaqes prej 0.677 ha e ndodhur në ekonominë pyjore, Bicaj-Kolesjan NJA Bicaj, Bashkia Kukës, parcela 120/b për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënd lojrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.). Afati i kontratës është 5-vjeçar.

Për dhënien në shfrytëzim të këtyre parcelave nga fondi pyjor/kullosor janë zhvilluar procedura ankandesh. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura rezulton se, në të dy rastet janë paraqitur 1 ofertues, por dokumentacionit të tyre u mungojnë:

- garancia financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes (vërtetimi bankar për gjendjen), dokumenti që vërteton se ka të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë në kundërshtim me kriteret e veçanta të kualifikimit të DSA, rubrikën: kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë, pika 6/1,2 “Kushtet e pjesmarrjes në konkurrin” dhe Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit kullosor publik” Kreu V, pika 5.

- dëgjesa publike, leja e ndërtimit të Bar-Restorantit, statusi juridik i parcelës nga ASHK bashkëlidhur me dokumentacionin miratimit me VKB në kundërshtim me - ligjit nr. 57, datë 30.04.2020, “Për pyjet” i ndryshuar, neni 17 “Përgjegjësitë e strukturave vendore përgjegjëse për pyjet”, pika 1/f në të cilën përcaktohet se: *“f) 1. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki ka këto detyra: f. bashkëpunon me shoqërinë civile dhe organizatat e ngritura mbi baza ligjore me objekt të tyre “pyllin”, si dhe garanton gjithë përfshirjen e popullsisë lokale për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor që ka në pronësi.”*

- ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, **Neni 18** “Seancat e këshillimeve me bashkësinë” përcaktohet se: *“Pika 1. Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, dhe 77, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të këtij ligji. Neni 54 “Kompetencat e Këshillit Bashkiak”, nënpika (e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve”.*

- proces-verbali i dorëzimit të parcelës, detyrim që nuk është parashikuar në kontratë si dhe në rastin e kontratës 10-vjeçare nuk është noterizuar në kundërshtim me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku **neni 826**, përcakton se: *Kontrata e qirasë të pasurisë së paluajtshme që shërben për kultivimin bujqësor për një kohë mbi 9 vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.”, neni 826 pika 4, i cili përcakton se: “Qiradhënësi me anë inventarit i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme, si tokën bujqësore, kullotat, ndërtesat e banimit e ato ndihmëse në shërbim të veprimtarisë bujqësore e blegtorale, si dhe sendet e luajtshme në shërbim të kësaj veprimtarie”.*

- Gjatë vitit 2023 janë aktive 7 kontrata për dhënie me qira të parcelave pyjore-kullosore për instalim antene të telefonisë celulare, ku në vitin 2024 janë përmbledhur 4 kontrata, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Kontrata nr. datë	Sip ha	Rrug km	Afat i në vite	Vlera Vjetore e Qirasë	Debitor 2022	Detyrimi në 2023	Paguar	Debitore 31.12.2023	Lloji i aktivitetit
1	"V. A." sh.a (site 1253 kalimashi)	30.04.2017	0.006		5	51.000	0	51.000		0	Antene
2	"V. A." sh.a (site 451 Morin)	01.05.2015	0.03	0,9	7	300.000	0	300.000		0	Antene
3	"V. A." sh.a (site 453 kukes south)	07.09.2018	0,025	0,75	5	250.000	0	250.000		0	Antene
4	"V. A." sh.a (site 1253 kalimashi) (site 451 Morin) (site 453 kukes south)	13.03.2024	0,061	1,65	5	601.000	601,000	765,236	601,000	765,236	Antena paguar 2024 (site 1253 kalimashi) (site 451 Morin) (site 453 kukes south)
5	"A.sh.a kalon në "O. A."sh.a	31.01.2022	0.04	0,8	1	300.000	0	300.000	300.000	0	Antene
6	"O. A."sh.a	13.08.2024	0,04	0,8	5	300.000	300,000	450.000	300.000	450,000	Antene
7	"A.C"Sh.a kalon në "O. A."sh.a	05.08.2014	0,015		10	82,500	0	82,500	82.500	0	Antene
										1,215,236	

Konkluzion: Nga verifikimi i dokumentacioni e dosjeve të kontratave dhe pagesave të kryera rezulton se, në fund të vitit 2023 paraqiten 2 subjekte qiramarrës (sipërfaqe pyjore) me detyrime kontraktore të papaguara në **vlërën 1,215,236 lekë**, veprime këto në kundërshtim me kontratat e lidhura të qiradhënies neni 4 "vlera e qirasë vjetore" dhe neni 5 "pagesa dhe regjimi i saj".

• **Konkluzion:** Referuar të dhënave të AKBN në territorin e Bashkisë Kukës, 19 shoqëri private kanë marrë licencën për ndërtim dhe ushtrim aktivitetit për 34 HEC-e, ku nga këto në 2 raste Hec-et janë në parcela që shtrihen në zona të mbrojtura të kaluara AKZM dhe në 4 raste parcelat janë hequr nga fondi pyjor/kullosor, ku të 6 rastet janë miratuar me VKM. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kontratave të qiradhënies me shoqëritë që ushtrojnë aktivitet HEC rezulton se, për periudhën objekt auditimi në 13 raste të Hec-ve pas vitit 2021 nuk janë lidhur kontrata qiradhënie me subjektet private për sipërfaqet pyjore/kullosore, që shfrytëzojnë për arsye se nga këto: në 1 rast tubacionet i kanë futur nën tokë, në 5 raste akoma nuk janë pajisur me leje ndërtimi, dhe në 7 raste nuk ka të dhëna. Në këto raste pavarësisht se nuk është marrë leja e ndërtimit (në AZHT), nga këto shoqëri për objektin e kryesor të kontratës, parcelat e marra me qira nga fondi pyjor-kullosor kanë vazhduar të mbajnë të bllokuara mbi 1 vit, duke mos lejuar Bashkinë të ketë në dispozicion për vënie në shfrytëzim nga qiramarrës të tjerë me pasojë shkaktimin e të **ardhurave të munguara** për buxhetin e Bashkisë Kukës. Rastet paraqiten të detajuara më poshtë:

Kontratat aktive dhe jo aktive për dhënie me qira të parcelave pyjore-kullosore për ndërtim të HEC-eve

Nr.	Subjekti	Kontrata nr. datë	Sip ha	Rrug km	Afat i në vite	Vlera Vjetore e Qirasë	Debit or 2022	Detyrimi në 2023	Paguar	Ardhura të munguara	Lloji i aktivitetit	Statusi
	E. sh.p.k E. G. T. sh.p.k L 1,2,3	15.03.2022 amendim kontrate Nr. 3868 05.10.2018	0.467	0	5	411,598	0	0	411,598	411,598	HEC	Hec 1 i ndërtuar, 2 dhe 3 nuk ka filluar ndërtimi
	Subjekti A-K sh.p.k (H. Th.)	Nr. 37 Prot date 20.05.2017-10.05.2020 Amendim kontrate Nr. 29/3 Prot date 04.07.2018	2.0016	0	3	Viti 1: 666,570 Viti 2: 657,125	0	0	Viti 1: 666,570 Viti 2: 657,125		HEC	I ndërtuar nuk ka kontrate, futur nëntokë tubacioni
1	Subjekti K. H. sh.p.k (Hec V 2)	Nr. 32 date 03.06.2019-02.06.2020	1.03	0	1	500,250	0	0	500,250	0	2 HEC	I ndërtuar, pa kontrate, tubacioni nën tokë
	Subjekti E. E. sh.p.k (Hec Q)	Nr. 32 Prot date 08.08.2018-08.08.2021	0.3262	0	3	346,084	0	0	346,084	346,084	HEC	I pa ndërtuar, pa kontratë, pa leje

												ndertim në AZHT
2	L. & K. E. (H. K.- L-D)	Nr. 79 Prot date 19.12.2017-18.12.2020	1.3327	0	3	Viti 1: 1,019,315 Viti 2: 903,265	0	0	Viti 1: 1,019,315 Viti 2: 903,265	903,265	3 HEC	I pa ndertuar, pa kontratë, pa leje ndertimi
3	E-P sh.p.k (H. Z. K.)	Nr. 20 Prot date 21.05.2018-20.4.2021	0.53	0	3	254,040	0	0	254,040	254,040	1 HEC	I pa ndertuar, pa kontratë, pa leje ndertimi
	L. I. sh.a (H. Q. 1)	Nr. 62 Prot date 04.08.2017-03.08.2019	0.5909	0	2	Viti 1: 651,431 Viti 2: 558,731	0	0	Viti 1: 651,431 Viti 2: 558,731		HEC	I ndertuar, pa kontratë sepse ka kaluar ADZM
	L. I. sh.a (H. Q. 1)	Nr. 75 Prot date 04.12.2018-03.12.2020	0	1.737 Km	2	79,975	0	0	79,975	0	Linje Elekt	I ndertuar ka kaluar ADZM
4	"E. E."sh.p.k	08.08.2018-08.08.2021	0.0751			79,975			79,975	79,975	Linje Elekt	Pagesa hyn ne fuqi pas marrjes se lejes "AZHT"
5	V.B N.- sh.p.k		0.9		5	652,239				652,239	1 HEC	Pagesa hyn ne fuqi pas marrjes se lejes "AZHT"
6	H. G-E. sh.p.k		2.1349		5	894,479				894,479	1 HEC	Pagesa hyn ne fuqi pas marrjes se lejes "AZHT"
	H. K.		0.1796		2	95,062				95,062	HEC	Pagesa hyn ne fuqi pas marrjes se lejes "AZHT"
7	"Gj.-S. P." sh.p.k	Lapaj, Bushtrice									1 HEC	
8	T. H. shpk	Borje, Oreshke, Cernaleve 1, Cernaleve									1 HEC	
9	"E. E.G. " Sh.p.k (2); E. shpk(1); A-E shpk (2);	Bele 1 & Topojan 2; Orgjost i Ri; Bele 2 & Topojan 1;									5 HEC	
10	"E. 2-E." shpk; L.E	Shemri; Mgull;									2 HEC	
11	Th.sh.p.k	Domaj (ROT)									1 HEC	
12	"E. P." shpk	Pobreg									1 HEC	
13	"R. E." shpk	Meshteken: Zaje, Turaj, Xhaferraj, Kollovoz, Novoseje, Meshteken									6 HEC	
14	"E" sh.p.k.	Lusen 1,2,3									2 HEC	VKM 822/17
15	"L. I." shpk	Qami 1									1 HEC	VKM 822/44
16	"E. E"	Qami									1 HEC	VKM 822/69
17	H.K.	Lusen 1,2,3									3 HEC	VKM 822/88
18	"A. K"	Thanza									1 HEC	VKM 822/27
19	H.T.shpk	Terfoje									1 HEC	VKM 822/28

• Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së dhe të dhënave të Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve, rezulton se në territorin e Bashkisë Kukës ushtrojnë aktivitetin 29 subjekte për prodhim dhe nxjerrje minerare në formë karriere dhe galerie, në territorin e Bashkisë Kukës, nga të cilat në 7 raste subjektsh parcelat që shfrytëzohen janë hequr nga fondi pyjor me VKM, në 5 raste subjektsh është dhënë dakortësia nga këshilli bashkiak me VKB përkatëse për heqje të parcelave që shfrytëzojnë nga fondi pyjor/kullosor, por akoma nuk janë miratuar me VKM ose me urdhër të Ministrit të Mjedisit. Në 23 raste subjektsh që nuk janë kryer procedurat e heqjes nga fondi pyjor/kullosor të parcelave që kanë shfrytëzuar për prodhim e nxjerrje minerali, ku 13 subjekte kanë mbyllur aktivitetin, 4 subjekte vazhdojnë akoma aktivitetin në parcelat pyjore/kullosore pronë e Bashkisë, si dhe 6 subjekte sipas AKBN janë të pajisura me licenca aktiviteti në harkun kohor 2007-2010 për të cilat nuk ka të dhëna të tjera, nuk janë lidhur kontrata, duke sjellë të ardhura të munguara dhe mos kompensim i sipërfaqeve të pyllëzuara, sipas VKM nr.537, datë 28.02.2021 “Për përcaktimin e kostove të përllogaritura për pyllëzim kompensues në rastin e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”. Në pikat 3 e 4 të nenit 25 “Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar” të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet” në nenin 25 “Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar” në **pikën 3** përcaktohet se: “3. *Dhënia në shfrytëzim/përdorim e pjesëve të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e përmendura në*

pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë të kontratave të nënshkuara nga kryetari i bashkisë/organi përgjegjës për zonat e mbrojtura kur përfshihet në këto zona. Kontratat përfundojnë në çastin, kur KKT-ja miraton tjetër zhvillim për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar, objekt kontrate. Rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për këto veprimtari caktohen me udhëzim të ministrit.” Rastet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet nxjerrje prodhim minerale në mënyrë të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Subjektet që kanë heqje të parcelave që shfrytëzojnë nga fondi pyjor/kullor (aktivitetet minerare)

Nr.	Bashkia	Lloji i Aktit Ligjor (Urdhër Ministri, V.K.M, Ligj)	Data e Urdhërit ose kontratës nëse ka	Sip e përgjithshme e hequr në ha	Ekonomia pyjore/ kullorore	Emri i Subjektit	Lloji i Aktivitetit Minerar	Raport Teknik Miratuar/ Pa miratuar
1.	Kukës	VKM nr. 972	02.12.2015	29.5	Mamëz-Kalimash	A. G. sh.p.k	Karrier	Miratuar
2.	Kukës	VKM nr. 259	25.03.2015	12.28	Mamëz-Kalimash	K. i Th. sh.p.k	Karrier	Miratuar
3.	Kukës	VKM nr. 135	22.02.2017	38.6	Mamëz-Kalimash	Ll. sh.p.k	Karrier	Miratuar
4.	Kukës	VKM nr. 112	15.02.2017	16.92	Surroj	M. F. Shpk	Karrier	Miratuar
5.	Kukës	VKM nr. 51	21.01.2015	4.1	Mamëz-Kalimash	V. D. sh.p.k	Karrier	Miratuar
6.	Kukës	VKM nr. 134	22.02.2017	1.18	Mamëz-Kalimash	V. D. sh.p.k	Fabrika	Miratuar
7.	Kukës	Urdhër Minis nr. 25	04.02.2020	0.5	Gjallice e Lumës	S. sh.p.k	Kantier Ndertim	Miratuar

Subjektet për të cilat është dhënë dakortësia nga këshilli bashkiak për heqje nga fondi pyjor/kullor të parcelave që shfrytëzojnë, por nuk kanë marrë aktin (Urdhër, VKM , ligj) për heqje.

(aktivitetet minerare)

Nr.	Bashkia	Lloji i Aktit Ligjor (V.K.B)	Data e miratimit e VKB	Sip e kërkuar në ha	Ekonomia pyjore/ kullorore	Emri i Subjektit	Lloji i Aktivitetit Minerar	Raport Teknik Miratuar/ Pamiatuar
1.	Kukës	V.K.B. 66	29.07.2021	8.3	Mamëz-Kalimash	"I." sh.p.k	Karrier	Miratuar
2.	Kukës	V.K.B. 84&85	23.12.2022	10&39.9	Tërthore e Lumës	T.M..al sh.p.k	Karrier	Miratuar
3.	Kukës	V.K.B. 17	25.02.2021	36.5	Mamëz-Kalimash	N.-B sh.p.k	Karrier	Miratuar
4.	Kukës	V.K.B. 53&54	29.10.2021	8.5&7.75	Mamëz-Kalimash	N. F.sh.p.k	Karrier	Miratuar
5.	Kukës	V.K.B. 52	29.10.2021	9	Mamëz-Kalimash	V. D sh.p.k	Karrier	Miratuar

Subjektet të cilat nuk kanë heqje nga fondi pyjor/kullor të parcelave që shfrytëzojnë dhe nuk kanë marrë dakortësinë nga Këshilli Bashkiak.(aktivitetet minerare)

Nr.	Lloji i Aktit Ligjor (Leje Minerare)	Data e lejes minerare	Vend-ndodhja e objektit	Ekonomia pyjore/ kullorore	Emri i Subjektit	Lloji i Aktivitetit Minerar	Heqje nga fondi pyjor
1.	Nr. 1752	27.04.2015	Arre-Molle	Arren	"A-K" sh.p.k	Shfrytez Hekur-Nikel karrier	Nuk ka heqje (Nuk vazhd aktivitet).
2.	Nr. 1529	13.12.2010	Mamez	Mamez-Kalimash	"O" sh.p.k	Shfrytez Hekur-Nikel karrier	Nuk ka heqje (Nuk vazhd aktivitet).
3.	Nr. 1408	01.09.2009	Mamez	Mamez-Kalimash	"N-M"	Shfrytez Hekur-Nikel karrier	Nuk ka heqje (Nuk vazhd aktivitet).
4.	Nr. 1732	29.10.2014	Surroj	Mamez-Kalimash	"S." sh.p.k	Shfrytez Hekur-Nikel karrier	Nuk ka heqje (Nuk vazhd aktivitet).
5.	Nr. 1579	02.10.2012	Are-Toter	Surroj	"A & N" sh.p.k	Shfrytez Kromi me karriere	Nuk ka heqje (Nuk vazhd aktivitet).
6.	Nr. 1424	11.09.2009	Kolsh	Mamez-Kalimash	"A-B"	Shfrytez Kromi me karriere	Nuk ka heqje (Nuk vazhd aktivitet).
7.	Nr. 1472	24.05.2010	Surroj	Surroj	"A" sh.p.k	Shfrytez Kromi me karriere	Nuk ka heqje (Nuk vazhd aktivitet).
8.	Nr.1886	07.02.2023	Surroj	Surroj	"P. G"	Shfrytez Kromi me karriere	Nuk ka heqje (Nuk vazhd aktivitet).
9.	Nr. 1680	09.09.2013	Thanez-Kolsh	Mamez-Kalimash	"B-XH" ndryshuar "K C M."	Shfrytez Kromi me karriere	Nuk ka heqje (Vazhdon aktivitetin).
10.	Nr. 1817	26.09.2016	Kalimash	Mamez-Kalimash	M-XH – 2014" sh.p.k	Shfrytez Kromi me karriere	Nuk ka heqje (Nuk vazhdon aktivitetin).
11.	Nr. 1650	30.07.2013	Kalimash	Mamez-Kalimash	I "I M I" sh.a	Shfrytez Kromi me karriere	Nuk ka heqje (Vazhdon aktivitetin).
12.	Nr. 1803	04.05.2018	Kalimash	Mamez-Kalimash	"B" sh..p.k	Shfrytez Kromi me karriere	Nuk ka heqje (Nuk vazhd aktivitet).
13.	Nr. 1677	06.09.2013	Mamez	Mamez-Kalimash	"V. I.	Shfrytez Hekur-Nikel karrier	Nuk ka heqje (Nuk vazhdon aktivitetin).
14.	Nr. 1863	18.07.2022	Perroi I Rrunes	Mamez-Kalimash	"F. e P. te K.B."	Shfrytez Kromi me karriere	Nuk ka heqje (Nuk vazhdon aktivitetin).
15.	Nr. 1582 Nr. 1801 Nr. 1802	17.10.2012 20.05.2016 26.05.2016	Lugjas	Mamez-Kalimash	"T.-A. K." sh.p.k	Shfrytez Kromi me karriere	Nuk ka heqje (Nuk vazhdon aktivitetin).

16.	Nr. 459	22.09.2017	Kapit	Surroj	"L"	Shfrytez Kromi me galeri	
17.	Nr. 1374 Nr. 1533	23.06.2009 12.01.2011	Kalimash	Mamez-Kalimash	"K." sh.p.k	Shfrytez Kromi me karriere	Nuk ka heqje (Nuk vazhdon aktivitetin).
18	1049/1	31.07.2007	Kodra e Nocit Kalla, Shishtav		A - F	Kuarc	
19	1051/1	03.08.2007	Përroi Thatë		K. K.	Gëlqeror I mermer	
20	1515	19.11.2010	Lajthizë, Orosh , Mirdite		B.(S. A. M. R. e N.K)	Krom	
21	1712/1	02.06.2014	Laku i Çupit, Malzi		K.CH. M	Krom	
22	1727	16.09.2014	Gjegjan		T. M. AL shpk	Krom	
23	1837	25.07.2017	Objekti Bicaj		G. shpk	Gur Gëlqeror	

Nuk është miratuar ndryshimi nga fondi pyjor, parakushti për zhvillimin e aktiviteti minerar në Republikën e Shqipërisë, veprim në kundërshtim pikat 3, 5 e 8 të nenit 5 të ligjit 57/2020 "Për Pyjet" (nenin 17 "Heqja e sipërfaqeve (tokave) nga fondi pyjor kombëtar" të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar.)

Nga Bashkia Kukës nuk është kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe. Gjithashtu nuk i është kërkuar Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Mos lidhja e kontratave të qirave me subjektet private është në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 391, datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", me VKM nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore" i ndryshuar me VKM nr.267, datë 27.04.2023.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z. S. Gj. në funksionin e ish-Kryetarit të Bashkisë Kukës, z. G. Gj. në funksionin e ish-nën/Kryetarit të Bashkisë (larguar 16.09.2023), z. A. Z. me detyrë Përgjegjës Sektori i Administrimit të Pronave Publike, z. I.D. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve (për periudhën 02.06.2023 - 01.12.2023), zj. M. D. me detyrë ish-Drejtoreshë e Drejtorisë Juridike e Prokurimeve Publike (për periudhën 01.01.2023- 24.03.2024).

2.5. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

2.5.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

2.5.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

2.5.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- Detyrat e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën e KLSH-së, 524/10 Prot, datë 13.12.2023
- Korespondenca shkresore e ndjekur nga Bashkia Kukës dhe KLSH.
- Dokumentacioni shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve.
- Dokumentacioni i mbajtur nga Këshilli Drejtues për këtë qëllim, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

- Bashkia Kukës, ka respektuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Bashkia Kukës, nuk ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të neni 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Realizimi i rekomandimeve në mënyrë të detajuar pasqyrohet si më poshtë vijon:

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacioni që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Kukës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.205, datë 11.12.2023, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 524/10 Prot, datë 13.12.2023 verifikohet se:

- Bashkia Kukës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH ka nxjerrë plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH dhe me shkresën nr.966/1, datë 26.12.2023 “Program Pune, për zbatimin e detyrave të lëna të nga KLSH” ka dërguar kthimin e përgjigjes mbi zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Nga Bashkia Kukës nuk është kthyer përgjigje për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, referuar ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë **27** masa gjithsej, nga të cilat **18** Masa Organizative, **2** masa për shpërblim dëmi, **5** masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë detyrimet nga qiradhënia(të ardhura të munguara) dhe masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për **2** punonjës dhe “Vërejtje” për **18** punonjës. Po kështu janë trajtuar edhe **19** rekomandimet e lëna në auditimet e mëparshme të cilat janë zbatuar në masën 21%.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Nga **18** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **8** janë zbatuar plotësisht, **7** janë në proces zbatimi dhe **3** nuk janë zbatuar.

- Nga **2** masa për shpërblim dëmi e rekomanduar **2** janë në proces zbatimi.

- Nga **5** masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë detyrimet nga qiradhënia(të ardhura të munguara)**4** janë pa zbatuar dhe **1** në proces zbatimi.

- Nga **2** masa disiplinore për **20** punonjës, ato janë zbatuar plotësisht

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 1.1. Nga Titullari i Bashkisë Kukës, me atributet e Kryetarit të GMS e të Nëpunësit Autorizues si dhe Koordinatorit të Riskut, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe

kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë. Të merren masa për përcaktimin e detyrave dhe kompetencave sipas pozicioneve të strukturës së Bashkisë. Të kryhet monitorimi i respektimit të afateve për trajtimin e kërkesave/ankesave në mënyrë që të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit ndaj qytetarëve. Të merren masa që të plotësohet struktura e punonjësve si dhe krijimi i organigramave sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjia e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës dhe Drejtori i kësaj drejtorie me cilësinë e sekretarit të GMS kanë informuar vazhdimisht dhe kanë bërë të njohur nga ana e të gjithë anëtarëve të GMS-së dhe EMP-të, të gjitha problemet dhe gjithë dokumentacionin mbi vetëvlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK), (Dokumentet çdo fillim viti p.sh: Shkresa Nr.684 datë 24.02.2023 Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Financave) hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit për çdo fillim viti. (Kërkesë për identifikimin e risqeve dhe hartimin e Regjistrit të Riskut për vitin financiar 2024, shkresa Nr.44 datë 12.01.2024, dërguar të gjitha drejtorive të Bashkisë Kukës dhe për dijeni Kryetarit të Bashkisë dhe Koordinatorit të GMS-së) me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Janë njoftuar EMP-të dhe Drejtoria e IT-së, të përcaktojnë nevojat për investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të Bashkisë si dhe të kryejnë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Janë njoftuar EMP-të që të sigurojnë raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti dhe jo vetëm në bazë programi, çdo katër muaj p.sh: shkresa nr.211 prot., datë 03.04.2023, shkresa Nr.512 datë 14.08.2023, shkresa nr.257, datë 09.05.2023, shkresa nr. 345, datë 08.06.2023, shkresa nr.596, datë 06.09.2023, etj.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Rekomandimi 2.1. Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjia e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, konstatojmë se në vitin 2023 është kryer auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Rekomandimi 3.1. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë si dhe të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjia e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, që i takon Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçensave u është dërguar shkresë të gjitha drejtorive pranë Bashkisë Kukës ku u është kërkuar informacion për hartimin e paketës fiskale. Gjithashtu nga ana Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçensave dhe mbi bazën e analizës se treguesve të planit dhe realizimit si dhe objektivat e vendosura është bërë planifikimi për treguesit e vitit në vazhdim.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Rekomandimi 4.1. Inspektorati i Mbrojtjes Territorit të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, të zbatohet vendimi i prishjes së objektit si dhe të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndaj shkelësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjia e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, për vendimet e prishjes kemi vështirësi në sigurimin e mjeteve për ekzekutimin e tyre. Sa i takon bërjes së kallëzimeve penale ato nuk janë realizuar për asnjë rast.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

Rekomandimi 5.1. Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa për të ndjekur me përpikmëri planin 3-vjeçar që kanë hartuar për mënyrën e likuidimit të detyrimeve ndaj palëve të treta si dhe të kryejë procesin e rakordimit me institucionet përkatëse për vlerat e detyrimeve të prapambetura që regjistrohen në thesar. Gjithashtu të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Kukës dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjia e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në Programin Buxhetor Afatmesëm trevjeçar dhe në korrespondencën me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ka caktuar shumën e likuidimit për çdo vit financiar por ky fond është i pamjaftueshëm për të përballuar likuidimin e plotë, megjithatë Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, do të marrë masat e nevojshme për të hartuar dhe për të ndjekur planin për mënyrën e likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve, ndërsa sa i takon raportimeve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës për 4-mujorin e fundit janar - dhjetor 2022 ka dërguar shkresën nr.398, datë 03.02.2023, për 4-mujorin e parë janar - prill 2023, ka dërguar shkresën nr.1663, datë 09.05.2023, për 4-mujorin dytë janar - gusht 2023, ka dërguar shkresën nr.3638, datë 14.09.2023.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Rekomandimi 6.1. Nëpunësi zbatues të marrë masa për sistemimin e llogarisë 520 "Disponibiliteti në thesar" në vlerën 77,642,791 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

Përgjigjia e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, nga shënimet që ish drejtori i Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Kukës z. M. I, në Informacionin për akt konstatimin nr.5, datë 04.09.2023 për "Vlerësim i raportimit financiar për te parashikuar opinionin mbi pasqyrat financiare për vitin 2022, mbajtur me datë 04.09.2023" dhe dorëzuar me datë 11.09.2023 është dhënë sqarimi: "Sqarojmë se për tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete ne thesar" dhe të llogarisë 466 janë të vërtetuara me akt rakordimet e mbajtura mes

Degës se Thesarit dhe Bashkisë Kukës”. Ndërsa këto shënime do të reflektohen në mbyllje të pasqyrave financiare 2024 dhe do të bëhet sistemimi i llogarive 520 dhe 466.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 7.1. Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të pasqyruara në llogarit analitike inventariale. Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin e regjistrit të aktiveve, me të gjithë elementët e nevojshëm të tij.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, ka drejtuar shkresën nr.86, datë 22.01.2024 “Për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara të Bashkisë Kukës” Drejtorisë Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave.

Drejtorja Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave me Nr.86/1 datë 09.02.2024 “Kthim përgjigje”

është shprehur se në bazë të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet” si dhe të akteve nën ligjore VKM nr.433, datë 08.06.201 ndryshuar me VKM nr.684, datë 02.09.2020, VKM nr.59, datë 26.01.2022 dhe VKM nr.60, datë 26.01.2022, Drejtoria Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave ka nën administrim sipërfaqen e fondit pyjor prej: 40,068.38 ha.

Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (Meqenëse kanë në strukturën organizative Sektor të administrimit të pronave publike).

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, ka drejtuar shkresën Nr.87 datë 22.01.2024 “Për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara të Bashkisë Kukës” Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

Drejtorisë Zhvillimit të Bujqësisë (Meqenëse kanë në strukturën organizative Punonjës të menaxhimit dhe monitorimit të parkut natyror) si dhe për dijeni Kryetarit të Bashkisë me qëllimin e ngritjes dhe krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri me sot, përkatësisht për zërin 211 "Pyje, Kullota, Plantacione" dhe zërin 210 "Toka, troje, terrene".

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, ka drejtuar shkresën nr.88 datë 22.01.2024 “Për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara të Bashkisë Kukës” Drejtorisë Zhvillimit të Bujqësisë

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit do të asistojë në aspektin financiar dhe kontabël çdo grup pune apo çdo komision të ngritur për këtë qëllim, pra për të krijuar regjistrat me të dhënat e datës së hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 8.1. Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, është detyrë e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të kryej procedurat e likuidimit të garancisë së punimeve dhe regjistrimin e veprimit kontabël në llogarinë 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", por kjo bëhet vetëm pasi shkresa ose plani që nënshkruhet nga Bashkia dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj, Kështu që është vetë operatori ekonomik që interesohet dhe bën kërkesën e likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% duke paraqitur proces-verbalin për marrjen në dorëzim të punimeve, aktin e kolaudimit të punimeve dhe certifikatën e përhershme të marrjes në dorëzim të punimeve.

Sipas nenit 107 "Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës" të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Plani i zbatimit të kontratës përfshin në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Rekomandimi 9.1. Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, njësia e prokurimit ka zbatuar këto kërkesa në prokurimet e zhvilluara.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Rekomandimi 10.1. Nga DPZHT Kukës të merren masa për të verifikuar planvendosjen e paraqitur si edhe të dhënat e përshkruara në të, që të jenë në përputhje me projektin e ndërtimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, nga drejtoria e urbanistikës janë konsideruar dhe zbatuar kërkesat ligjore.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Rekomandimi 11.1. Nga DPZHT Kukës të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, nga DPZHT janë konsideruar dhe zbatuar kërkesat ligjore.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 12.1. Nga DPZHT Kukës të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë, që të vërtetojnë ekzistencën e objektit në të cilin do të zhvillohet shtesa e kateve të ndërtimit në hartën treguese, në të dhënat/përshkrimet e paraqitura në kartelën e pasurisë dhe të mos ketë kufizim të pronësisë, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, nga DPZHT janë konsideruar dhe zbatuar kërkesat ligjore.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 13.1. Nga DPZHT Kukës të merren masa për të mos pajisur me certifikatë përdorimi dhe miratuar ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit pa verifikuar më parë masën e ndryshimit të sipërfaqeve ndërtimore në projekt dhe duke verifikuar realizimin e zbatimit të punimeve në përputhje me projektin e ndërtimit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, nga DPZHT janë konsideruar dhe zbatuar kërkesat ligjore.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 14.1. Nga DPZHT Kukës të merren masa për të mos pajisur me certifikatë përdorimi objekte pa verifikuar më parë përfundimin e realizimit të punimeve të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, nga DPZHT janë konsideruar dhe zbatuar kërkesat ligjore.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 15.1. Nga ana e Titullarit të Institucionit në bashkëpunim me Strukturat Drejtuese të merren masa e nevojshme si më poshtë:

- Komisioni i Blerjeve të Vogla, të marrë masa për administrimin e çdo procedurë në dosje të veçanta.
- Të hartojë fondin limit duke pasqyruar metodën e ndjekur dhe dokumentacionin provues.
- Të hartojë procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave për operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e 10-të.
- Komisioni i Blerjeve të Vogla, të firmosë faturat e tvsh-së për blerjen e mallit ose shërbimit të kryer.
- Komisioni i Blerjeve të Vogla, të përcaktojë në urdhrin e prokurimit fondin e përllogaritur.
- Autoriteti Kontraktor, të marrë masa për planifikimin e blerjeve dhe shërbimeve, duke mos kryer copëzim të fondeve.
- Drejtoria Ekonomike, të kryejë likuidimin e faturave brenda afatit ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, janë marrë masa nga njësia e prokurimit për plotësimin e dokumentacionit sipas kërkesave ligjore.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Rekomandimi 16.1. Nga ana e Bashkisë Kukës dhe strukturave Drejtuese të merren masa për të zëvendësuar anëtarët e komisioneve të konstatuara në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të kryhet procesi i dokumentimit dhe gjurmës së auditimit në mënyrë të tillë që në të ardhmen të parandalohen situatë ku mund të ketë anëtarë të komisioneve në kushte të konfliktit të interesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, është vepruar për çdo procedurë prokurimi si edhe janë marrë masat dhe po punohet për dokumentimin e gjurmës së auditimit.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 17.1. Bashkia Kukës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, konform detyrave të lëna sipas shkresës nr. 524/10 prot. datë 13.12.2023 "Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet", do të paraqesë para mbledhjes së parë GMS-së, Raportin për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, ky raport do të bëhet pjesë e Raportit të Përgjithshëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH që do të hartohet në rang institucioni dhe me këtë raport do të njihet Këshilli i Bashkisë Kukës në mbledhjen më të afërt.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

Rekomandimi 18.1. Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve që janë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi si vijon:

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, nuk janë marrë masa për të analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë në lidhje me mos zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

Rekomandimi 1.1. Nga ana e Bashkisë Kukës të merren masa për:

- Hartimin e manualeve mbi procedurat për operacionet kryesore;
- Krijimin e procedurave për delegimin e detyrave;
- Hartimin e gjurmëve standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Kukës;
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Vendosjen e një sistemi elektronik të mirëfilltë unik të mbajtjes së kontabilitetit;
- Hartimin e mekanizmave të cilat t'i dedikohen ankesave për korrupsion;
- Vendosjen e rregullave që të garantojnë sigurinë e sistemit IT;

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka hartuar manualin mbi procedurat për operacionet kryesore të veprimtarisë së kësaj drejtorie dhe me urdhrin nr.515, datë 17.08.2023 të Kryetarit të Bashkisë ka miratuar Dokumentimin e Hartës dhe Manualit të proceseve të punës në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në këtë urdhër është theksuar se për urdhrin dhe formatin e Hartës dhe Manualit të proceseve të punës në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit njoftohen Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) në Bashkinë Kukës në mbledhjen e radhës të GMS-së.

Po kështu Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka hartuar gjurmët standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Kukës dhe me Urdhërat Nr.511; 513 datë 17.08.2023 të Kryetarit të Bashkisë ka miratuar Dokumentimin e gjurmës së auditimit për procedurat e përgatitjes të PBA-së në Bashkinë Kukës, dokumentimin e gjurmës së auditimit për procedurat e ekzekutimit të shpenzimeve në Bashkinë Kukës, në këto urdhra është

theksuar se për urdhrat dhe formatet e gjurmës së auditimit për procedurat e ekzekutimit të shpenzimeve dhe për procedurat e përgatitjes të PBA-së njoftohen Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) në Bashkinë Kukës në mbledhjen e radhës të GMS-së. Prandaj dalja e këtyre urdhrave ju shërben edhe drejtorive të tjera dhe GMS-së për plotësimin e rekomandimit nr.1 të Grupit të auditimit që ka paraqitur në Projekt Raportin e Auditimit.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Rekomandimi 4.1. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, të marrë masa që jo vetëm të regjistrojë të gjitha vendimet gjyqësore që paraqiten pranë saj, por edhe të hartojë grafikun e likuidimit të tyre, duke u bazuar në përparësinë e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese. Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, ka marrë të gjitha masat që jo vetëm të regjistrojë të gjitha vendimet gjyqësore që paraqiten pranë saj, por edhe të hartojë grafikun e likuidimit të tyre, duke u bazuar në përparësinë e paraqitjes së tyre në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Rekomandimi 5.1. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në raportimin që dërgon në MFE dhe në akt rakordimin me thesarin, duhet të regjistrojë vlerën e plotë të të gjitha detyrimeve që kanë mbetur pa u likuiduar në fund të vitit, me qëllim identifikimin e vlerës reale të detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të pa likuiduara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Rekomandimi 6.1. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.

Gjatë hartimit të paketës fiskale 2023 dhe në vijimësi

Rekomandimi 7.1. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me Drejtorinë e Bujqësisë për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës mbi tokën bujqësore, si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Kukës në vlerën 1,802,472 lekë.

Deri në Dhjetor 2022

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimet nr.5, 6 dhe 7 nuk janë zbatuar nga Bashkia Kukës.

Rekomandimi 8.1. Nëpunësi Zbatues të marrë masa për sistemimin e llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar” në vlerën 158,359,154 lekë.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është në **proces zbatimi**.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Rekomandimi 9.1. Nëpunësi Zbatues, të kryejë veprimet e sistemimit për llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” duke siguruar përfshirjen në këtë llogari të studimeve dhe kërkimeve vetëm për objektet ende të papërfunduara në vitin ushtrimor të mbylljes së bilancit.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është në **proces zbatimi**.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Rekomandimi 10.1. Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa:

-Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” dhe zërin 210 “Toka, troje, terrene”, duke krijuar regjistrat me të dhënat e datës së hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

-Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrat të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacionin përkatës.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është në **proces zbatimi**.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Rekomandimi 11.1. Titullari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së Aktiveve Afatgjata Materiale për llogari të Bashkisë Kukës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Rekomandimi 12.1. Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të kryejë sistemimin e normës së amortizimit për llogarinë 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM”, respektivisht në vlerën 1,098,695,329 lekë për vitin 2021.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Rekomandimi 13.1. Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të kryejë njoftimin e subjekteve sipas kontratave përkatëse të investimeve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë totale 10,607,978 lekë dhe të kryejë sistemimet përkatëse në llogarinë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Rekomandimi 14.1: Titullari i Bashkisë Kukës në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruar në llogarinë 467 “Kreditore të ndryshëm” detyrimet për faturat e likuiduara 14,758,973 lekë për vitin 2021. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimet 11,12,13 dhe 14 janë në **proces zbatimi**.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Rekomandimi 15.1. Bashkia Kukës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi **nuk është zbatuar**.

Rekomandimi 16.1. Bashkia Kukës të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm si vijon:

-Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të arkëtojë vlerën e mbetur prej 57,847,995 lekë, përse i takon zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të KLSH-së.

-Të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 14,537,823 lekë pa TVSH nga z. A.P. në cilësinë e Shefit të Sektorit të Shërbimeve Publike dhe z. P. Th., në cilësinë e Shefit të Tatim Taksave,

vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e mungesës së dokumentacionit ligjor justifikues.

-Të merren masa për ndjekjen e 15 rekomandimeve që janë në proces zbatimi dhe që gjithashtu janë trajtuar edhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, sqarojmë se kjo çështje ka shkuar në Prokurori nga KLSH.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi **është në proces.**

Rekomandimi 1.1. Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 484 debitorë në vlerën 17,966,783 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Kukës të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi **nuk është zbatuar.**

Rekomandimi 2.1. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën:

- **9,294,922 lekë** detyrime nga taksat dhe tarifat familjare;

- **135,697,321 lekë** detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve.

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Kukës, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licensave kanë vazhduar procedurat për të ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore duke marrë masa konkrete si:

- Me anë për të verifikimit dhe monitorimit në vend aktivitetit tregtar të tatim paguesit
- Verifikimet në QKB në lidhje me statuset e tyre (aktiv/pasiv)
- Me anë të masave administrative apo sekuestros
- Bashkëpunime me banka të nivelit të dytë për urdhër bllokimet e llogarive bankare për vjeljen e detyrimeve perkatëse ... etj.
- Për sa i përket takses familjare jemi në proces të organizimit të menjëhershëm për vjeljen e kesaj takse.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 3.1. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bëjë verifikimet e dokumentacionit të subjekteve “G. P.”, “V. Sh.”, “S. P. A” dhe “D. 2001” shpk dhe të marrë masa që këto subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën përkatëse. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave ka kryer procedurat si më poshtë:

- G.P. në bazë të verifikimeve të terrenit dhe verifikimeve në QKB e ka mbyllur këtë aktivitet dhe ka kaluar në proces gjyqësor për vjeljen e detyrimit të këtij aktiviteti. Është hapur në të njëjtën adresë G.P.2.P dhe është pajisur me autorizim për ushtrimin e aktivitetit si dhe ka paguar detyrimin për autorizim.
- V. Sh. dhe S. P. A. nuk ushtrojnë aktivitet pra është mbyllur. Sqarojmë në bazë të verifikimeve të bëra se është e njëjta vendodhje aktiviteti dhe janë 2 subjekte që janë në proces gjyqësor për arsye konflikti mes dy palëve.
- D. 2001 ka likuiduar detyrimet për autorizimin dhe është në procedura për pajisjen me autorizim.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 4.1. Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave të marrin masa që qiramarrësit E.shpk & E-G shpk, dhe A. sha të paguajnë detyrimet referuar kushteve të kontratës në vlerën totale 1,628,127 lekë (E.shpk në vlerën 1,234,794 lekë dhe A. sha në vlerën 393,333 lekë). Gjithashtu, në vijimësi DAPK të ndjekë me përpikmëri zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit si dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave.

DAPK të hartojë një regjistër të plotë dhe të saktë për regjistrimin e të gjitha kontratave që lidhen për dhënie me qira të aseteve të bashkisë. Të përditësojë saktë të dhënat mbi afatet e kontratave, vlera e tyre si dhe pagesat periodike që kryhen nga qiramarrësit.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, Subjekti A. sha ka kryer pagesën në Shtator të vitit 2022 sipas kushteve të kontratës së lidhur me Bashkinë Kukës dhe nuk është debitor. Subjekti “E.shpk & E-G shpk ka kryer pagesën me datën 02.08.2023.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 5.1. Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare vlerën e gjobës së vendosur nga IMTV për vlerën totale **309,830,000 lekë**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, nga IMT konfirmohet se janë në proces të realizimit të tyre, gjobat e vitit 2022 janë dërguar në zyrën përmbaremore për ekzekutimin e tyre, gjobat e vitit 2021 janë pjesërisht në zyrën përmbaremore dhe pjesërisht në proces gjyqësor për shkak të vonesave të gjykatës, ku disa prej tyre janë pushuar gjykimet dhe i kemi ankimuar.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.MASA SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi 1.1. Bashkia Kukës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **983,375** lekë pa TVSH që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve OE "C" shpk me të cilin është lidhur kontrata nr.55 prot. datë 26.04.2021 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë e në vijimësi

Përgjigjia e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, OE "C" shpk është ende pa u likuiduar vlera e situacioneve, nuk është bere likuidimi përfundimtar, nga ku diferenca prej 983,375 Lekë do ti zbritet ne situacion ose do ti kërkohet arkëtim i shumës paraprakisht.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandimi 2.1. Bashkia Kukës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës **1,384,600** lekë pa TVSH që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve "C" shpk me të cilin është lidhur kontrata nr.139prot. datë 25.11.2022 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë e në vijimësi

Përgjigjia e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, OE "C" shpk është ende pa u likuiduar vlera e situacioneve, nuk është bërë likuidimi përfundimtar, nga ku diferenca prej 1,384,600 Lekë do ti zbritet në situacion ose do ti kërkohet arkëtim i shumës paraprakisht.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

Rekomandimi 1.1. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me Drejtorinë e Bujqësisë për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës mbi tokën bujqësore, si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Kukës në vlerën **1,802,472 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 2.1. Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 624 debitorë në vlerën 23,936,441 lekë**.

Rekomandimi 3.1. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën: Detyrimet nga taksat dhe tarifat familjare në shumën 14,545,865 lekë (2247 familje); Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve në shumën 161,823,517 lekë (471subjekte); a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim pagesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Kukës, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 4.1. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bëjë verifikimet e dokumentacionit të subjekteve G. P., V. Sh., S. P. A. dhe D. 2001 shpk dhe të marrë masa që këto subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën përkatëse. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Rekomandimi 5.1. Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare vlerën e gjobës së vendosur nga IMTV për vlerën totale 314,710,000 lekë, nga e cila vlera 4,880,000 lekë i përket vitit 2022. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjia e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, nga IMT Bashkia Kukës konfirmohet se gjobat e vitit 2022 janë dërguar në zyrën përmbarimore për ekzekutimin e tyre, gjobat e vitit 2021 janë pjesërisht në zyrën përmbarimore dhe pjesërisht në proces gjyqësor për shkak të vonesave të gjykatës, ku disa prej tyre janë pushuar gjykimet dhe janë ankimuar.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

D. MASA DISIPLINORE.

-Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kukës**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

“Vërejtje me paralajmërim”, për:

1.Z. A. Sh.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, masa e ezauruar pasi ky punonjës është larguar nga puna.

Komenti i grupit të auditimit:Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2. Zj. D. B.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, masa është ekzekutuar me vendimin nr. 1, datë 05.03.2024.

Komenti i grupit të auditimit:Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3. Z. E. T.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, masa e ezauruar pasi ky punonjës është larguar nga puna.

Komenti i grupit të auditimit:Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

4. Z. H. M.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, masa është ekzekutuar me vendimin nr. 84, datë 27.05.2024.

Komenti i grupit të auditimit:Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5. Zj. E. P.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, masa është ekzekutuar me vendimin nr. 2, datë 05.03.2024.

Komenti i grupit të auditimit:Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

6. Zj. M. D.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, masa e ezauruar pasi ky punonjës është larguar nga puna.

Komenti i grupit të auditimit:Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

7.Z. G. M. me detyrë Drejtor i Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e hartuesit të fondit limit, kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2 procedura.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, masa është ekzekutuar me vendimin nr. 3, datë 05.03.2024.

Komenti i grupit të auditimit:Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

8. Z. H. O.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, masa është ekzekutuar me vendimin nr. 4, datë 05.03.2024.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

9.Z. M. R.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, masa është ekzekutuar me vendimin nr. 5, datë 05.03.2024.

Komenti i grupit të auditimit:Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

10. Znj. O. M, me detyrë topografe, për problemet e konstatuara në lidhje me miratimin e 1 leje ndërtimi dhe 1 çertifikatë përdorimi, jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit dhe sipas kriterëve të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, masa e ezauruar pasi ky punonjës është larguar nga puna.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

11. Znj. O. L.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, masa është ekzekutuar me vendimin nr. 6, datë 05.03.2024.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

12. Z. M. G.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, masa e ezauruar pasi ky punonjës është larguar nga puna.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Për punonjësit të cilët kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Kukës, cilët janë trajtuar me Shërbim civil apo Kodin e Punës për arsye se janë larguar, masa e dhënë konsiderohet e ezauruar dhe konkretisht për:

1. Z. E. D.

2. Z. D. K.

3. Z. R. T.

4. Z. I. M.

5. Zj. E. Sh.

6. Zj. M. S.

7. Zj. G. E.

8. Zj. F. S.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim për 8 punonjësit si më sipër, masa konsiderohet e ezauruar pasi këta punonjës janë larguar nga puna.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces
Masa Organizative	18	8	3	7
Masa Shpërbllim dëmi	2			2
Uljen e Borxhit	5		4	1
Masa Disiplinore	2	2		
Total	27	10	7	10

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e viteve 2020-2022 paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces
Masa Organizative	13	3	3	7
Masa Shpërbllim dëmi	2	1		1
Uljen e Borxhit	4		2	2
Total	19	4	5	10

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

- Drejtoria Ekzekutive, nuk ka respektuar afatin 6 - muhor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

-Drejtoria Ekzekutive, ka vepruar dhe ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve.

-Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 37 %, ndërsa niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e viteve të kaluar paraqitet në masën 21%.

2.5.Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Gjatë auditimit nuk pati probleme apo çështje të tjera për të shqyrtuar.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2023 u konstatua se:

a. Për vitin 2023 shpenzimet janë realizuar 2,234,553 mijë lekë nga 2,068,427 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 92.5% dhe të ardhurat janë realizuar në shumën 179,764 mijë lekë nga 146,581 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 123%. Gjatë vitit 2023 ndryshimet e buxhetit janë bërë që në 3-mujorin e parë të vitit buxhetor.

b. Programim i të ardhurave nuk është bazuar në kapacitetet reale, duke planifikuar vlera të pa argumentuara në mungesë të të dhënave se mbi ç'bazë janë përlllogaritur të ardhurat për çdo taksë dhe tarifë, fakt të cilin e tregon realizimi i të ardhurave, ku për disa taksa dhe tarifa ka mosrealizim dhe në disa paraqiten me tejkalime të theksuara.

c. Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2023 të raportuara në MF janë në vlerën 164,622,100 lekë e cila përbëhet nga:

- vlera prej 86,668,986 lekë që i përket detyrimeve të prapambetura për energji elektrike, për ujësjellsin, shërbimit postar të krijuar në vitet e hershme, të pa regjistruara në sistemin e thesarit as në kontabilitet në kohën e krijimit të tyre.

- vlera prej 77,953,114 lekë detyrime për fatura të pa likuiduara, e cila është më ulët se në fund të vitit 2022 që ka qenë 83,793,293 lekë. Pjesë e detyrimeve të prapambetura është edhe vlera prej 35,949,383 lekë, që i përket vlerës pjesore të një fature të 1 projekti investimi të financuar nga AKUM, e cila ndërkohë është e likuiduar në datën 29.12.2023, duke sjellë kështu raportim të gabuar të detyrimeve në MF, kur në fakt duhet të ishte 42,003,731 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 paragrafi 4, nenet 47,48 dhe 52, me Udhëzimin e MF nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore” shtojca 4 germa (c), me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 40/h dhe 42; me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3 dhe me VKB-në nr. 83, datë 23.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 34-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Kukës, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në bashkëpunim me Menaxherët e Programeve, të kryejnë një proces

planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim që, programimet e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të jenë të plota dhe sa më të argumentuara, si edhe të eliminohen rialokimet e fondeve që në muajt e parë të vitit buxhetor. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, për uljen e detyrimeve të papaguara në mënyrë të kontrolluar, të cilat duhet të raportohen periodikisht dhe në mënyrë të saktë në Ministrinë e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Kukës familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit-gjellbërim-ndriçim dhe taksën e ndërtesës. Nga të dhënat e vëna në dispozicion rezulton se, kanë paguar detyrimet për këto taksa/tarifa 362 familje në vlerën 1,283,712.34 lekë nga 2852 gjithsej të taksuara për qytetin Kukës, ku 22.6 % e tyre rezultojnë debitorë në një ose disa taksa/tarifa. Bashkia Kukës në mungesë të agjentëve tatimor i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësive administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë, ndërsa për familjet debitorë nuk ka një regjistër, të cilat e marrin shërbimin e pastrimit-gjellbërim-ndriçimit dhe nuk paguajnë taksa/tarifa për to.

Gjithashtu, nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se, fermerët nuk ngarkohen për pagesën e **taksës së tokës** bujqësore dhe se Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve fermere që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë, si edhe për sipërfaqen e tokës bujqësore që fermerët zotërojnë në përdorim apo me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe taksa e tokës bujqësore. Për taksën e tokës për vitin 2023 janë arkëtuar 4,577 lekë nga 568,328 lekë e planifikuar, ose në masën 0,8%, fakt që tregon se familjet fermere nuk taksohen dhe planifikimi i kësaj takse është jo reale, pasi mbi bazën e të dhënave mbi ndarjen e fondit të tokës dhe kategorizimin e saj të ardhurat e planifikuara në vitin 2022 ishin në vlerën 2,370,800 lekë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, neni 23, me ligjin nr.139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” i ndryshuar neni 9 pika 1.3 dhe neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10 dhe me VKB nr. 83, datë 23.12.2022, “*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës*”, me ligjin nr.139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” i ndryshuar neni 9 pika1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 44-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Këshilli Bashkiak të marrë në analizë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën, ndërsa Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa për hartimin e regjistrave të plotë për taksapaguesit familjarë dhe fermerë me ngarkesat e sakta për taksat dhe tarifatat vendore, në mënyrë që të përcaktojë saktë detyrimet debitorë, si edhe të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për detyrime dhe të ndjekë arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Referuar treguesve të programimit dhe realizimit të të ardhurave rezultoi se janë realizuar në nivel shumë të ulët ose nuk janë mbledhur të ardhura në disa tarifa:

a. Tarifa për shërbime (tregje, leje të përkohshme etj.) për vitin 2023 është realizuar 0 lekë nga 2,869,776.94 lekë e planifikuar. Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve Publike dhe Tregjeve publike nuk kanë arritur të mbledhin të ardhura për tarifën e tregjeve publike në administrim të bashkisë për vitin 2023, ku sipas paketës fiskale tarifa e tregut të lirë është 600 lekë në muaj ose 7200 lekë në vit.

b. Tarifa e shërbimit veterinar për vitin 2023 është realizuar 0 lekë nga 342,685 lekë e planifikuar ose në masën 0%. Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka siguruar informacion për numrin e therjeve të bagëtive gjatë vitit ushtrimor dhe nuk ka ndjekur procedurat për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e therjes dhe shërbimit, duke sjellë të ardhura të munguara.

c. Tarifa e parkimit për vitin 2023 është realizuar 80,000 lekë nga 344,373.23 lekë e planifikuar ose në masën 13.7%. Bashkia Kukës nuk ka një plan të detajuar për mbledhjen e tarifës së parkimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 5/a, me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9/1, pika 1.3, germa (a,b dhe ç), me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, nenet 6 dhe 9 “Arkëtimet”, me paketën fiskale, Kreu II, pika 14 dhe me Rregulloren e Bashkisë miratuar me Urdhër nr.328, datë 05.04.2022, neni 67/b, neni 68/b. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 44-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë situatën, duke nxjerrë përgjegjësitë dhe të miratojë një plan veprimi për mënyrën e arkëtimit të tarifës së parkimit dhe tarifës së shërbimit veterinar, si edhe të përcaktojë qartë përllogaritjen dhe arkëtimin e tarifës së tyre.

Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrin masa për arkëtimin e tarifës së tregut të lirë për vitin 2023, si edhe të arkëtojnë tarifën në vazhdim nëpërmjet lidhjes së kontratave me subjektet që ushtrojnë veprimtari në tregjet në administrim të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në aktiv të bilancit në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerë bruto dhe neto 13,032,892 lekë dhe sipas inventarit kontabël në vlerën 5,611,778 lekë, pra nuk rakordon për shumën 7,420,514 lekë, e cila është mbartje e pa analizuar e viteve të kaluara 2011-2013 nga ish-komunat. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik i projekt-studimeve të blera dhe mos identifikimi i tyre në mungesë të dokumentacionit nuk ka bërë të mundur përcaktimin se kujt investimi të kryer apo jo i përkasin, për të bërë sistemimet kontabël. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizim. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu III, pika 36, Aneksi 1, pika 2, klasa 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 56-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të shqyrtojë dokumentacionin financiar të arkivuar të ish-komunave dhe bashkisë për identifikimin e projekt-studimeve gjendje e llog. 202 “*Studime dhe kërkime*”, ku vlerat e tyre ti kalojnë AAGJM-ve përkatëse dhe për pjesën e mbetur të përlllogarisë amortizimin e tyre, veprime të cilat të evidentohen nëpërmjet sistemimeve kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024.

Brenda datës 31.03.2025

5. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të kontabilitetit dhe analizës të pjesës më të madhe të llogarive të AAGJM rezulton se, inventarët kontabël dhe fizik nuk rakordojnë me gjendjet në bilanc të llogarive:

- Inventari kontabël i llog.210 “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 273,575,103 lekë, i cili nuk rakordon për vlerën 202,600,645 lekë me gjendjen prej 70,974,458 lekë të paraqitur në bilanc;
- Inventari kontabël i llog.211 “*Pyje, Plantacione*” është në vlerën 101,458,750 lekë, i cili nuk rakordon për vlerën 22,186,849 lekë me gjendjen prej 123,645,599 lekë të paraqitur në bilanc;
- Inventari kontabël i llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” është në vlerën 1,294,797,949 lekë, i cili nuk rakordon për vlerën 377,725,348 lekë me gjendjen prej 1,672,523,297 lekë të paraqitur në bilanc;
- Inventari kontabël i llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” është në vlerën 1,063,823,718 lekë, i cili nuk rakordon për vlerën 767,282,166 lekë me gjendjen prej 1,831,105,884 lekë të paraqitur në bilanc;
- Inventari kontabël i llog. 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” është në vlerën 10,415,206 lekë, i cili nuk rakordon për vlerën 54,548,880 lekë me gjendjen prej 64,964,086 lekë të paraqitur në bilanc;
- Inventari kontabël i llog. 215 “*Mjete Transporti*” është në vlerën 189,429,719 lekë, i cili nuk rakordon për vlerën 15,142,508 lekë me gjendjen prej 174,287,211 lekë të paraqitur në bilanc.

Në këto llogari azhurnimet bruto për një pjesë të aktiveve janë kryer me një emërtim të pa adresuar, ku vlerat e tyre nuk dihet se çfarë përfaqësojnë, pasi nuk janë të analizuara me emërtesa të sakta dhe të plotë. Për këto aktive mungon inventari fizik. Regjistri historik i aktiveve AAGJM mbi të cilin kanë dalë dhe vlerat kontabël të llogarive të klasës 20 -21 është i pasaktë dhe i pa plotë, gjë që e tregojnë mos rakordimet me vlerat e bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” kapitulli III, pika 30, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 , i ndryshuar, Aneksi 1, pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 56-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Strukturat drejtuese të marrin masa, që të kryhet inventarizimi fizik i AAGJM-ve dhe shqyrtimi i dokumentacionit financiar arkivor i ish-komunave dhe Bashkisë, për identifikimin e plotë dhe evidentimin e AAGJM-ve të institucionit me vlerat e tyre.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet të AAGJM, duke saktësuar gjendjet e llogarive të klasës 21 në aktiv të bilancit, duke ribërë klasifikimin e saktë të aktiveve. Gjithashtu të bëjë rakordimin e inventarëve kontabël dhe fizik të tyre, si dhe përcaktimin e vlerës së plotë të çdo aktivi që nga vlera fillestare me gjithë shtesat dhe pakësimet, shoqëruar me korrektimet kontabël për amortizimet, si edhe evidentimin e tyre aktiv për aktiv në librin historik të hartuar sipas formatit të përcaktuar ligjor.

Brenda datës 31.03.2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se, inventarizimi ka filluar pas mbylljes së vitit ushtrimor 2023 dhe ka përfunduar pas hartimit të PF, çka tregon se nuk ka shërbyer evidentimit të plotë të AAGJ dhe saktësisht të tyre. Komisionet inventarizimit nuk kanë evidentuar dhe nënshkruar procesin e inventarit në fletët e inventarëve sipas formatit tip, të cilat kanë formën e kartelave të magazinës, ku nuk përfshihet rubrika e inventarit fizik dhe rezultati nga krahasimi me inventarin kontabël. Aktivitetet e inventarizuara nuk janë të ndara sipas llogarive, por janë listuar të gjitha aktivitetet e llogarive 31 “Materiale”, llog.32 “Inventar i imët” dhe llog.218 “Inventar ekonomik” me një vlerë totale të inventarit kontabël prej 147,885,686 lekë, ndërsa në bilanc vlera e këtyre llogarive së bashku paraqitet 119,031,338 lekë, pra nuk rakordon për shumën 28,854,348 lekë. Nuk është hartuar një relacion përmbledhës për gjithë inventarin e AAGJM, ku të përshkruhen mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit. Gjithashtu mungon dokumentimi i procedurës nëpërmjet procesverbaleve përkatëse dhe i rezultatit të inventarizimit nëpërmjet hartimit të raportit të inventarizimit nga komisioni.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 85, me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 i ndryshuar, Aneksi 1, pikat 2 dhe 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 56-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për saktësimin e gjendjeve të llogarive në aktiv të bilancit llog.31 “Materiale”, llog.32 “Inventar i imët” dhe llog.218 “Inventar ekonomik”, duke rishikuar dokumentet bazë financiare për nxjerrjen e të dhënave të sakta dhe pas inventarizimit fizik të këtyre aktiveve të kryhen veprimet e sistemimit në kontabilitet.

Brenda datës 31.03.2025

7. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 719,722,580 lekë, e cila duhet të paraqesë vlerën pjesore të paguara të kontratave deri në vlerë të plotë të investimeve që janë në vazhdim të pa kapitalizuara. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se, në gjendjen e saj ekzistojnë rreth 51 aktive në vlerën 257,135,966 lekë, të financuara në vlerë të plotë e të kapitalizuara nga kryerja e investimeve dhe janë marrë në dorëzim në vitet e mëparshme, të cilat në fakt nuk duhet të ishin pjesë e kësaj gjendje në këtë llogari, por duhet të shpërndaheshin në llogaritë e aktiveve përkatëse, sipas llojit nëpërmjet veprimeve kontabël. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 i ndryshuar, Kreu II pika 16/b,d dhe 18/a,b, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 56-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që, për vlerat e AAGJ-ve pjesë e gjendjes së llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” të kapitalizuara dhe të marra në dorëzim të kryhen veprimet kontabël për sistemin e tyre në llogaritë përkatëse të AAGJ.

Brenda datës 31.03.2025

8. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 0 lekë. Kjo gjendje nuk është e saktë, pasi në këtë llogari kontabilizohen diferencat e faturave të pa likuiduara të krijuara mbi afatin prej 60 ditë të pagesës, pra detyrimet e prapambetura, të cilat në fakt janë kontabilizuar në llog.401-404 “Furnitorë dhe

llogari të lidhura me to". Në gjendjet e këtyre llogarive të detyrimeve ndaj të tretëve nuk është përfshirë vlera e faturave prej 86,668,986 lekë të energjisë elektrike, shërbimit postar dhe të ujit të pijshëm, i cili është detyrim e hershëm i mbartur nga vitet e mëparshme, por është raportuar në MF. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, Kreu III pika 3.1 nënpika 42, Aneksi 1 pika 3.3/c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 56-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë veprimet në kontabilitet për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të detyrimeve ndaj të tretëve në llogaritë e klasës 4, duke kontabilizuar të gjitha faturat e mbërritura për blerje mallrash e shërbimesh të papaguara, me qëllim që pasqyrat financiare në fund të vitit ushtrimor të japin një informacion të saktë e të besueshëm në lidhje me detyrimet afatshkurtra.

Brenda datës 31.03.2025

9. Gjetje nga auditimi: Në gjendjen prej 573,235,944 lekë të llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* në mbyllje të vitit 2023 është përfshirë vlera prej 28,128,366 lekë e mbartur ndër vite, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 i ndryshuar, Kreu II, pika 15 nënpika b, pika 4.2, pika 3.3. Aneksi 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 56-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të shqyrtojë dokumentacionin financiar të viteve të mëparshme për aparatën e Bashkisë dhe ish-komunave sot Njësitë Administrative, në mënyrë që të bëjë të mundur analizimin dhe saktësimin e vlerës debitore prej 28,128,366 lekë në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024.

Brenda datës 31.03.2025

10. Gjetje nga auditimi: Referuar analizës të gjendjes së llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* rezulton se, nuk është zbritur vlera prej 13,545,856.14 lekë e investimeve të kryera në 11 objekte për ujësjellësa e rrjetin shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji, të cilat Bashkia Kukës nuk ia ka transferuar Ujësjiellës Kanalizime SHA Kukës (në varësi të AKUK) në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura"*, Kreu II, pika 14 dhe me Marrëveshjen e nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 15.07.2022 me objekt *"Krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizimeve"* neni 6, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 56-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandim: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Kukës dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë procedurat ligjore për transferimin e aktiveve që i përkasin ujësjellësave të rrjetit shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji në *"Shoqërinë Rajonale të Ujësjiellës Kanalizime, Kukës"* dhe të kryhen veprimet sistemuese kontabël në llog. 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*.

Brenda datës 31.03.2025

11. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2023 me urdhër-shpenzime në **60** raste faturash me vlerë 285,654,535 lekë, mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime/ investime të mbërritura në Bashkinë Kukës në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 i ndryshuar, neni 44

“Kontrolli i shpenzimeve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 58-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Administrimit të Pronave Publike konstatohet se, nga 4427 pasuri të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi/përdorim Bashkisë Kukës nga pushteti qendror i kanë kaluar përfundimisht 1894 pasuri Bashkisë (qendër) dhe 145 pasuri NJA Surroj sipas listave përfundimtare të miratuara me VKM-ët përkatëse. Ndërsa 2388 pasuri të paluajtshme të transferuara 9 Njësive Administrative si: Kolsh, Arrën, Bushtricë, Topojan, Malzi, Shtiqën, Kalis, Gryk-Çajë, Shishtavec janë në fazën fillestare të miratimit dhe 4 NJA-ve Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Zapod janë në fazën e miratimit të listave paraprake. Nga këto janë hipotekuar 20 prona dhe janë në proces hipotekimi 20 prona të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë inventarizimi dhe përditësimi i të dhënave.

Në mungesë të inventarizimit, përditësimit dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” dhe me VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 73-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandim: Bashkia Kukës nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave për 13 NJA: Kolsh, Arrën, Bushtricë, Topojan, Malzi, Shtiqën, Kalis, Gryk-Çajë, Shishtavec, Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Zapod, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga pushteti qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave paraprake apo fillestare të pronave të miratuara. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim të pa hipotekuara të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Vendore Kukës.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së dhe të dhënave të Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të kontratave të qiradhënies me shoqëritë të cilat:

- ushtrojnë aktivitet “HEC” rezulton se, në 13 raste të Hec-ve pas vitit 2021 nuk janë lidhur kontrata qiradhënie me subjektet private për sipërfaqet pyjore/kullosore, që shfrytëzojnë për arsye se nga këto: në 1 rast tubacionet i kanë futur nën tokë, në 5 raste ende nuk janë pajisur me leje ndërtimi dhe në 7 raste nuk ka të dhëna. Në këto raste pavarësisht se nuk është marrë leja e ndërtimit, nga këto shoqëri për objektin kryesor të kontratës, parcelat e marra me qira

nga fondi pyjor-kullosor kanë vazhduar ti mbajnë të bllokuara mbi 1 vit, duke mos lejuar Bashkinë ti ketë në dispozicion për vënie në shfrytëzim nga qiramarrës të tjerë me pasojë shkaktimin e të *ardhurave të munguara* për buxhetin e Bashkisë Kukës.

- Ushetrojnë aktivitet *“prodhim dhe nxjerrje minerare në formë karriere dhe galerie”* në 23 raste subjektet nuk kanë kryer procedurat e heqjes nga fondi pyjor/kullosor të parcelave që kanë shfrytëzuar, nga të cilat 13 subjekte kanë mbyllur aktivitetin, 4 subjekte vazhdojnë aktivitetin, si dhe 6 subjekte sipas AKBN janë të pajisura me licenca aktiviteti në harkun kohor 2007-2010, për të cilat Bashkia nuk disponon dokumentacion dhe nuk ka të dhëna. Për subjektet që ushtrojnë këtë aktivitet nuk janë lidhur kontrata, duke sjellë të ardhura të munguara dhe mos kompensim të sipërfaqeve të pyllëzuara.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.537, datë 28.02.2021 *“Për përcaktimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues në rastin e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”* i ndryshuar, nenit 25, pikat 3 e 4, me ligjin nr. 57/2020 *“Për pyjet”* neni 25, pikat 3,4,5 dhe me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*, neni 36, me VKM nr.559, datë 29.07.2022 *“Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”*, i ndryshuar me VKM nr.267, datë 27.04.2023, lidhja I dhe II. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 73-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandim: Strukturat drejtuese në Bashkinë Kukës në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Sektorin e Administrimit të Pronave Publike të marrë masa që, për subjektet, të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të hartojë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pa zbritura nga fondi pyjor, t'i drejtohet subjekteve me leje minerare të bëjë kërkesën për zbritje nga fondi pyjor. Ndërsa për rastet e 13 shoqërive që kanë mbyllur aktivitetin e prodhim-nxjerrje minerali të kërkohej kompensim të sipërfaqeve të pyllëzuara.

13.2. Rekomandim: Strukturat drejtuese nëpërmjet Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Sektorin e Administrimit të Pronave Publike në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Inspektoratin e Mbrojtjes të Territorit (IMT) për 13 rastet e shoqërive që ushtrojnë aktivitet “HEC” dhe 10 rastet e shoqërive që ushtrojnë aktivitet “prodhim dhe nxjerrje minerali” të kryejnë kontrolle në terren me qëllim evidentimin e sipërfaqeve që shfrytëzojnë për shtrirje tubacionesh, rrugë transporti të mineralit e vend-depozitim minerali apo vendosje ngrehinash dhe nënshkrimin e kontratave të qirasë.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2023 janë lidhur 2 kontrata me nr.73prot., datë 02.06.2023 dhe nr.48prot., datë 13.03.2023 të miratuara me VKB përkatëse, për dhënien në shfrytëzim të parcelave nga fondi pyjor/kullosor me procedura ankandesh, ku në të dy rastet janë paraqitur 1 ofertues, por nga verifikimi i dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura rezultojnë se mungojnë:

- garancia financiare e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në plan-biznes (vërtetimi bankar për gjendjen), dokumenti që vërteton se ka të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë në kundërshtim me kriteret e veçanta të kualifikimit të DSA, pika 6/1,2 “Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim” dhe Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit kullosor publik” Kreu V, pika 5.

- dëgjesa publike, leja e ndërtimit të Bar-Restorantit, statusi juridik i parcelës nga ASHK bashkëlidhur me dokumentacionin miratimit me VKB në kundërshtim me ligjin nr. 57, datë 30.04.2020, “Për pyjet” i ndryshuar, neni 17, pika 1/f dhe ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 18 pika 1, nënpika (e).

- proces-verbali i dorëzimit të parcelës, detyrim që nuk është parashikuar në kontratë si dhe në rastin e kontratës 10-vjecare nuk është noterizuar në kundërshtim me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 826, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 73-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masa për revokimin e 2 kontratave të lidhura të qiradhënies me persona fizik me nr.73prot., datë 02.06.2023 dhe nr.48prot., datë 13.03.2023 për mosplotësim dokumentacioni në ofertat e paraqitura në ankandet për dhënien më qira të parcelave nga fondi pyjor/kullosor në pronësi/përdorim të Bashkisë Kukës, të cilat nuk janë në përputhje me DSA.

Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike të marrë masa për rastet e dhënies me qira të aseteve në përdorim apo në pronësi të bashkisë që, para se të merret vendimi i Këshillit bashkiak të kryhen dëgjesa publike, si dhe ofertat duhet të shoqërohen me dokumentacion të plotë, sipas kërkesave të dokumenteve standarde të ankandit për tu kualifikuar. Kontratat të shoqërohen me procesverbalin e dorëzimit të parcelave që jepen me qira dhe kontratat mbi 9-vjet të jenë të noterizuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, bazuar në vetëvlerësimin dhe rezultatet e testeve të kryera, është konstatuar se, megjithëse disa aspekte të kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, ende mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK, si:

Për “Mjedisin e kontrollit”, megjithëse ka plan vjetor trajnimi dhe zhvillimi të stafit, mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës, zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, si dhe nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

- Mungon ndarja e proceseve të punës dhe përcaktimi i detyrave që ka secili punonjës. Drejtoria Juridike nuk bashkëpunon me drejtoritë e tjera si Drejtoria e Financës, Drejtoria e Aseteve etj, për të zbatuar detyrat funksionale.

Lidhur me “Menaxhimi i Riskut” Bashkia Kukës krahas vlerësimit të riskut, nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Për komponentin “Aktivitetet e Kontrollit” Bashkia Kukës nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT, jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Në kuadër të komponentit “Informimi dhe komunikimi” sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të bashkisë dhe të njësive të varësisë të saj.

Nga auditimi për komponentin “Monitorimi” ka rezultuar se: Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit si dhe Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave.

- Nuk është hartuar një dokument i mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm.

- Nuk janë ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punë, e cila gjendet. vetëm Drejtoria Ekonomike.

Veprimet e mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, pika 8/a, dhe 8/b; 9/3; 10; 2/3;16; 18/1; 21/2 dhe neni 27. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 17-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kukës, në kuadër të konsolidimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, si dhe të gjurmës së auditimit; të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësive si edhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Kryetari i Bashkisë dhe grupi i menaxhimit strategjik të marrë masa për evidentimin e nevojave të stafit për trajnim me qëllim ngritjen e nivelit profesionale të tyre, si edhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit dhe menaxherët e mesëm e të lartë të njësive.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2023, nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm, nuk ka të përcaktuara mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës.

- Audituesit e brendshëm nuk janë trajnuar në fushat e planifikuara në planin strategjik të Auditimit, si edhe nuk kanë kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut.

- Për vitin 2023, konstatohet se nuk është realizuar plani i auditimeve.

- Nuk dokumentohet procesi i ndarjes së detyrave/sistemeve për tu vlerësuar, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës, dokument ky i nevojshëm për vlerësimin e punës për secilin auditues.

- Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve nuk është dhënë asnjë opinion apo analizë mbi arsyet e mos realizimit të rekomandimeve të mëparshme si dhe mungon konkluzioni nga audituesit për masat që duhet të marrë menaxhimi i subjektit të audituar për realizimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13, si dhe me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, Kapitulli IV, pikat 4.1.12. dhe 4.1.1.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 28-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1.Rekomandim: Bashka Kukës të marrë masa për ngritjen e Komitetit të Auditimit si dhe trajnohen audituesit mbi menaxhimin e riskut. Njësia e Auditimit të Brendshëm, gjatë veprimtarisë audituese të marrë masa që, të plotësojë dosjen e auditimit sipas kërkesave të

përcaktuara në Manualin e Auditimit si dhe japë opinione apo të kryejë analizë për arsyet e mosrealizimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, me qëllim kryerjen e misionit të auditimit që i shërben përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 524/10 prot., datë 13.12.2023 rezultoi se, nga Bashkia Kukës, nuk është respektuar afati 6 mujor i kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga **18** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **8** janë zbatuar plotësisht, **7** janë në proces zbatimi dhe **3** nuk janë zbatuar.

-Nga **2** masa për shpërblyerje të rekomanduara **2** janë në proces zbatimi.

-Nga **5** masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) **4** janë pa zbatuar dhe **1** në proces zbatimi.

-Nga **2** masa disiplinore për 20 punonjës, ato janë zbatuar plotësisht.

Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 37 %.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 83-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

A. Masat Organizative

4.1.Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, të zbatohet vendimi i prishjes së objektit si dhe të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndaj shkelësve.

17.1 Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

18.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve që janë të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi si vijon:

- **Rekomandimi 5.1.** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në raportimin që dërgon në MFE dhe në akt rakordimin me thesarin, duhet të regjistrojë vlerën e plotë të të gjitha detyrimeve që kanë mbetur pa u likuiduar në fund të vitit, me qëllim identifikimin e vlerës reale të detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të pa likuiduara.

- **Rekomandimi 6.1.** Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.

- **Rekomandimi 7.1.** Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me Drejtorinë e Bujqësisë për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës mbi tokën bujqësore, si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Kukës në vlerën 1,802,472 lekë.

- **Rekomandimi 15.1.** Bashkia Kukës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

- **Rekomandimi 1.1.** Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 484 debitorë në vlerën 17,966,783 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Kukës të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

C.2 Masa për uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munquara).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me Drejtorinë e Bujqësisë për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës mbi tokën bujqësore, si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Kukës në vlerën 1,802,472 lekë.

2.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 624 debitorë në vlerën 23,936,441 lekë.**

3.1.Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

Detyrimet nga taksat dhe tarifatat familjare në shumën 14,545,865 lekë (2247 familje);

Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e bizneseve në shumën 161,823,517 lekë (471subjekte);

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Kukës, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

4.1.Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bëjë verifikimet e dokumentacionit të subjekteve G. P., V. Sh., S. P. A. dhe D. 2001 shpk dhe të marrë masa që këto subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën përkatëse. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE DHE QIRDHËNIET, ME PASOJË MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi planifikimit dhe realizimit të të ardhurave rezulton “Tarifa e përkohshme për investime në bashki” është realizuar 380,000 lekë nga 3,443,732 lekë e planifikuar ose në masën 11%. Në paketën fiskale është përcaktuar tarifë vendore në fushën e ndërtimit për subjektet që kryejë në projekte investimi në territorin e Bashkisë, e cila ka lidhje me dëmtimin në infrastrukturë, ndikimin në mjedis etj, si dhe shqetësimet që i vijnë komunitetit për shkak të kryerjes së punimeve. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, për 4 subjekte sipërmarrës punimesh që kanë realizuar projekte investimi për vitin 2023 me fondet e bashkisë në territorin e Bashkisë Kukës mbi 10 milionë lekë nuk është aplikuar “Tarifa e përkohshme për investime në bashki”. Nga përlllogaritja e detyrimit për “Tarifën e përkohshme për investime në bashki” për 4 subjekte rezultojnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë në vlerën 560,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 5/a, me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3/a,b,ç, me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar nenet 6 dhe 9, me paketën fiskale 2023 Kreu II, pika 4, nënpika 1, tab.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 44-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të nxjerrë njoftim pagesat dhe të ndjekë procedurat për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 560,000 lekë për “Tarifën e përkohshme për investime në bashki” për vitin 2023 për 4 subjektet që kanë realizuar projekte investimi gjatë viteve 2023-2024 me fondet e Bashkisë Kukës e ndarë:

- Për subjektin “O.”shpk për vlerën prej 140,000 lekë;
- Për subjektin “G.”shpk për vlerën prej 140,000 lekë;
- Për subjektin “D.”shpk për vlerën prej 140,000 lekë;
- Për subjektin “M.”shpk për vlerën prej 140,000 lekë.

Brenda datës 30.06.2025

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale konstatohet se, në fund të vitit 2022 janë 624 individë debitorë në vlerën 23,936,441 lekë. Gjatë vitit 2023 janë shtuar 85 debitorë në vlerën 3,060,990 lekë dhe janë kryer pagesa nga 95 individë detyrimet për TNI në vlerën 2,424,773 lekë. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave e Bashkisë Kukës nuk ka marrë masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë (legalizimet) për 614 individë debitorë në vlerën **24,572,657** lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për bashkinë, në fund të vitit 2023. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, pika 3/“c”, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5, me VKB nr. 83, datë 23.12.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 44-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa

administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 614 debitorë në vlerën **24,572,657 lekë**, si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

Brenda datës 30.06.2025

3. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kontratave për dhënien me qira të aseteve në përdorim/pronësi të Bashkisë Kukës konstatohet se, gjatë vitit 2023 janë aktive 7 kontrata për dhënie me qira të parcelave pyjore-kullosore për instalim antene të telefonisë celulare, ku në vitin 2024 janë përmbledhur në 4 kontrata. Nga këto paraqiten 2 subjekte qiramarrës (sipërfaqe pyjore) me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 1,215,236 lekë**, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kukës, veprime këto në kundërshtim me kontratat e lidhura të qiradhënies neni 4 “vlera e qirasë vjetore” dhe neni 5 “pagesa dhe regjimi i saj”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Kukës të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e tarifës së qirasë nga 2 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën 1,215,236 lekë e ndarë: Shoqëria “V. A.” sha në vlerën 765,236 lekë dhe Shoqëria “O. A.” sha në vlerën 450,000 lekë.

Brenda datës 30.06.2025

C. MASA PËR RRITJEN E PERFORMANCES NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT E TARIFAT VENDORE.

1. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave (DAPPLL) në territorin e Bashkisë Kukës kryejnë aktivitet ekonomik 678 subjekte private të biznesit të madh dhe të vogël. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave nuk disponon një regjistër të saktë dhe të plotë të taksapaguesve biznes i vogël dhe biznes i madh, pasi nuk janë kryer përditësimet çdo vit me të dhënat e DVTT, Kukës nëpërmjet korrespondencës zyrtare. Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Kukës, rezultoi se ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, për biznesin, taksat dhe tarifatat vendore, i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2022** vlera debitorëve është **155,256,317 lekë**, ndërsa **vlera borxhit e krijuar gjatë vitit 2023 është 48,952,961 lekë** dhe në fund të **vitit 2023** vlera debitorëve është **204,209,278 lekë**, vlerë e cila është pjesë e gjendjes së llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit Formati 1 i pasqyrave financiare.

Në gjendjen e debitorëve për biznesin është përfshirë dhe vlera debitorë prej 7,000,000 lekë e 7 subjekteve në fund të vitit 2023, që ushtrojnë aktivitet për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij.

Në vijim të punës për vjeljen e detyrimeve sipas informacionit të Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave (DAPPLL) janë nxjerrë 438 urdhër njoftime për bllokimin e llogarive bankare për vitin 2022 dhe 309 për vitin 2023. Si rezultat i këtyre masave të marra nga debitorët gjatë vitit 2023 kanë likuiduar detyrimet 73 subjekte në vlerën 17,869,591.91 lekë. Nga shqyrtimi me zgjedhje i 17 subjekteve e njoftuara për pagesën e detyrimeve me vlerë më të lartë debitorë konstatohet se, për 15 subjektet me vlerë debitorë 111,940,177 lekë nuk janë marrë masa të mëtijshme për arkëtimin e detyrimeve si: urdhër i bllokimit e llogarive bankare, masa të sigurimit të detyrimit tatimor, urdhër sekuestrimi dhe

konfiskimi i pasurisë. Ndërsa për 4 subjekte nga këto nuk është dërguar as urdhër bllokimi në bankat e nivelit të dytë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, pika 3, shkronja “c”, me VKB nr. 83, datë 23.12.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 90,91,93. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 44-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitoare në vlerën **204,209,277 lekë** nga subjektet e biznesit. Gjithashtu të marrë masa për plotësimin dhe saktësimin regjistrimit të taksapaguesve të biznesit, duke përcaktuar saktë detyrimet për arkëtim sipas llojeve të taksave e tarifave vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Për të gjithë punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kukës, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a -“Vërejtje” neni 58 shkronja (a), për 6 punonjës, si më poshtë:

1. Z. P. G. me detyrë Drejtor i të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave (për periudhën nga data 24.05.2023).

2. Z. E. M. me detyrë Shef i Sektorit të Menaxhimit të Ndërmarrjeve publike dhe Tregjeve publike.

3. Z. K. K. me detyrë Shef i Sektorit të Kontabilizimit dhe Shërbimit të Tatimpaguesve (për periudhën nga data 11.09.2023).

Për problemet e konstatuara në lidhje me mbledhjen e të ardhurave të bashkisë dhe monitorimin e borxhit, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, me paketën fiskale të miratuar me VKB nr. 83, datë 23.12.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës” dhe me Rregulloren e Bashkisë miratuar me Urdhër nr.328, datë 05.04.2022 si:

- Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit debitorë në vlerën 204,209,277.27 lekë dhe mos marrja e të gjithë masave për njoftimin e të gjithë msave shtrënguese për to.
- Rezultojnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kukës për vitin 2023, për tarifën vendore për 4 subjekte që realizojnë projekte investimi me fondet e Bashkisë Kukës në vlerën 560,000 lekë.
- Mos identifikimi i saktë i bizneseve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Kukës, pasi nuk ka bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukës për të saktësuar numrin e bizneseve dhe mungesën e dosjeve për çdo biznes me dokumentacionin përkatës.
- Për taksën e tokës për vitin 2023 janë arkëtuar 4,577 lekë nga 568,328.37 lekë e planifikuar ose në masën 0,8%, fakt që tregon se familjet fermere nuk taksohen.
- Nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së infrastrukturës 604 individë në vlerën 24,572,657 lekë dhe tarifën e autorizime/leje nga 7 subjekte në vlerën 7,000,000 lekë që ushtrojnë aktivitetin në fushën e tregtimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

4. Z. R. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit (për periudhën nga data 06.06.2023) në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe mbajtjes së kontabilitetit e hartuesit të PF, aktualisht specialist në DTTV, Bashkia Kukës, pasi:

Referuar të dhënave të kontabilitetit dhe analizës të pjesës më të madhe të llogarive të AAGJ rezulton se, mungojnë inventarët fizik dhe inventarët kontabël nuk rakordojnë me gjendjet në bilanc të llogarive të aktiveve si: llog. 202 “*Studime dhe kërkime*”, llog.210 “*Toka, Troje, Terrene*”, llog.211 “*Pyje, Plantacione*”, llog. 212 “*Ndërtesa Konstrukione*”, llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, llog. 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”, 31 “*Materiale*”, llog.32 “*Inventar i imët*” dhe llog.218 “*Inventar ekonomik*”.

- Në gjendjen e llog. 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*” ekzistojnë në mënyrë të gabuar rreth 51 aktive të kapitalizuar shumë kohë më parë. Në gjendjen e llog. 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” mungon vlera e faturave prej 86,668,986 lekë e Shërbimit postar dhe UK sha dhe gjendja e llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” është përfshirë vlera prej 28,128,366 lekë për të cilën nuk ka analizë të detajuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022.

5. Z. Z. J. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit, pasi:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të buxhetit rezulton se, plani vjetor nuk është hartuar i plotë, përse i përket treguesve të projekteve të investimit.

- Gjatë vitit 2023 janë kryer 3 shtesa fondesh, të cilat kanë ndodhur në 3-mujorin e parë të vitit, ndërkohë që, ky alokim fondesh nuk duhet të ndodhte, kur buxheti sapo është miratuar, si dhe nuk është përcaktuar se kush zë shpenzimesh është pakësuar apo objekt investimi.

- Një pjesë e investimeve janë parashikuar në PBA si objekte investimi, por pa vlerë, krahas objekteve të investimit me vlerë. Krijimi dhe akumulimi i detyrimeve të papaguara në fund të vitit ushtrimor dhe mos evidentimi i saktë i tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar nenin 52, Udhëzimin e MFE nr.9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” i ndryshuar pika 153-162 UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*”, pikat 82-91.

6. Z. A. Z. me detyrë Përgjegjës Sektori i Administrimit të Pronave Publike.

Për moskryerjen e procedurave për përgatitjen e formateve të miratuara të inventarit të përditësuar për transferimin në fazën përfundimtare në pronësi/përdorim të Bashkisë Kukës të 2388 pasuri të 13 Njësive Administrative si: Kolsh, Arrën, Bushtricë, Topojan, Malzi, Shtiqën, Kalis, Gryk-Çajë, Shishtavec, të cilat janë në fazën fillestare të miratimit dhe Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Zapod janë në fazën e miratimit të listave paraprake. Nga këto prona janë hipotekuar 20 prona dhe janë në proces hipotekimi 20 prona të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë inventarizimi dhe përditësimi i të dhënave.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*, Kreu IV, nenet 35-44, me Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003 *“Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”* dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 *“Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”*.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për **4 ish-punonjësit** e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e mëposhtëm nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” përkatësisht:

1. Z. G. Gj. me detyrë ish zv/Kryetar i Bashkisë Kukës.
2. Z. M. I. me detyrë ish-Drejtori i Financës dhe Buxhetit.
3. Z. I. D. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve.
4. Zj. M. D. me detyrë ish-Drejtoreshë e Drejtorisë Juridike e Prokurimeve Publike.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT